


MANUALI I PLANEVE TË MBARËSHTIMIT TE PYJEVE DHE KULLOTAVE



Janar, 2019

Miratuar nga:
Sekretar i Përgjithshëm

Adrian KAMENICA

LISTA E SHKURTIMEVE

AKM	Agjensia Kombetare e Mjedisit
AKZM	Agjensia Kombetare e Zonave te Mbrojtura
ARZM	Agjensite Rajonale te Zonave te Mbrojtura
ASIGJ	Autoriteti Shteteror per Informacionin Gjeohapsinor
BA	Bashkia
BE	Bashkimi European
D_{1.3}	Diametri bazimetrik(1.3 m nga toka)
GJP-db	Data baza per Gjendjen e Pyjeve
Ha	Hektar
IKP	Inventari Kombetar i Pyjeve
IPV	Inventarizimi Pyjor i Vazhdueshem
KAT-db	Katalog-baza e te dhenave
KP	Kadastra Pyjore
m	meter
m³	meter kub
m³/ha	meter kub per hektar
MP-db	Data baza per Monitorimin e Pyjeve
MTM	Ministria e Turizimit dhe Mjedisit
NJM	Njesia e Mbareshtimit
NJMPK	Njesia per Menaxhimin e Pyjeve dhe Kullotave
OBU	Organizata per Bujqesine dhe Ushqimin
OJQ	Organizata Jo qeveritare
PPJD	Produkte pyjore jo drusore
PMPK	Plani per Menaxhimin e Pyjeve dhe Kullotave
PMP-db	Data baza e Planit per Menaxhimin e Pyjeve
PLV	Prerja e Lejuar Vjetore
QKL	Qendra Kombetare e Licensimit
SIGJ	Sistemi i Informacionit Gjeografik
SISP	Sistemi i Informacionit Shqiptar ne Pyje
SPGJ	Sistemi i pozicionit gjeografik
SHBKP	Shtresat baze te Kadastres Pyjore
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
TPE	Tipet e Pyjeve European
VLK	Vlera te larta Konservuese
ZRPP	Zyra per Regjistrimin e Pasurive te Paluajtshme

PERMBAJTIA

1. Hyrie	7
2. Përmbajtja e Planit të Mbareshtimit.....	7
3. Pergjegjesite e Institucioneve ne hartimin e Planit te Mbareshtimit	9
4. Kuadri ligjor	10
5. Objektivat e Udhëzuesit	13
6. Struktura dhe përdorimi i Udhëzuesit	13
A. NËNSHKRIMI I KONTRATËS PËR FILLIMIN E PUNËS PËR	16
A.1 Kontrolli i disponibilitetit dhe aftesive profesionale te stafit te sherbimit pyjor bashkiak.....	16
A.2 Kontrolli i paisjeve ne ngarkim te Stafit te Pyjeve te Bashkise.....	16
A.3. Caktimi i detyres per hartimin e planit te mbareshtimit tek stafi ose tek ekspertet private.....	17
B. PROÇESI I PJESËMARRJES	18
C. PUNA PËRGATITORE.....	18
C.1. Grumbullimi i dokumentave dhe te dhenave nga planet e vjetra te Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave.....	18
C.2 Ndarja e ekonomise pyjore në parcela dhe nënparcela.....	18
C.3. Hyrja e planit te ri te mbareshtimit ne SISP dhe menaxhimi i procesit te punes	20
C.4. Kontrolli i transferimit të të dhënave tek SISP dhe shfaqja ne Web	20
D. PUNA NE TERREN	21
D.1 PËRGATITJA PËR PUNËN NË TERREN	21
D.1.1 Përbërja e ekipit të punës	21
D.1.2 Rikonjicioni i terrenit.....	21
D.1.3 Vendosja e rrjetit te siperfaqeve prove ne ortofoto ose ne harten e re te mbuleses sipas Inventarit Kombetar te Pyjeve (IKP).....	21
D.1.4 Puna me hartat dhe planifikimi i ecurise së saj.....	22
D.1.5 Kontrolli i GPS, tabletëve dhe regjistrimi i listes se siperfaqeve prove	22
D.1.6 Planifikimi per te arritur siperfaqet prove	22
D.2. PERSHKRIMI PARCELAR.....	22
D.2.1. Hyrje.....	22
D.2.1.1 Struktura e pershkrimit parcelar.....	22
D.2.1.2 Te dhenat parcelare dhe lidhja me Kadastren Pyjore dhe SISP	22
D.3 TE DHENA PER MENYREN E INVENTARIZIMIT.....	23
D.3.1 Pershkrimi i metodes se inventarizimit dhe vendosjes se rrjetit te siperfaqeve prove.....	23
D.3.1.1 Konsiderata te pergjithshme.....	23
D.3.1.2 Planifikimi i inventarizimit dhe pershkrimi i rrjetit te siperfaqeve prove.....	23
D.3.1.3 Inventarizimi me siperfaqe prove te perhershme dhe te perkohshme.....	24
D.3.1.4 Tipi dhe madhesia e siperfaqeve prove	26
D.3.1.5 Vendodhja gjeografike dhe vendosja e siperfaqeve prove ne terren	27
D.3.1.6 Shenimi i qendres se siperfaqes prove	27
D.3.1.7 Siperfaqet prove ne skaj te grumbullit	27
D.3.1.8 Matja e variablave te drureve brenda siperfaqeve prove	28
D.3.1.9. Tabelat e volumeve.....	28
D.3.2 Inventarizimi dhe kampionimi ne kullota	29
D.3.2.1 Konsiderata te pergjithshme.....	29
D.3.2.2 Tipi i inventarizimit dhe madhesia e siperfaqeve prove	29
D.3.2.3 Matjet brenda siperfaqeve prove	30

D.4. INFORMACIONI MBI SIPERFAQET PROVE (PYLL & SHKURRE).....	30
D.4.1 Te dhenat identifikuese	30
D.4.2 Matjet dhe te dhenat e mbledhura ne siperfaqet prove–Pyll	31
D.4.3. Matjet dhe grumbullimi i te dhenave ne siperfaqet prove - Shkurre	37
D.4.4. Informacioni per siperfaqet prove ne kullota	37
D.4.5 Produktet pyjore jo drusore (bimet aromatiko-mjeksore, frutat pyjore, lulet, farat)	39
D.4.6 Futja e te dhenave dhe kontrolli	39
D.5 INFORMACIONI I FORMULARIT TE TERRENIT	40
D.5.1. Te dhenat identifikuese	40
D. 5.2 Pershkrimi i stacionit.....	41
D.5.3. Pershkrimi i pyjeve, shkurreve dhe kullotave	44
D.6. REKOMANDIMET PER MENAXHIMIN	53
E. PUNA NE ZYRE – RAPORTIMI DHE PLANIFIKIMI I AKTIVITETEVE.....	57
E.1. PERGATITJA E RAPORTIT	57
E.1.1. Udhezimet baze per pergatitjen e raportit te PMPK.....	57
E. 2. PERMBAJTIA E RAPORTIT TE PLANIT TE Mbareshtrimit	57
E.2.1 Hyrje	57
E.2.1.1. Qellimi dhe objektivat e Planit te Mbareshtrimit te Pyjeve dhe Kullotave (PMPK).....	57
E.2.1.2. Ecuria e punes dhe pergjegjesite.....	57
E.2.1.3. Metodologjia e Punes.....	57
E.2.1.4. Informacioni i perdorur ne hartimin e PMPK.....	57
E.2.2 Pershkrimi i pergjithshem i Ekonomisë Pyjore	58
E.2.2.1. Informacion i pergjithshem rreth Ekonomise pyjore	58
E.2.2.2. Pronesia, administrimi dhe organizimi.....	58
E.2.2.3. Vendodhja gjeografike dhe ndarja administrative.....	58
E.2.2.4. Konteksi i Bashkise dhe Ekonomise Pyjore	58
E.2.2.5. Historiku i Mbareshtrimit te Pyjeve dhe Kullotave ne Ekonomine Pyjore	58
E.2.2.6. Situata demografike dhe social-ekonomike	58
E.2.2.7. Marketingu i produkteve pyjore drusore dhe jodrusore	59
E.2.2.8. Gjuetia dhe peshkimi.....	59
E.2.2.9. Fasilitetet rekreacionale dhe didaktike	59
E.2.2.10. Prania e zonave te mbrojtura, specieve dhe stacioneve.....	59
E.3. GJENDJA AKTUALE E PYJEVE DHE KULLOTAVE	59
E.3.1. Mbareshtimi dhe funksionet e Pyjeve dhe Kullotave	59
E.3.1.1. Perdorimi i territorit (aktual & propozimet)	59
E.3.1.2. Forma e qeverisjes (aktuale dhe propozimet)	59
E.3.1.3. Ndarja e ekonomise pyjore ne parcela dhe nenparcela	60
E.4. KUSHTET STACIONALE	60
E.4.1. Klima	60
E.4.2. Topografia dhe morfologjia.....	60
E.4.3. Gjeologjia.....	60
E.4.4. Tokat.....	60
E.4.5. Rrjeti hidrologjik dhe burimet e furnizimit me uje.....	61
E.4.6. Erozioni ne shpate dhe rrjedhiet ujore.....	61
E.4.7. Rrëshqitjet	61
E.5. VEGJETACIONI DHE BIODIVERSITETI.....	61
E.5.1. Brezat bioklimatike.....	61
E.5.2. Pyjet dhe kullotat	61
E.5.3. Tipet e pyjeve	62
E.5.4. Tipet e kullotave	62
E.5.5. Tipet potenciale te vegetacionit.....	62
E.5.6 Biodiversiteti.....	62
E.5.7. Prania e vlerave konservuese te larta (VKL).....	63

E.5.8. Rreziqet per biodiversitetin dhe efektet mbi planifikimin	63
E.5.9. Mundesite per aktivitetet didaktike dhe kerkim shkencor	63
E.6. ANALIZA E PYJEVE DHE KULLOTAVE	63
E.6.1. Analiza e të dhenave për Pyjet	63
E.6.1.1. Analiza e tipeve të pyjeve.....	63
E.6.1.2. Shperndarja e siperfaqes dhe volumit sipas formes se qeverisjes.....	63
E.6.1.3. Struktura e pyjeve sipas klasave të moshës dhe klasave të prodhimit	64
E.6.2. Analiza e të dhënave të kullotave	64
E.6.2.1. Gjëndja e kullotave	64
E.6.2.2. Madhesia e siperfaqes se kullotave dhe vendodhja e tyre	64
E.6.2.3. Altituda, pjerresia, kundrejtimi, kushtet hidrologjike	65
E.6.2.4. Mbritshmëria.....	65
E.6.2.5. Grumbullimi i te dhenave per zonat e djegura ne kullota(10 vitet e fundit)	65
E.7. REZULTATET E INVENTARIZIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE	65
E.7.1 Rezultatet e Inventarizimit të Pyjeve	65
E.7.1.1. Analiza statistikore e Inventarizimit	65
E.7.1.2. Volumi dhe rritja ne volum e grumbujve pyjore	65
E.7.1.3. Struktura Vertikale	65
E.7.1.5. Cilësia e materialit drusor.....	65
E.7.1.6. Biomasa dhe Faktoret e Ekspansionit te Biomases	66
E.7.1.7. Analiza e rolit te ekonomise pyjore ne sekuestrin e karbonit.....	66
E.7.2. Gjëndja shëndetsore dhe fitosanitare.....	66
E.7.2.1. Drurët e tharë	66
E.7.2.2. Dëmtimet e tjera	66
E.7.3. Prerjet e paligjshme.....	66
E.7.3.1 Prerjet e paligjshme, gjendja aktuale dhe efektet ne procesin e planifikimit.....	66
E.7.3.2. Impakti i prerjeve ilegale ne planifikimin dhe mbareshtimin e pyjeve.....	66
E.7.4 Rezultatet e Inventarizimit te Kullotave	66
E.7.4.1. Tipi dhe cilesia e kullotave.....	66
E.7.4.2. Perdoruesit e kullotave dhe koha	66
E.7.4.3. Llojet e bagetive	67
E.7.4.4. Perdorimi aktual dhe kapaciteti mbajtes i kullotave.....	67
E.7.4.5. Infrastruktura aktuale	67
E.7.4.6. Problemet mbi kullotjen dhe furnizimin e blegtorise me baze ushqimore.....	67
E.8. OBJEKTIVAT E MBARSHTRIMIT TE PYJEVE DHE KULLOTAVE	67
E.8.1. Objektivat e përgjithshme për planifikimin afat-gjatë	67
E.8.2. Objektivat kombetare per Zhvillimin e Pyjeve dhe Kullotave	67
E.8.3. Pajtueshmeria e PMPK me planifikimin rajonal dhe atë në nivel Bashkie	67
E.8.4. Objektivat kryesore te PMPK.....	68
E.8.5. Objektivat specifike të ekonomisë pyjore/NJM	68
E.8.5.1. Objektivat specifike mbi përdorimin e tokës, funksionin dhe formën e qeverisjes/mbarështrimit.....	68
E.8.5.2. Objektivat specifike mbi tipet e pyjeve	68
E.8.5.3. Objektivat specifik silvikulturale.....	68
E.8.5.4. Objektivat specifik për kullotat	68
E.8.5.5. Objektivat specifik mbi biodiversitetin.....	68
E.8.5.6. Objektivat specifik mbi gjëndjen shëndetsore	68
E.8.5.7. Objektivat specifik mbi faunen.....	68
E.8.5.8. Objektivat specifik për pyjet me funksion prodhues	68
E.8.5.9. Objektivat specifik për pyjet me funksion mbrojtës	69
E.8.5.10. Objektivat specifik për pyjet me funksion rekreacioni.....	69
E.8.5.11. Objektivat specifik për pyjet me funksion konservues	69
E.9. MASAT/AKTIVITETET E PLANIFIKUARA NË KUADËR TË MBARËSHTRIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE.	69
E.9.1. Prerja vjetore e lejuar/mundësia vjetore e shfrytëzimit.....	69

E.9.2. Prerja vjetore silvikulturore.....	69
E.9.3. Planifikimi vjetor i masave.....	69
E.9.3.1. Masat ne Pyje	69
E.9.3.2. Masat në kullota	70
E.9.3.3. Masat në infrastrukture dhe në zonat e degraduara, rekreacionale dhe didaktike	70
E.9.4. Masat afat-gjata	70
E.9.4.1. Masat silvikulturale në trungishte.....	70
E.9.4.2. Masat silvikulturore në cungishte	71
E.9.4.3. Masat silvikulturore në shkurre	72
E.9.4.4. Pyllëzimi, ripyllëzimi	72
E.9.4.5. Masat në kullota.....	72
E.9.4.6. Gjëndja dhe masat në infrastrukturën e ekonomisë pyjore	73
E.9.4.7. Masat specifike për aktivitetet rekreacionale dhe didaktike	73
E.10. VLERËSIMI EKONOMIK.....	74
E.10.1. Vleresimi i efekteve të masave të planifikuara në pyje dhe kullota	74
E.10.2 Planifikimi i të ardhurave/përfitimeve	74
E.10.3 Planifikimi i kostove/shpenzimeve	74
E.10.4 Analiza kosto-përfitim	74
F. LIDHJA MIDIS PLANIT TË MBARËSHTRIMIT TË PYJEVE E KULLOTAVE DHE SISP	75
F.1. PROÇESI I VALIDIMIT TË PMPK NË SISP	75
F.2. MIRATIMI I PLANIT TË MBARËSHTRIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE	75
G. MONITORIMI I ZBATIMIT TE PMPK	77
G.1. RISHIKIMI PERIODIK I ZBATIMIT TË PLANIT TË MBARËSHTRIMIT	77
G.2. RISHIKIMI AFAT-MESËM I PLANIT TE MBARESHTRIMIT.....	77
G.3. RISHIKIMI FINAL I PLANIT TË MBARËSHTRIMIT	77
SEKSIONI H - STANDARTET	78
STANDARTI 1 – PËRGATITJA E HARTAVE	79
1. Hyrje	79
2. Harta e Ekonomise Pyjore	79
3. Harta e funksioneve.....	81
4. Harta e tipeve të pyjeve dhe kullotave	82
5. Harta e rrjetit rrugor, infrastukturës dhe zonave të degraduara	85
6. Harta e ndërhyrjeve.....	88
STANDARTI 2 – LISTA E SPECIEVE	91
STANDARTI 3 – LISTA E TIPEVE TE PYJEVE DHE KULLOTAVE	94
STANDARTI 4 – LISTA E BIMEVE MJEKSORE DHE PRODUKTEVE PYJORE JO DRUSORE	96
STANDARTI 5 – LISTA E BIOTOPEVE	96
SEKSIONI I - ANEKSET	97
ANEKSI 1 - FORMATI PER LLOGARITJEN E KOSTOVE PER HARTIMIN E PLANIT TE MBARESHTRIMIT TE PYJEVE DHE KULLOTAVE.....	98
ANEKSI 2 - TERMAT E REFERENCES PER HARTIMIN E PMPK	102
ANEKSI 3 - UDHEZUESI PER PROÇESIN E PJESMARRJES	106
ANEKSI 4 – LLOGARITJA E NUMRIT TE SIPERFAQEVE PROVE.....	113
AneKSI 5 - MATJA E DIAMETRIT BAZIMETRIK (1.3 m NGA TOKA) DHE LARTESISE SE DRUREVE.....	115
ANEKSI 6 – SKEDA E TERRENIT PER GRUMBULLIMIN E TE DHENAVE NE SIPERFAQET PROVE NE PYJE/ /KULLOTA	118
ANEKSI 7 - DISTANCA HORIZONTALE	119
ANEKSI 8 - FORMULARI PER PERSHKRIMIN PARCELAR DHE NENPARCELAR.....	120
ANEKSI 9 – STACIONET ME VLERA KONSERVUESE TE LARTA (HCV).....	124
ANEKSI 10 - LISTA E SPECIEVE TE KERCENUARA.....	125
ANEKSI 11 - TIPET E VEGJETACIONIT POTENCIAL.....	130
ANEKSI 12 - PERMBAJTIA PER KONTEKSTIN E PERGJITHSHEM	132
ANEKSI 13 - QASJA E PERGJITHSHME DHE OBJEKTIVAT	132

ANEKSI 14 - METODAT PER LLOGARITJEN E MUNDESISE VJETORE TE SHFRYTEZIMIT	133
ANEKSI 15 - SHENJAT KUFI NDARËSE NË TERREN	135

1. HYRIE

Me reformen administrative dhe Ligjin Nr 115/2014, Qeveria e Republikës së Shqipërisë vendosi të krijonte njësi të reja administrative të quajtura Bashki, të cilat u krijuan nga bashkimi i njësive administrative të mëparshme (Bashkitë dhe ish komunat). Në këtë mënyrë nga 363 njësi administrative lokale (Bashki dhe komuna) me ndarjen e re administrative, u krijuan vetëm 61 Bashki të cilat natyrisht kanë edhe kufijet e tyre respektive. Po kështu me këtë ndarje të re administrative është e nevojshme të përcaktohen dhe definohen edhe njësia baze për mbareshtrimin e burimeve pyjore dhe kullorore në nivel Bashkie të cilat natyrisht kanë nevojë për hartimin e "**Planeve të Mbareshtrimit**" për zhvillimin e tyre afat-gjate. Situata aktuale tregon se shumica e planeve të mbareshtrimit të ekonomive pyjore kanë skaduar, sepse periudha e vlefshmërisë prej 10 vjetësh ka kaluar dhe kjo ka krijuar mjaft vështirësi në punën e stafit të pyjeve të bashkive. Po kështu Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) synon që të krijojë një sistem informacioni për burimet pyjore i quajtur **Sistemi Shqiptar i Informacionit të Pyjeve (SISP)** dhe informacioni që do sigurohet nga planet e mbareshtrimit do të integrohet në këtë sistem. Derisa SISP të jetë funksional përpunimi i të dhënave të planeve të mbareshtrimit do të realizohet nepermjet **MS Access** i cili do të rikonfigurohet duke siguruar lehtësi në transferimin e të dhënave tek ky sistem.

Bazuar në keto parakushte përgatitja e udhëzuesit të ri të planeve të mbareshtrimit është mjaft e domosdoshme. Udhëzuesi do të sigurojë një integrim të informacionit për pyjet dhe kullotat që ndodhen në territorin e Ekonomisë Pyjore dhe hartimi i udhëzuesit është bazuar në keto supozime:

- planet e mbareshtrimit do të përfshijnë pyjet (pyjet e lartë, cungishtet, shkurret) dhe kullotat që ndodhen në brendësi të kufijve të Bashkive dhe për këtë arsye plani që do të hartohet do emërtohet **Plani i Mbareshtrimit të Pyjeve dhe Kullotave (PMPK)**.

- udhëzuesi do të gjejë përdorim për të gjitha format e pronësive (publik apo private) të pyjeve dhe kullotave

- njësia baze për secilin PMPK do të jetë **Ekonomia Pyjore** e cila sipas klasifikimit të Organizatës për Bujqësinë dhe Ushqimin (OBU) njihet me emrin Njësia e Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave (NJMPK).

Si baze për krijimin e njësive të reja të mbareshtrimit do të shërbejnë ekonomitë pyjore ekzistuese. Në rastet specifike kur një ekonomi pyjore me ndarjen e re administrative i përket 2 bashkive fqinje, atëherë në këtë rast ekonomia pyjore ndahet në 2 njësi ekonomike të cilat i përkin bashkive të ndryshme. Në rast se sipërfaqja e njësive ekonomike është e konsiderueshme duke plotësuar kriterin e sipërfaqes sipas mbareshtrimit pyjor, ajo do të konsiderohet si ekonomi pyjore me vetë dhe për këtë rast duhet të riperkacohen kufijet e saj në përputhje me kufijet e bashkive. Në rast se sipërfaqja e njësive ekonomike është shumë e vogël propozohet që ajo të bashkëngjitet ekonomisë pyjore fqinje të bashkive respektive dhe në këtë rast duhet të rikonfigurohen kufijet e kësaj ekonomie pyjore. Ky udhëzues është hartuar për keto arsye:

- me qëllim përdorimin e mundësive aktuale dhe zhvillimet teknologjike në fushën e mbareshtrimit të pyjeve duke përfshirë, jo vetëm lidhjen direkte me internetin dhe përditësimin e informacionit, por edhe përdorimin e mjeteve të reja informatike sidomos ato që lidhen me SISP si: platforma kryesore e mbareshtrimit të të dhënave të pyjeve dhe kullotave në Shqipëri.

- udhëzuesi siguron një standartizim lidhur me klasifikimet që do përdoren nga PMPK, Kadastra Pyjore, IKP duke qenë të përshtatshëm për SISP.

2. PËRMBAJTIA E PLANIT TË MBARESHTRIMIT

"**Plani i mbarështrimit**" është dokumenti bazë për mbarështrimin e pyjeve, i hartuar në nivel ekonomie pyjore dhe përfshin:

- studimin e përgjithshëm të ekonomisë pyjore në aspektin e përshkrimit, organizimit territorial dhe studimit të kushteve stacionale të prodhimit
- punimet e terrenit ose inventarizimi i ekonomisë pyjore duke përdorur si njësia baze grumbullin pyjor (nenparcelen pyjore)

- planifikimin e masave dhe punimeve ne aspektin afatgjat dhe organizimin e procesit të prodhimit

Planifikimi afatgjate i qeverisjes se pyjeve dhe kullotave per nje periudhe maksimumi 15 vjet duhet te mbuloje te gjitha aspektet sociale, ekologjike dhe ekonomike. Udhëzuesi synon te mbështesë hartimin e **Planeve te Mbareshtimit te Pyjeve dhe Kullotave**, bazuar ne rregulla dhe standarte te mirë përcaktuara duke perfshire te gjithë aktoret dhe duke siguruar nje pjesmarje sa me te gjere te aktoreve ne procesin e hartimit te planit dhe planifikimit te masave. Qellimi final ne hartimin e Planit te Mbareshtimit te Pyjeve dhe Kullotave do te jete nje vendimarrje sa me e mire brenda nje kuadri te mirë përcaktuar. Në përgjithsi planifikimi i mbareshtimit te pyjeve do te bazohet në informacionin qe do te sigurohet nga inventarizimi i grumbujve pyjore dhe fokusi kryesor do te jete:

- përcaktimi i objektivave te mbareshtimit
- përshkrimi i burimeve pyjore ne nivelin e grumbullit pyjor si njësia më homogjene
- përshkrimi i gjëndjes silvikulturore dhe metodave të ndryshme
- përcaktimi i mundesise vjetore të shfrytezimit, rigjenerimit dhe përzgjedhja e specieve
- parashikimi dhe monitorimi i rritjes së pyllit dhe dinamizmit të rritjes
- mbrojtja e mjedisit bazuar në vlerësimin në terren
- planet per identifikimin e specieve te rralla, te rrezikuara dhe ne rrezik zhdukjeje
- grumbujt pyjore me funksione mbrojtjeje dhe rekreative
- planifikimi i nderhyrjeve ne ngastrat pyjore/kullosore
- hartografimi i grumbujve pyjore ose ngastrave (speciet,mosha e drureve, rrjeti rrugor,siperfaqet me bimesi te rralle pyjore,strukturat e ndryshme etj)
- hartat per qellime te veçanta (zjarret ne pyje,zonat kritike te erozionit te tokes etj)

Më në detaje detyrat dhe objektivat e seciles etape të përgatitjes së Udhëzuesit janë:

- **prezantimi i qëllimit te Projektit dhe Udhëzuesit te Mbareshtimit te Pyjeve e Kullotave** permes takimeve formale me stafin e sherbimit pyjor në Bashki, Ministri dhe agjensi te tjera me fokus kryesor: (1) përcaktimin e objektivave te mbareshtimit; (2) identifikimin e konflikteve; (3) përcaktimi i permbajties se udhëzuesit te Mbareshtimit te pyjeve.
- **kampionimi ne menyre sistematike** duke perdorur siperfaqet prove te perhershme dhe te perkohshme per sigurimin e te dhenave ne nivel grumbulli pyjor dhe per kullotat.
- **grumbullimi i te dhenave dhe planifikimi i nderhyrjeve** ne grumbujt individuale me fokus kryesor mbi: (i) speciet ne grumbujt pyjor dhe vendosja sipas kateve; (ii) mosha; (iii) perqindja e specieve dhe perzierja e tyre: (iv) klasa e prodhimit; (v) numri i drureve; (vi) cilesia e materialit drusor; (vii) nevojat per nderhyrje dhe perkujdesje; (viii) llogaritja e volumit; (ix) prodhimtaria e kullotave.
- **analiza e te dhenave** (grafiket me te dhenat kryesore te inventarizimit, sasia e materialit drusor qe do pritet; tabelat sipas specieve; tabelat e grumbujve sipas specieve kryesore; tabelat e klasifikimit te stacioneve; hartat etj).
- **planifikimi i nderhyrjeve ne grumbujt pyjore** si: prerjet rrah, prerjet rigjeneruese, prerjet e kujdesimit, aksesit ne pyje, ruajtja e natyres, permiresimi i kullotave etj.
- **perfundimi i negociatave me aktoret** dhe palet e interesuara
- **aprovimi nga autoritetet pergjegjese/perkatese**

Udhëzuesi i propozuar do të sjelle disa te reja krahasuar me udhëzuesin e mëparshëm. Disa nga këto ndryshime apo risi janë:

- udhëzuesi siguron nje integrim te kullotave dhe pyjeve duke i konsideruar ato si një entitet unik ne peisazhin rural

- udhëzuesi sjell një ndryshim në metodologjinë e kampionimit dhe marrjes së të dhënave në inventarizimin në terren duke synuar rritjen e saktësisë pa ndryshuar kostot.
- udhëzuesi përfshin inventarizimin e produkteve jo drusore
- udhëzuesi siguron një standartizim në përgatitjen e hartave duke përcaktuar rregullat dhe standartet përkatëse
- udhëzuesi ofron mundësinë e llogaritjes së kostove të aktiviteteve të ndryshme deri në hartimin final të Planit të Mbareshtimit të Pyjeve dhe Kullotave
- udhëzuesi është konceptuar si një mjet për përdorimin e informacionit dhe integrimin e tij në Planin e Përgjithshëm të Zhvillimit të Bashkive.

3. PËRGJEGJESITË E INSTITUCIONEVE NË HARTIMIN E PLANIT TË MBARSHTRIMIT

Aktoret sipas institucioneve të përfshira në procesin e planifikimit dhe rolet e tyre janë :

- **Bashkita (BA):** Janë pronarët legjitimë dhe administratorët e pyjeve dhe kullotave brenda territorit të tyre. Administrimi i pyjeve dhe kullotave kryhet nëpërmjet strukturave përkatëse të shërbimit pyjor bashkiak dhe menaxhimi i tyre deri tanimë është kryer nëpërmjet planeve ekzistuese të mbarshtimit. Aktualisht, shumica e planeve të mbarshtimit të pyjeve në pronësi të bashkive kanë skaduar prandaj ka një nevojë urgjente për hartimin e udhëzuesit dhe fillimin e punës për hartimin e PMPK. Për këtë arsye BA është një aktor i rëndësishëm në procesin e hartimit të PMPK. Roli kryesor i Bashkive në këtë proces do të jetë:

- përcaktimi i kriterëve për përcaktimin e Ekonomisë pyjore/NJM
- përcaktimi i nevojave për përgatitjen e planit të ri të pyjeve dhe kullotave bazuar në kriterin e urgjencës
- alokimi ose aplikimi për fonde me qëllim përgatitjen e PMPK dhe drejtimi i procesit të hartimit të planit të mbarshtimit që nga nënshkrimi i kontratës deri në monitorimin final.
- sigurimi i informacionit për Kadastrën Pyjore në lidhje me të dhënat e parcelave dhe nënparcelave (në të ardhmen e afert tek SISP).
- përcaktimi me bashkitë fqinje i nevojave për rregullimin e kufijve të ekonomive pyjore nëse është e nevojshme duke respektuar kufijtë sipas ndarjes së re administrative.
- organizon dhe menaxhon procesin e pjesëmarrjes së aktoreve ose paleve të interesuara (pronarë, komunitet, përdorues pyjesh, shoqata të përdoruesve të pyjeve, OJQ).
- transmeton të dhënat e monitorimit të përvitshëm të nderhyrjeve dhe ngjarjeve tek SISP dhe tek institucionet e tjera (AKM, MTM).

– **Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) :** MTM është përgjegjëse për menaxhimin e të dhënave të Kadastrës Pyjore, Planeve të Mbarshtimit të Pyjeve dhe SISP. Ajo menaxhon integrimin e informacionit të planeve aktuale që janë të vlefshme dhe të planeve të reja të mbarshtimit të pyjeve dhe kullotave të përgatitura për çdo Bashki në SISP. MTM bën miratimin final të PMPK, pasi bashkia ka bërë miratimin apo mbështetjen nga ana e saj.

– **Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM):** AKM është nën varesinë e MTM dhe ka përgjegjësi për menaxhimin dhe monitorimin e Inventarit Kombëtar të Pyjeve (IKP) (nëpërmjet sektorit të inventarizimit të pyjeve), të gjithë fondit pyjor dhe kullor, biodiversitetit, të dhënave të mbulesës së tokës dhe të ndryshimit të saj (nëpërmjet sektorit të Silvikuturës dhe Biodiversitetit). Bazuar në VKM Nr 47, datë 29 Janar 2014, AKM është përgjegjëse për zhvillimin e Planeve të Mbarshtimit të Pyjeve dhe Kullotave si dhe ruajtjen apo monitorimin e të dhënave të këtyre planeve.

Këta janë aktoret direkt përgjegjës në procesin e përgatitjes dhe menaxhimit të PMPK. Por ka edhe disa aktore të tjera të rëndësishme të përfshira në këtë proces të quajtur aktore kyç si:

– **Organizatave Joqeveritare (OJQ):** Shoqatat e përdoruesve të pyjeve dhe kullotave janë të organizuara në nivel lokal dhe mbrojnë interesat e përdoruesve të pyjeve dhe kullotave në zonat rurale në Shqipëri dhe bëjnë koordinimin midis përdoruesve. Ato mbështesin zbatimin e aktiviteteve të planifikuara në kuadrin e planit të mbarshtimit të pyjeve dhe kullotave në nivel Njesie Administrative. Këto shoqata janë të organizuara në nivel rajonal duke formuar Federatën Rajonale të Pyjeve dhe Kullotave. Federatat Rajonale

te Pyjeve dhe Kullotave janë pjesë përbërëse e Federatës Kombëtare të Pyjeve dhe Kullotave, e cila është një organizatë jofitimprurëse dhe joqeveritare që mbron dhe përfaqëson interesat e përdoruesve të pyjeve dhe kullotave në zonat rurale në Shqipëri.

– **Fakulteti i Shkencave Pyjore(FSHP):** Fakulteti i Shkencave Pyjore është institucioni i vetëm i edukimit universitar në fushën e pyjeve. Ai ofron trajnim për stafin pyjor të BA, shpërndarje të informacionit, harton manuale për aktivitetet e planeve të mbarestrimit dhe asistencë për hartimin e udhëzuesit të planeve të mbarestrimit.

Organizata të tjera të rëndësishme në nivel lokal dhe kombëtar të përfshira në proces si aktorë kyç janë:

- Organizatat jo qeveritare të Grave
- Organizatat joqeveritare Mjedisore
- Organizatat e menaxhimit të biznesit lokal
- Këshillat e fshatrave dhe të grave

4. KUADRI LIGJOR

Ky kapitull përmban disa të dhëna të kuadrit ligjor për hartimin e PMPK. Referenca kryesore është ligji Nr 9385, datë 4.05.2005: "Për pyjet dhe Sherbimin Pyjor-i ndryshuar" i cili ka pësuar ndryshime në disa pjesë të tij dhe kjo është reflektuar në Ligjin Nr 9791, datë 23.07.2007 dhe në fundmi në Ligjin Nr 48, datë 05.05.2016. Organizata e Bujqësisë dhe Ushqimit (OBU) thekson se secili vend duhet të përdorë perkufizimet e tij kombëtare në lidhje me pershkrimin për menaxhimin e qendrueshëm të pyjeve dhe për këto arsye disa perkufizime që përmban kuadri ligjor në vend janë të ndryshme nga ato të propozuara nga kjo organizatë. Megjithatë në këte seksion kemi përfshirë përkufizimet sipas kuadrit ligjor shqiptar dhe i kemi krahasuar ato me perkufizimet sipas OBU. Këto perkufizime jepen në tabelën e mëposhtme:

Termet	Percaktimet	
	Kuadri ligjor Shqiptar	OBU(FAO)
Fondi pyjor	"Fond pyjor" janë të gjitha sipërfaqet pyjore e jopyjore, burimet pyjore e jo pyjore bashkëshoqëruese, infrastruktura perkatese, përfshirë edhe sipërfaqet e zhveshura të cilat krijojnë një mjedis harmonik me pyjet e token pyjore (çeltirat, shkëmbinjte, dunat dhe ranishtet), brezat pyjorë mbrojtës, grupet e veçuara të drurëve dhe shkurreve.	Sipas OBU sipërfaqja pyjore është e percaktuar nga ligji ose rregulloret e cila mbetet e tillë dhe nuk mund të konvertohet në formë të tjera përdorimi ¹ .
Ekonomia pyjore	"Ekonomi pyjore" është sipërfaqja pyjore e ndarë në ngastra e nënngastra, si njësi bazë për drejtimin, organizimin, planifikimin dhe kontrollin e mbarestrimit të pyllit dhe që plotëson parimin e vazhdimësisë së prodhimit pyjor. Shënim: Në Shqipëri madhësia e ekonomive pyjore luhetet nga: <ul style="list-style-type: none"> ✓ 1500-6000 ha në zonat malore ✓ 1000-4000 ha në zonat kodrinore ✓ 500-1500 ha në zonat fushore 	Nuk ka një perkufizim

¹ Ligji Nr.9385, datë 4.5.2005: "Për Pyjet dhe Sherbimin Pyjor"

<p>Ngastra pyjore/ kullosore</p>	<p>"Ngastër" është ndarja e sipërfaqes së ekonomisë pyjore ne parcela, të cilat shërbejnë si njësi bazë për drejtimin, organizimin, planifikimin dhe kontrollin e mbarështimit të pyllit.</p> <p>Shënim: Kufijte e parcelave pyjore perfaqsohen nga forma natyrore te relievit si: lumenjte, luginat etj, ose nga kufij artificiale te perhershëm si: rruge, kanale vaditese etj. Identifikohet me numra dhe secila parcele karakterizohet nga forma, madhesia dhe perberja e saj. Siperfaqja e parcelave pyjore varion nga 15-50 ha dhe ne kushte specifike mund te jete e ndryshme nga keto limite.</p>	<p>Nuk ka nje perkufizim</p>
<p>Nengastra pyjore/kullosore</p>	<p>"Nëngastër" është një njësi sipërfaqe me madhësi minimale 0,5 ha, që shërben për vlerësimin e grumbujve pyjorë, planifikimin dhe kontrollin e trajtimeve të njëjta silvikulturore.</p> <p>Shënim: Nenparcela eshte njesi homogjene e cila ndryshona nga siperfaqet perreth nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ regjimi ose forma qeverisëse e grumbullit pyjor (trungishte, cungishte, shkurre). ✓ atributet e pyllit (speciet, klasat e moshes, faza e zhvillimit, kurodendesia, cilesia dhe prodhimtaria e grumbullit pyjor). 	<p>"Siperfaqe toke mbi 0.5 ha me drure me lartesi mbi 5 m dhe mbulesa kurorash mbi 10%, ose drure qe jane ne gjendje te arrijne keto vlera limit ne vend. Nuk perfshin siperfaqet qe jane toka bujqesore ose tokat urbane.</p>
<p>Plani i Mbareshtimit te Pyjeve dhe Kullotave</p>	<p>– Plani i Mbareshtimit të Pyjeve dhe Kullotave është një dokument baze per mbareshtimin e pyjeve i hartuar sipas njesive te ekonomisë pyjore me punime terreni e zyre, per njohjen dhe marrjen e te dhenave per token, klimen, faunen, biodiversitetin, grumbullin pyjor etj, si dhe masat qe parashikohen per administrimin dhe qeverisjen e qendrueshme te fondit pyjor, organizimin e prodhimit dhe planifikimin e punimeve te nderthurura te nevojshme silvikulturore.</p>	<p>Plani i mbareshtimit pershtat politikat rajonale dhe kombetare per pyjet ne nje program operacional te mire-kordinuar per pyjet dhe kullotat dhe qe siguron rregullimin e aktiviteteve ne pyje dhe kullota per nje periudhe te caktuar kohore nepermjet aplikimit te nderhyrjeve ne perputhje me synimet e specifikuara, veprimet/nderhyrjet dhe kontrollet. Eshte nje pjese e domosdoshme e sistemit te mbareshtimit sepse rregullon mbrojtien, prodhimtarine, shfrytezimin, trajtimin silvikulturor, monitorimin dhe operacionet e tjera.²</p>

- Qeverisja dhe drejtimi nga pikpamja teknike e pyjeve dhe kullotave behet ne perputhje me planet e mbareshtimit. Planet e mbareshtimit ekzistuese jane hartuar ne shumicen e rasteve nga kompanite private te licensuara. Sipas kuadrit rregullator ekzistues, plani i mbareshtimit te pyjeve publik dhe private miratohet nga nje komision teknik i krijuar nga MTM³ bazuar ne vleresimin e bere nga 3 recenzente (1 nga AKM dhe 2 te tjere specialiste me eksperience te fushes te zgjedhur nga Lista e Eksperteve te ministrisë). Në kuadrin ligjor nuk ka detyrime lidhur me periudhen e vlefshmerise se ketyre planeve.
- Edhe sipas OBU "Ekonomia pyjore menaxhohet nga nje plan menaxhimi afatgjate (10 ose me shume vjet) duke synuar ne percaktimin e qellimeve te mbareshtimit dhe ky plan duhet te rishikohet ne menyre periodike". Sipas ligjit dhe perkufizimeve te OBU administrata publike ne nivel lokal ruan te

² <http://www.fao.org/docrep/w8212e/w8212e04.htm#TopOfPage>

³ Rregullorja Nr 4, date 19.09.2008 "Per funksionimin e komisionit teknik per shqyrtimin e planeve te mbareshtimit te pyjeve".

drejten dhe pergjegjesite e mbareshtimit brenda përcaktimeve të kuadrit ligjor vendas. Prandaj kuadri ligjor parashikon se bashkia duhet të krijojë strukturat e saj për qeverisjen dhe mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave që ndodhen brenda kufijve të saj territorial (neni 7, paragrafi 3.1, ligji 9385/2005 i amenduar me ligjin Nr 48/2016). Administrimi dhe zhvillimi i pyjeve lokale ose pjesëve të tyre kryhet nga bashkitë (neni 7, paragrafi 3.1, ligji 9385/2005 i amenduar me ligjin Nr 48/2016).

Sipas Ligjit 9385/2005 i amenduar me ligjin Nr 48/2016 "Bashkia (pergjegjese per pyjet dhe kullotat bashkiake) kryen shërbimet teknike në fondin pyjor publik dhe ka këto detyra:

- a. qeverisjen e pergjithshme të pyjeve
- b. grumbullimin e të dhënave për zhvillimin e pyjeve publik dhe private
- c. ruajtjen e ekuilibrave biologjike në grumbujt pyjorë
- d. ruajtjen dhe menaxhimin e të gjithë dokumentave për skemen dhe zbatimin e planeve të mbareshtimit të fondit pyjor privat që ndodhen brenda njësive administrative që përbejnë bashkitë.
- e. mban të dhënat për semundjet, demtuesit dhe zjarret në pyjet dhe kullotat e bashkive
- f. drejton dhe supervizon punën për rehabilitimin e sipërfaqeve të eroduar dhe ndalimin e erozionit dhe rreshqitjeve në brendësi të territorit
- g. përgatitja e projekteve për investimet në pyje dhe kullota
- h. ndjekien, bashkëpunimin, harmonizimin dhe kryerjen e aktiviteteve të kërkimit shkencor në pyje dhe kullota
- i. vrojtimin e zhvillimit të flores dhe faunes së eger dhe propozimi i metodave për mbrojtjen e specieve të rrezikuara, të rralla apo në rrezik zhdukjeje.
- j. siguron mbështetje teknike nëpërmjet keshillimit për pronarët private dhe komunitetin
- k. organizon trajnimin dhe shërbimin e keshillimit për pronarët private
- l. kontrollon dhe merr në dorëzim punimet e kryera në pyje dhe kullota pavarësisht burimit të financimit.
- m. mirëmbajtjen dhe berjen funksionale të infrastruktures në fondin pyjor bashkiak
- n. hartimi dhe zbatimi i një programi për trajnimin e punonjësve dhe shërbimit pyjor bashkiak nëpërmjet trajnimit profesional
- o. mbështet zhvillimin e agro-pylltarisë në bashki

Në lidhje me pronesinë Ligji 9385/2005 thekson:

Fondi pyjor dhe kullor kombëtar ndahet sipas pronesisë në:

- pyje dhe toka pyjorë në pronesi të bashkive që ndodhen brenda territorit të tyre administrativ
- fondi pyjor dhe kullor që përben zonat e mbrojtura në Republikën e Shqipërisë dhe që zotërohet si pasuri e paluajtshme nga MTM.
- fondi pyjor dhe kullor që zotërohet në mënyrë ligjore nga persona private

OBU në perkufizimin për pronësinë thekson se i referohet të drejtës legale për të përdorur lirshëm dhe ekskluzivisht, për të kontrolluar, transferuar ose përfituar nga burimet pyjorë. Ajo mund të fitohet nëpërmjet këtyre mënyrave: blerjes; dhurimit dhe trashëgimit. Pronesia publike sipas OBU⁴ nënkupton pyjet që zotërohen nga shteti ose njësitet administrative të administratës publike, ose nga institucionet apo korporatat që zotërohen nga administrata publike. Në rastin e Shqipërisë pyjet publike janë zotëruar nga njësitet administrative dhe MTM (zonat e mbrojtura). Ndërsa pyjet private sipas OBU zotërohen nga individë, familje, komunitete, kooperativa private, korporata ose entitete të tjera biznesi, institucione fetare dhe edukuese.

Një pikë referimi në procesin e hartimit të PMPK është edhe Ligji Nr 9970, datë 24.07.2008 "Mbi barazimin gjinor në Shqipëri" ku në paragrafin 5 "Përfaqsimi i barabartë gjinor" është përcaktuar se përfaqsimi për secilin gjini nuk duhet të jetë më pak se 30% në institucione, nivele menaxhimi, organet e emëruara, partitë politike etj. Prandaj në të gjithë hapat e procesit të pjesëmarrjes aktive grupe duhet të përfaqsojnë jo më pak se 30%.

⁴ FRA(2015). "Forest Resources Assessment". Working Paper 180.

5. OBJEKTIVAT E UDHËZUESIT

Objektivi i udhëzuesit është të sigurojë mbështetje teknike për Bashkitë dhe ekspertët e pyjeve për përgatitjen e planeve të mbareshtrimit të Pyjeve dhe Kullotave. Plani i mbareshtrimit i përgatitur sipas këtij udhëzuesi synon të përcaktojë masat e nevojshme teknike dhe organizative për trajtimin e duhur dhe përmirsimin e gjëndjes aktuale të burimeve pyjore me qëllim specifik të rrisë produktivitetin e materialit drusor dhe funksioneve të tjera jo drusore. Përgatitja e planit të mbareshtrimit do të kryhet në përputhje me parimet e mëposhtme:

- ✓ parimi i vazhdueshmerisë
- ✓ parimi i shumë funksionalitetit duke mbuluar aspektet sociale, ekonomike dhe ekologjike
- ✓ parimi i rritjes së përdorimit të prodhimit pyjor
- ✓ parimi i vlerësimit total të rezervave

Plani i mbareshtrimit do të sigurojë parashikimin e tërësive masive dhe nderhyrjeve si: ripulëzimin, prerjet kulturore, prerjet sanitare/te higjenes dhe prerjet për ripërteritjen natyrore. Ai përcakton specifikimet teknike për të gjithë hapat që duhen ndjekur për hartimin e planit me qëllim kryesor sigurimin e një metode pune të standartizuar për të siguruar rezultate homogjene dhe të krahasueshme në nivel kombëtar duke përdorur procedurat dhe mundësitë e sistemit të ri të informacionit (SISP).

6. STRUKTURA DHE PËRDORIMI I UDHËZUESIT

Udhëzuesi për përgatitjen e Planeve të Mbateshtrimit të Pyjeve dhe Kullotave është zhvilluar në një dokument të vetëm i përbërë nga këto seksione:

- A. Nënshkrimi për fillimin e punës për hartimin e PMPK**
- B. Proçesi i konsultimit me grupet e interesit për hartimin e PMPK**
- C. Puna përgatitore**
- D. Puna e terrenit (të dhënat baze)**
 - D.1 Përshkrimi i parcelave dhe nën-parcelave
 - D.2 Inventarizimi
- E. Puna në zyrë – Raportimi dhe planifikimi i aktiviteteve**
- F. PMPK dhe SISP**
- G. Monitorimi i zbatimit të PMPK**
- H. Standartet dhe anekset**

Disa seksione (C; D; & E) mund të përdoren edhe si manuale. Ato përmbajnë një përshkrim të detajuar të fazave individuale dhe përmbajtjes së punës, referencat në formatin në terren dhe hartat. Kështu:

- **Seksionet A & B** – shpjegojnë proçesin e punës në lidhje me: (i) vlerësimin e aftësive profesionale dhe trajnimin e ekipeve të punës (ii) nënshkrimin e kontratës për fillimin e punës; (iii) menaxhimin e proçesit të pjesëmarrjes së aktoreve dhe palëve të interesit për të përcaktuar qëllimet dhe objektivat e planit të mbareshtrimit.
- **Seksioni C- Puna përgatitore** - përshkruan aktivitetet në ngarkim të Bashkisë me qëllim fillimin e proçesit për hartimin e PMPK duke përfshirë: (i) grumbullimin e dokumentacionit të nevojshëm; (ii) hartat pyjore (ndarja e parcelave, nënparcelave dhe vendosja e rrjetit të sipërfaqeve prove në hartën pyjore).
- **Seksioni D-Puna e terrenit.** Kjo fazë shërben për të siguruar të dhënat baze për vlerësimin e burimeve pyjore dhe kullotave që do të sigurohen nga përshkrimi i parcelave dhe nga inventarizimi. Ky seksion do të ndahet në 2 nën seksione:
 - **Seksioni D.1 – Përshkrimi i parcelave dhe nënparcelave** - përfshin të gjitha të dhënat e nevojshme për të siguruar një pamje të plote të gjëndjes aktuale të parcelave dhe nënparcelave duke përcaktuar edhe masat e nevojshme. Udhëzuesi ndjek të gjithë rrugën e cila përshkruhet në formularin e terrenit.

- **Seksioni D.2- Puna e terrenit/ inventarizimi** - pershkruan pergatitjet per fillimin e punes se terrenit, kriteret dhe metodat per organizimin e procesit te grumbullimit te te dhenave ne terren, operacionet dhe matjet e realizuara brenda siperfaqeve prove. Udhezuesi ndjek shenimet e formularit te terrenit.
- **Seksioni E – Puna në zyre, raportimi dhe planifikimi i aktiviteteve** – pershkruan të gjithë përmbajtien e nevojshme për një përshkrim te plote te gjëndjes aktuale të Ekonomise Pyjore, duke pershkruar objektivat e planifikimit dhe masat ne te gjithe sektoret lidhur me menaxhimin shumefunksional te pyjeve dhe kullotave. Ecuria e kapitujve duhet te ruhet ne pergatitjen e raportit per te siguruar rezultate homogjene.
- **Seksioni F - PMPK dhe SISP.** Ky seksion pershkruan qasjen dhe metoden e punes nga hyrja ne sistem deri ne miratimin e planit dhe ruajtien e tij ne SISP.
- **Seksioni G- Monitorimi i zbatimit te PMPK.** Ne kete seksion pershkruhet frekuenca e monitorimit te aktiviteteve te zbatuara sipas planifikimit ne planin e mbarështrimit si dhe pergjegjësia e stafit te shërbimit pyjor të BA ne procesin e monitorimit.
- **Seksioni H- Standartet dhe anekset.** Në fund të udhëzuesit gjenden dokumentat e Standarteve ne pune, sidomos lidhur me hartat e PMPK (duke pershkruar atributet,ngjyrat dhe emertimet), por edhe ne lidhje me listen e specieve, tipeve te pyjeve etj. Ne fund te dokumentit gjenden disa anekse qe jane pjese integrale e udhezuesit me qellim plotesimin dhe permirsimin e informacioneve dhe sygjerimin e masave te reja dhe mundesive.

Udhezuesi per hartimin e PMPK ndjek këtë rrjedhë logjike:




Figura 1. Rrjedha logjike e informacionit ne Planifikimin e Mbareshtimit te Pyjeve

A. NËNSHKRIMI I KONTRATËS PËR FILLIMIN E PUNËS PËR

Per te nisur procesin e hartimit te Planit te Mbarështrimit te Pyjeve dhe Kullotave është e nevojshme që të percaktohen aktivitetet e para ne nivel Bashkie dhe ne ngarkim te eksperteve te pyjeve per hartimin e tij.

A.1 KONTROLLI I DISPONIBILITETIT DHE AFTESIVE PROFESIONALE TE STAFIT TE SHERBIMIT PYJOR BASHKIAK

Aktiviteti i pare qe eshte pergjegjesi e bashkise eshte zgjedhja e eksperteve qe do merren me hartimin e PMPK. Keta eksperte do te jene nga stafi i sherbimit pyjor lokal te cilet ne pergjithesi jane inxhinjere pyjesh dhe qe duhet te jene pjese e ekipit te punes, sepse kane njohuri te mira mbi territorin dhe per aspekte te tjera me natyre lokale. Per kete arsye bashkia duhet te kontrolloje perberjen aktuale te stafit lokal duke marre ne konsiderate se numri minimal per ekipin e punes duhet te jete 3 dhe eshte mire qe te kete edhe disa persona te tjere qe te perfshihen ne kete pune per te siguruar nje efektivitet me te mire . Numri total i inxhinjereve te pyjeve apo teknikeve duhet te jete ne perputhje me karakteristikat e ekonomise pyjore (siperfaqja e saj, tipet e pyjeve, kushtet e terrenit etj.). Ekipi per hartimin e planit te mbareshtimit duhet te kete kete perberje:

- 1 inxhinjere pyjesh per te realizuar nje planifikim shume-funksional(drejtues i grupit te punes)
- 2 specialiste (1 teknik & 1 inxhinjere pyjesh qe duhet te angazhohen ne punimet e terrenit)
- minimumi 1 ekspert GIS per pergatitjen e hartave dhe menaxhimin e te dhenave dixhitale

Eshte e rendesishme qe te vleresohet edhe eksperienca e teknikeve ne organizim dhe ne menaxhimin e procesit te pjesmarries duke siguruar pjesmarrjen ne staf te nje eksperti i cili te lehtesoje angazhimin e aktoreve (jo domosdoshmerisht inxhinjer pyjesh).

Nevoja per trajnimin e stafit te sherbimit pyjor bashkiak duhet te vleresohet paraprakisht dhe duhet te fokusohet ne drejtim te menaxhimit të të dhenave, hartave dhe integrimin e tyre ne platformen e informacionit SISP. Deri ne funksionimin e SISP, planet e reja te mbarështrimit do të përgatiten nëpërmjet programit ekzisutes MS Access i cili do te pesoje nje rikonfigurim per tu permirsuar dhe per te qene me fleksibel ne perdorim.

A.2 KONTROLLI I PAISJEVE NE NGARKIM TE STAFIT TE PYJEVE TE BASHKISE

Bashkia duhet te kontrolloje gjendjen e instrumentave dhe paisjeve qe stafi i sherbimit pyjor bashkiak zoteron ne menyre qe te realizoje me sukses punen e terrenit. Per realizimin e planit duhet te kene te pakten 1 makine 4 x 4, diameter mates, hipsometer, busull, tryele, tablete per regjistrimin e te dhenave ne terren, kompjuter, printer (me ngjyre qe printojne ne formatin A3). Duhet qe te behet nje vleresim i gjendjes aktuale se paisjeve dhe mjeteve te nevojshme dhe me pas te percaktohen nevojat per permirsimin ose paisjen e stafit me instrumentat e lartpërmendur. Më poshte po japim nje liste te paisjeve qe ekipi i punes duhet te zoteroje me qellim hartimin e PMPK (1 ekip duhet te perbehet nga te pakten 3 specialiste):

Materialet per punen ne zyre dhe mjetet e nevojshme	Materiale per punen ne terren
Te pakten 1 kompjuter + 1 printer (me mire ne formatin A3 me ngjyra)	Makine 4x4
Lidhje me Internet (me cilesi te mire)	Klinometer
Te pakten 1 tablet (me veshje mbrojtese)	hipsometer
Software per menaxhimin e te dhenave (OpenForis, perpara se SISP te jete funksional)	Ph meter
Kamera ose telefon celular	Tryele
GPS	2 diameter mates 80 cm
	1 busull, 2 meter-shirit 30 m
	1 peshore, per peshimin e barit ne kullota

Eshte e nevojshme qe te kontrollohet cilesia dhe shpejtesia e Internetit dhe disponibiliteti i programeve dhe kompjuterave per perpunimin e te dhenave dhe pergatitjen e hartave.

A.3. CAKTIMI I DETYRES PER HARTIMIN E PLANIT TE Mbareshtrimit TEK STAFI OSE TEK EKSPERTET PRIVATE

Pas kryerjes se vleresimeve te mesiperme, Bashkia duhet ti caktojte stafit te saj detyren per fillimin e punes per hartimin e planit te mbarështrimit për pyjet dhe kullotat. Në të kundert bashkia mund te kerkoje eksperte te jashtem te cilet kane aftesite profesionale te nevojshme duke bere te mundur edhe angazhimin e stafit lokal per te arritur rezultate sa me te mira. Ekspertet e jashtem mund te jene individe ose kompani konsulente te licensuar nga MMT dhe te regjistruar ne QKL/QKB dhe qe kane eksperience ne hartimin e planeve te mbareshtrimit⁵. Kontrata me ekspertet e jashtem duhet te percaktojte saktesisht detyrat dhe pergjegjesite e paleve ne kete proçes. Po keshtu eksperti qe do te anagzhohet ne proçesine pjesmarries mund te jete ekspert i jashtem.

Per te bere te mundur vleresimin e koston per hartimin e planit te mbareshtrimit ne Aneksin 1 jepet nje model (ne formatin Excel) i cili mund te adaptohet sipas nevojave lokale. Aneksi 2 eshte nje model i Termave te References per Percaktimin e Detyres per Hartimin e PMPK nga ekspertet e kjashtem e cila edhe ajo mund te ndryshoje ne perputhje me nevojat lokale.

⁵ - Ligji nr.10 081, date 23.2.2009 "Per licensimin, autorizimin dhe paisjen me leje ne Republiken e Shqiperise"

- VKM Nr.538, date 26/05/2009 "Per licensimin dhe paisjen me leje nga Qendra Kombetare e Licensimit", licensa e kategorise III.7 "Shfrytezimi dhe mbareshtimi i flores (tokesore dhe ujore)"

- Propozimi Nr 100 ,date 08/05/2009 i Ministririt te Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave.

B. PROÇESI I PJESËMARRJES

Pyjet dhe kullotat sigurojnë një shumëllojshmeri shërbimesh dhe janë burime mjaft të rëndësishme për komunitetet lokale dhe shoqërinë në Shqipëri. Ruajtja e pyjeve dhe e funksioneve të tyre është mjaft e rëndësishme dhe kjo mund të arrihet nepermjet një qeverisje të qëndrueshme duke harmonizuar dimensionet sociale, ekonomike dhe ekologjike bazuar në pjesëmarrjen e të gjithë aktoreve ose paleve të interesuara. Qasja për pjesëmarrjen synon që të përfshijë të gjithë aktorët në procesin e vendimmarrjes për mbareshtrimin e pyjeve dhe kullotave, përdorimin dhe mbrojtjen e tyre duke siguruar një balance midis përdorimeve të ndryshme nepermjet një qasje shumëfunktionale të mbareshtrimit të pyjeve dhe kullotave. Përgjegjësia për organizimin dhe menaxhimin e **Proçesit të Pjesëmarrjes** është e Bashkisë dhe e stafit pyjor lokal me përfshirjen në të gjitha hapat të ekspertëve të caktuar për hartimin e planit të mbareshtrimit. Organizimi dhe menaxhimi i proçesit të pjesëmarrjes duhet të nisë menjëherë pas nënshkrimit të kontratës për hartimin e planit të mbareshtrimit (shiko rrjedhën e punës në Tabelën 2). Sfondi, parimet dhe hapat e proçesit të pjesëmarrjes për hartimin dhe zbatimin e PMPK përshkruhen në Aneksin 3, duke iu referuar rrjedhës së punës në Tabelën 2.

C. PUNA PËRGATITORE

Për të filluar proçesin e hartimit të Planit të Mbareshtrimit të Pyjeve dhe Kullotave është e nevojshme që të përcaktohen dhe përshkruhen aktivitetet e para në nivel bashkie dhe në ngarkim të ekspertëve të pyjeve për përgatitjen e këtij plani.

C.1. GRUMBULLIMI I DOKUMENTAVE DHE TË DHENAVE NGA PLANET E VJETRA TË MBARËSHTRIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

Ekspertët përgjegjës për hartimin e planit duhet të grumbullojnë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm që lidhet me ekonominë pyjore që do të mbareshtrohet si:

- planin e mëparshëm të mbareshtrimit të pyjeve dhe kullotave (komunale apo shtetërore)
- hartat e mbareshtrimit ose të inventarizimit të mëparshëm në shkallën 1:25,000 ose 1:10,000
- studime të kryera më herët për ekonominë pyjore
- informacione dhe dokumenta që lidhen me Planin e Zhvillimit të Territorit të Bashkisë i ashtequajtur "Plani i Përgjithshëm Lokal i Bashkisë"
- informacion mbi të dhënat demografike, të drejtat e përdorimit, tregjet lokale të produkteve drusore dhe jodrusore, kullosore etj.
- informacion mbi turizmin, edukimin dhe aktivitetet rekreacionale

Është e rëndësishme që të grumbullohen hartat për të gjithë zonën e ekonomisë pyjore dhe më pas të përcaktohet vendodhja e saj gjeografike brenda kufijve të rinj të bashkisë. I gjithë informacioni do të shërbejë për të kryer një studim paraprak të ekonomisë pyjore që do të mbareshtrohet. Ky studim duhet të përmbajë:

- shtrirjen, kufijtë dhe sipërfaqen e përgjithshme të ekonomisë pyjore dhe kullosore
- karakteristikat e përgjithshme të fondit pyjor (sipërfaqja e veshur me pyll dhe kullota; llojet drusore perberes; klasat e moshës; gjendja e grumbujve pyjorë; rruget që përshkojnë ekonominë pyjore)
- të dhëna të tjera të nevojshme për ekonominë
- hartat pyjore

C.2. NDARJA E EKONOMISE PYJORE NË PARCELA DHE NËNPARCELA

Ndarja në parcela

Përpara fillimit të punës së terrenit, është e nevojshme të përgatitet një draft me hartat baze dhe me rrjetin e sipërfaqeve prove. Shenimet e mëposhtme janë të nevojshme përpara se platforma e informacionit SISIP të

jete funksionale. Në fillim te punes se terrenit nese keni nje harte te mire nga plani i mëparshëm i mbareshtimit (harte topografike me kufij te qarte te parcelave dhe nenparcelave si dhe me vendodhjen e siperfaqeve prove, ku nuk ka diference te madhe ne kufijte e ekonomise ekzistuese pyjore), ju mund ta perdorni ate perpara fillimit te punes se terrenit. Pergatitja e hartes baze duhet te behet ne formatin dixhital dhe perben hapin fillestar te pergatitjes se hartave (shiko seksionin 4 te udhezuesit-Pergatitja e Hartave, detajet grafike).

Projektimi i ndarjes parcelare duhet të bëhet së pari mbi hartën ekzistuese të ekonomise pyjore duke patur parasysh madhesine dhe formen e terrenit dhe me pas duhet te behet verifikimi ne terren. Kufijte me te qarte jane ata natyrale (kulme,lugina,perrenj) dhe kufij artificiale te përhershëm. Parcelat pyjore te shenuara ne harte duhet te verifikohen ne terren dhe ne te njejten kohe duhet te behet shenimi i kufijve me boje vaji duke shenuar druret kufitare. Kufijte e parcelave qe jane njekohesisht edhe kufij ekonomie pyjore shenohen me 2 vija paralele vertikale me gjatesi 20-25 cm, gjeresi 3-5 cm dhe distanca midis vijave eshte 2 cm. Ndersa kufijte midis parcelave pyjore shenohen ne druret kufitare me 1 vijë vertikale. Vendosja e vijave behet ne lartesine 1.5-2 m nga toka. Kur mungojne druret keto shenja vendosen ne gure te medhenj qe ndodhen ne vijen kufizuese te parces pyjore. Distanca midis drureve ku vendosen vijat duhet te jete jo me shume se 50 m dhe vijat duhet te vendosen ne menyre qe te duken njera nga tjetra. Ne disa raste kufijte e parcelave pyjore shenohen me shtylla druri me diameter 20 cm dhe gjatesi 1.5 m. Pjesa e sipërme gdhëndet ne forme trung-piramide ne te 4 faqet. Faqet e shtylles duhet te jene minimumi 16 x 10 cm dhe shtylla ngulet 50 cm ne toke dhe mbulohet per 60 cm lart. Nje tjetër opsion eshte perdorimi i shtyllave prej betoni te cilat kane forme me te thjeshte me 2 faqe te trasha rreth 3-4 cm, ndërsa dimensionet e tjera jane te njejta me ato te shtyllave prej druri. Ngulja e tyre duhet te behet mire ne toke per te mos u shkukur. Faqet e shtyllave orientohen sipas parcelave dhe ne faqen karshi shënohet numri i parcelës pyjore. Numërimi i parcelave pyjore behet me numra sipas ketij rregulli: (i) ne fushë nga jugu drejt veriut dhe nga perëndimi drejt lindjes; (ii) ne kodra dhe male fillon nga gryka e basenit dhe vazhdon sipas drejtimit te akrepave te ores. Pjesa e sipërme e shtylles lyhet krejt me boje vaji qe te jete e dukshme. Madhesite e parcelave pyjore për trungishtet dhe cungishtet ndryshojne sipas formes se terrenit. Me poshte po japim disa te dhena per madhesine e parcelave pyjore:

- ✓ zona fushore deri 20 ha
- ✓ zona kodrinore deri 30 ha
- ✓ zona malore deri 50 ha

Ndarja në nënparcela

Nënparcelat pyjore jane njësi homogjene me madhesi minimale 0.5 ha. Ndarja ne nenparcela behet gjate pershkrimin parcelar sipas ketyre kriterëve: (i) kriterë stacionale (boniteti i stacionit ose prodhimtaria); (ii) kriterë silvikulturore (origjina,forma e qeverisjes,trajtimi); (iii) kriterë te grumbujve (tipi i grumbullit dhe perberja e llojeve,klasa e moshes,faza e zhvillimit). Kufijte e nënparcelave shënohen ne druret kufitare me boje vaji me 1 vije horizontale ne te dy anet me dimensione 3 x 3 cm. Ne vend kryqëzimet e kufijve të nënparcelave druret e afërt shënohen me bojë ne forme unazore. Në harte nenparcelat shenohen me germa te vogla te alfabetit dhe ne kete manyre secila nënparcele shenohet me numrin e parcelës dhe shkronjën perkatese psh: (5b).

Për te kryer dixhitalizimin e hartave dhe ndarjen ne parcela e nenparcela duhet te ndiqet kjo rradhë pune:

- grumbullohen hartat e Ekonomise Pyjore nga plani i vjeter i mbareshtimit dhe behet dixhitalizimi i kufijve duke krijuar nje shtrese te re dixhitale.
- ne 2 shtresa te ndryshme te dixhitalizohen kufijte per parcelat dhe nenparcelat pyjore
- ne nje shtrese tjetër duhet te dixhitalizohet rrjeti i siperfaqeve prove. Nese rrjeti i siperfaqeve prove eshte ne harten e vjeter mund te perdoret, ose perndryshe duhet te ndertohet nje rrjeti i ri.Rrjeti i siperfaqeve prove duhet te jete unik ne te gjitha planet e mbareshtimit te ekonomive pyjore dhe duhet te ndertohet ne sistemin kordinativ kartezi 2 dimensional-UTM.Nje mundesi tjetër per ndertimin e rrjetit te siperfaqeve prove eshte ai bazuar ne rrjetin kilometrik te hartes topografike 1000 x 1000 m, ne formatin dixhital ose te pakten ne formatin raster.
- duke mbivendosur shtresat e meparshme ne harten topografike ndertohet rrjeti baze i siperfaqeve prove te perhershme [200 x 200 m].

Kjo harte mund te ngarkohet ne laptop, ne telefon celular, ose mund te printohet ne formatin leter. Ato duhet te perdoren ne shkallen me te pershtatshme per zona te caktuara te ekonomise pyjore dhe mund te pergatitet ne GIS (shiko Standartin 1).

C.3. HYRJA E PLANIT TE RI TE Mbareshtimit NE SISP DHE MENAXHIMI I PROCESIT TE PUNES

Stafi i Pyjeve te Bashkise duhet te gjeneroje ne SISP:

- a. te dhenat e planit te ri te mbarështrimit të pyjeve dhe kullotave
- b. të ngarkoje informacionin e planit të mbarështrimit dhe të bëj ruajtien e tij.

Hartimi i PMPK dhe hedhja e tij ne SISP duhet te kryhet sipas kesaj rruge:

- 1) **Bashkia(BA)** duhet te verifikoje nevojën per te hartuar nje PMPK te ri per nje ose disa ekonomi pyjore dhe me pas ne SISP duhet te njoftoje fillimin e punes per hartimin e planit te ri te mbarështrimit.
- 2) **Konsulenti** duhet te gjeneroje planin e ri te mbarështrimit
 - a. te editoje parcelat dhe nenparcelat e ekonomise pyjore respektive
 - b. te siguroje informacionin e nevojshem qe kerkohet
 - c. te miratoje informacionin e ngarkuar duke siguruar korrektesine dhe përputhshmërinë
- 3) te dorëzoje per miratim ne BA planin e mbarështrimit te pergatitur
- 4) **Bashkia** duhet të kontrollojë aktivitetet që janë pjese e planit te mbarështrimit
 - a. te kontrolloje saktesine dhe perputhshmerine e informacionit te futur ne SISP
 - b. te beje pranimin e PMPK

Etapat e ndryshme te ketij procesi (njoftimi; rregullimi/editimi; miratimi dhe publikimi) duhet te raportohen dhe te kene nje status korrespondues ne PMPK. Kur plani i ri eshte krijuar, statusi i tij do te jete "Editim/ rregullimi " dhe kur rregullimi ka perfunduar statusi i tij eshte "miratim". Ne momentin kur BA pranon planin e mbarështrimit, atehere ajo do te kete statusin "i pranuar" dhe pas publikimit te vendoset statusi "i publikuar".

C.4. KONTROLLI I TRANSFERIMIT TË DHËNAVE TEK SISP DHE SHFAQJA NE WEB

Ekspertët përgjegjes për hartimin e planit duhet te kontrollojnë disponueshmërinë e materialeve hartografike dhe fotografike per pergatitjen e hartave te planit si dhe te dhenat baze per fillimin e punes. Te dhenat nga Kadastra Pyjore, hartat topografike, ortofotot etj mund te transferohen direkt nga platforma e informacionit pyjor shqiptar (SISP). Ortofotot dhe hartat topografike gjenden ne faqen e Autoritetit Shtetëror te Informacionit Gjeohapsinor (www.asig.gov.al) dhe mund te perdoren per pergatitjen e hartave dhe për të siguruar njohuritë përkatse për gjëndjen aktuale të territorit të ekonomisë pyjore.

D. PUNA NE TERREN

D.1 PËRGATITJA PËR PUNËN NË TERREN

Kjo faze ka si qellim kryerjen e nje studimi mbi ekonomine pyjore duke u fokusuar ne :

- studimin e kufijve te ekonomise pyjore dhe percaktimin e siperfaqes totale pyjore
- karakteristikat e pergjithshme te fondit pyjor sipas planeve të meparshme të mbarështrimit ose nga hartat e dixhitalizuara
- hartat ekzistuese në shkallën 1:25 000, ose fotot ajrore
- planifikimi i punës së matjeve në terren dhe përcaktimi i pozicionit te ekipeve te punes
- grumbullimi i te dhenave shtese (te dhenat mbi klimen,token etj)

Puna ne terren duhet te filloje ne Maj dhe vazhdon deri ne Tetor dhe ne varesi te kushteve te motit mund te filloje me heret dhe te mbaroje me vone.

D.1.1 PËRBËRJA E EKIPIT TË PUNËS

Secili nga ekipet e punes se terrenit duhet te perbehet nga 2 specialiste profesioniste (inxhinjere pyjesh) dhe 1 specialist teknik pyjesh (ekspert ne punen e terrenit). Kjo eshte perberja minimale e 1 ekipi qe do punoje ne terren. Do ishte mire qe te ishte edhe nje ekip tjetër me te njejten numer anetaresh dhe aftesish profesionale. Ne rastin e zonave specifike dhe ne varesi te veshtiresive te terrenit eshte mire qe te kemi me shume gupe pune ne terren. Kordinimi i aktiviteteve eshte nje nga detyrat qe duhet te kryeje Drejtuesi i Punes ne Terren.

D.1.2 RIKONJICIONI I TERRENIT

Ne fillim te nisjes se punes se terrenit specialistet pergjegjes per hartimin e PMPK (personi pergjegjes i Bashkise, inxhinjeri lokal i pyjeve, kontraktori dhe Drejtuesi i Punes ne Terren) duhet te bejne nje vizite ne terren ne ekonomine pyjore per te vleresuar gjendjen aktuale dhe te percaktojne permbajtien dhe parimet ku do bazohet plani i mbarështrimit. Gjate punes në terren është e domosdoshme qe te kryhen vizita periodike ne terren dhe te behen kontrole nga personi pergjegjes i Bashkise dhe nga aktore lokal te interesuar(bura dhe gra), te percaktuar ne takimin e pare te procesit te pjesmarrjes me qellim diskutimin e problemeve te ndryshme dhe qartesimin e zgjidhjeve. Ne fund te punes se terrenit duhet te organizohet nje vizite e perbashket ne terren me te gjithë grate dhe burrat e perfhsire ne te gjitha fazat e procesit te pjesmarrjes. Rezultatet kryesore duhet te prezantohen, problemet me kryesore duhet te diskutohen duke percaktuar strukturen e draftit te planit te mbarështrimit.

D.1.3 VENDOSJA E RRJETIT TE SIPERFAQEVE PROVE NE ORTOFOTO OSE NE HARTEN E RE TE MBULESES SIPAS INVENTARIT KOMBETAR TE PYJEVE (IKP)

Proçesi i meparshëm identifikon kufijte dhe vendodhjen e siperfaqeve prove bazuar ne gjendjen e planit te vjeter te Mbareshtimit. Ka te ngjare qe gjendja aktuale e siperfaqes pyjore te ekonomise (pyjeve, kullotave, shkurreve) te jete e ndryshme duke bere qe te ndryshoje shperndarja e siperfaqeve prove ose masat qe duhet te zbatohen (psh: masat ne nje grumbull pyjor jane te ndryshme nga masat ne shkurre).

Perpara se te behet nje kontroll nepermjet rikonjicionit ne terren eshte mire qe te behet nje perditesim per gjendjen e pyjeve dhe kjo duke perdorur ortofotot qe jane te vlefshme nga Agjensia e Informacionit Hapsinor (ASIG) ne formatin dixhital. Duke mbivendosur shtresat e kufijve dhe rrjetit te siperfaqeve prove ne ortofoto ju mund te kontrolloni ndryshimet ne vendodhjen e siperfaqeve prove. Ne SISP eshte e mundur qe te punohet direkt me hartat e reja nga IKP duke bere edhe kontrollin e diferences midis gjendjes aktuale te mbuleses dhe asaj ne te shkuaren ne shkalle vjeterore ose midis viteve te ndryshem.

D.1.4 PUNA ME HARTAT DHE PLANIFIKIMI I ECURISE SË SAJ

Përpara fillimit të punes, çdo ditë ekipi i terrenit duhet të kontrollojë paisjet sipas listes, por edhe hartën e punës në terren (harta me të gjithë kufijtë, rrjetin e sipërfaqeve prove) në një shkallë të pershtatshme dhe planin për grumbullimin e të dhënave brenda sipërfaqeve prove.

D.1.5 KONTROLLI I GPS, TABLETËVE DHE REGJISTRIMI I LISTES SE SIPERFAQEVE PROVE

Përpara fillimit të ditës së punës, është e nevojshme të bëhet kontrolli i paisjeve të nevojshme si: GPS dhe tabletët nëse janë në gjendje pune apo jo. Ekipi i punës duhet të regjistrojë në GPS në formatin UTM koordinatat e sipërfaqeve prove që do të inventarizohen. Në rastet e tjera është e nevojshme të jenë gati edhe paisjet e tjera si: busulla, shiritmetri etj, ose kopje në letër e hartës së punës dhe planit të punës.

D.1.6 PLANIFIKIMI PËR TË ARRITUR SIPERFAQET PROVE

Planifikimi për të mbërritur tek sipërfaqet prove duhet të bëhet fillimisht në hartën e ekonomisë pyjore. Në këtë hartë të gjitha sipërfaqet prove, rrugët dhe zonat urbane duhet të jenë të specifikuar. Pas identifikimit të drejtimit të transferimit për të mbërritur sipërfaqet prove, në kombinim me hartat topografike, duhet të zgjidhet mundësia më e shkurtër dhe më e sigurtë për të arritur në destinacion. Kontrolli i GPS dhe i listës së sipërfaqeve prove duhet të shërbejë si pikë e fillimit.

D.2. PERSHKRIMI PARCELAR

D.2.1. HYRJE

D.2.1.1 Struktura e pershkrimit parcelar

Struktura e pershkrimit parcelar duhet të ndjehet këtu kuader logjik:

- I. Të dhënat identifikuese
- II. Pershkrimi i stacionit
- III. Gjendja e pyjeve, shkurreve dhe kullotave
- IV. Objektivat dhe planifikimi i masave
 1. Pyjet dhe kullotat
 2. Infrastrukturat

D.2.1.2 Të dhënat parcelare dhe lidhja me Kadastren Pyjore dhe SISP

Derisa SISP të jetë operacional, rikonfigurimi i programit MS Access i përdorur deri tani për planet e mbarestrimit do të jetë një mundësi e ndërmjetme. Ai duhet të sigurojë lidhjen me të dhënat e Kadasitres Pyjore me qëllim që informacioni tashmë i regjistruar të përdoret në fazën e hartimit të PMPK. Lidhja midis të dhënave të pershkrimit parcelar në PMPK dhe SISP do të konsistojë në hapat e mëposhtme:

- 1) përditesimin e shtresave baze të Kadasitres Pyjore: përcaktimi/rikonfigurimi i kufijve të parcelave dhe nënparcelave të ekonomisë pyjore (do synohet të ruhen të pandryshuar kufijtë ekzistues të parcelave pyjore)
- 2) futja/përditesimi i bazës së të dhënave të Kadasitres Pyjore e Kullësore (në SISP ky entitet njihet me emërtimin Baza e të Dhënave të Gjendjes së Pyjeve (GJP-db) lidhur me parcelat/nënparcelat e ekonomisë pyjore.

Përditesimi i shtresave baze të Kadasitres Pyjore përfshin veprimet e mëposhtme:

- 1) Futja si Konsulent dhe sigurimi i aksesit për të përcaktuar hartimin e PMPK
 - a. hyrja në sistem
 - b. kontrolli i PMPK i përcaktuar
 - c. zgjidhet plani që do hartohet

- d. berja e mundur e funksionaliteteve per te edituar shtresat baze te kadastrës dhe bazen e te dhenave
- 2) Paraqitja e shtresave baze te kadastrës tek eksperti i GIS bazuar tek imazhet satelitore apo burime ndihmese te ekspozuara nepermjet sherbimeve web, ose qe ekzistojne ne formatin "shape file"
- 3) Zgjidhen objektet, shikohen dhe rregullohen atributet e tyre
- 4) Gjenerohen parcelat/nenparcelat duke filluar nga ekonomia pyjore ose objektet te tjera parcelare.

Veprimet e mundshme jane:

- a. Zgjidhet nje objekt i ekonomise pyjore dhe dyfishohet si nje parcele. Objekti i ri do te rezultojte si nje objekt i vetem i zgjedhur ne harte.
- b. Zgjidhet nje parcele dhe ndahet ne 2 pjese duke perdorur nje vije dhe duke gjeneruar ne kete menyre 2 parcela te reja. Keto 2 objekte do te jene te vetmet te perzgjedhura ne harte.
- c. Gjenerohet nje parcele e re nepermjet bashkimit te 2 ose me shume parcelave ekzistuese. Objekti qe do krijohet do te jete i vetmi i zgjedhur ne harte.

Futja apo perditësimi i bazës së të dhënave të Kadastrës Pyjore në lidhje me parcelat/nenparcelat e ekonomise pyjore dhe parcelat e perfshira ne PMPK do te perfshije keto veprime:

- 1) Zgjidhet nje parcele/nenparcele ne harte ose zgjidhet kodi i saj nepermjet nje liste dhe sigurohet aksesi ne informacionin e bazës së të dhënave të kadastrës per kete parcele/nenparcele.
- 2) Editohen/rregullohen atributet ne bazen e të dhënave të kadastrës

D.3 TE DHENA PER MENYREN E INVENTARIZIMIT

D.3.1 PERSHKRIMI I METODES SE INVENTARIZIMIT DHE VENDOSJES SE RRJETIT TE SIPERFAQEVË PROVE

D.3.1.1 Konsiderata te pergjithshme


Inventarizimi i grumbujve pyjore është aktiviteti i grumbullimit të të dhënave që ndikon në gjenerimin e informacionit baze të nevojshëm të burimeve pyjore brenda zonës së interesit. Është një mjet që siguron informacion për madhësinë dhe formën e sipërfaqes prove si dhe grumbullimin e informacionit cilësor apo sasior për grumbullin pyjor. Ai siguron një informacion të sigurtë për druret brenda sipërfaqeve prove. Perfaqson përpjekjen për të përshkruar shpërndarjen sasiore dhe cilësore të diametrave të drurëve si dhe mjaft karakteristika të tjera të tokës ku rriten druret. Informacioni i inventarizimit pyjor përftohet, ose nga matjet e drurëve individuale, ose të grumbujve pyjore. Ky informacion mund të sigurohet nga matjet në terren të kombinuara me imazhet satelitore, fotot ajrore etj. Inventarizimi i plotë i grumbujve pyjore është i pamundur, prandaj inventarizimi i bazuar në kampionimin (inventarizimi me zgjedhje) është gjerësisht i përdorur. Inventarizimi periodik i ekonomive pyjore na siguron të dhëna të sakta në lidhje me ndryshimet në grumbullin në këmbë dhe rritjen e grumbujve pyjore midis dy periudhave të njëpasnjëshme të matjeve.

D.3.1.2 Planifikimi i inventarizimit dhe përshkrimi i rrjetit të sipërfaqeve prove

Inventarizimi i pyjeve i referohet matjes së parametrave të drurëve dhe grumbujve pyjore si dhe analizës së volumit dhe rritjes së pyjeve. Ai bazohet në kampionimin ose matjen e sipërfaqeve prove. Opsione të ndryshme për skemën e vendosjes dhe vrojtimit të sipërfaqeve prove ekzistojnë, por vendosja sistematike është më e përdorura për grumbullimin e të dhënave nga druret dhe grumbujt pyjore. Vendosja sistematike e sipërfaqeve prove ka këto avantazhe:

- planifikohet lehtësisht
- vendosja e sipërfaqeve prove bëhet shpejt dhe ka kosto të vogël
- jep një vlerësim më të mirë të mesatares sesa zgjedhja e rastit dhe madje edhe se zgjedhja e rastit me shtresëzim në rastin e zonave të mëdha pyjore, sepse variacioni i cili mund të jete mjaft i madh në këto zona përfaqësohet më mirë pasi sipërfaqet prove shpërndahen në të gjithë zonën pyjore.
- jep një vlerësim më të saktë (ka precizion më të mirë) sesa zgjedhja e rastit

Bazuar në eksperiencën e deritanishme vendosja e sipërfaqeve prove duhet të bëhet në baze të rrjetit kilometrik 1000 x 1000 m të hartave pyjore.




D.3.1.3 Inventarizimi me sipërfaqe prove të përhershme dhe të përkohshme

Vendosja sistematike e sipërfaqeve prove nga pikpamja statistikore është e sigurtë dhe përdoret gjerësisht në rastin e inventarizimit në nivel grumbullimi pyjor. Matja e përsëritur me zëvendësim të pjesshëm të sipërfaqeve prove e cila nënkupton kombinimin e sipërfaqeve prove të përhershme dhe të përkohshme është metoda që do përdoret për inventarizimin e grumbujve pyjorë. Korelacioni pozitiv që ekziston midis atributëve në sipërfaqet fillestare dhe ato të fundit do të rrisë precizionin në vlerësimin e ndryshimeve në ekonomitë pyjore pa ndryshuar koston. Nëse përdoren foto ajrore me rezolucion të lartë ose imazhe satelitore për një ekonomi pyjore të caktuar, të gjitha sipërfaqet prove është mirë që të vendosen në to duke siguruar një bazë referençe të mirë për vendosjen e tyre në terren. Veç kësaj sipërfaqet prove duhet të vendosen edhe në hartat pyjore të cilat përdoren nga ekipet e punës në terren.

Metodologjia për krijimin e rrjetit të sipërfaqeve prove jepet më poshtë:

1. Rrjeti kilometrik i hartave topografike (1000 x 1000 m) sipas sistemit koordinativ UTM, është rrjeti bazë referençe për ndërtimin e rrjetit sistematik të sipërfaqeve prove të vendosura në intervale uniforme.
2. Rrjeti i sipërfaqeve prove duhet të orientohet sipas drejtimit Veri/Jug dhe Lindje/Perendim
3. Rrjeti kilometrik dendësohet duke u ndarë në intervale uniforme. Në këtë mënyrë sipërfaqet prove të përhershme do të vendosen sipas një rrjeti 200 x 200 m (intensiteti i kampionimit 1 sipërfaqe prove në 4 ha). Në këtë mënyrë një kuadrat i rrjetit kilometrik do të ndahet në 25 njësi katrore (200 x 200 m). Ky rrjet është unik për mbareshtrimin e të gjitha ekonomitë pyjore.
4. Nëse kërkohet një nivel saktësie edhe më i lartë rrjeti i mesipërm dendësohet edhe me shumë çdo 100 m ose 50 m. Në këtë mënyrë në rrjetin e dytë të sipërfaqeve prove 100 x 100 m (1 sipërfaqe prove për 1 ha) ose 50 x 50 m (1 sipërfaqe prove për 0.25 ha) do të vendosen sipërfaqet e përkohshme.
5. Në rastin e nënparcelave me madhësi 0.5 ha, specialisti duhet të përdorë rrjetin 50 x 50 m (1 sipërfaqe prove për 0.25 ha) për sipërfaqet e përkohshme.
6. Vendosja dhe matja e sipërfaqeve prove të përkohshme do të bëhet vetëm në rast se kërkohet një saktësi më e madhe dhe nëse shtimi i sipërfaqeve prove do të jetë efektiv nga pikpamja e koston.



- ✓ vijat e holla përfaqsojnë rrjetin e sipërfaqeve të perkohshme (100 x 100 m ose në raste të veçanta kur sipërfaqja e nengatsrave është shumë e vogël mund të jetë 50 x 50 m)

Numri i sipërfaqeve të provës llogaritet përpara se të fillojë puna në terren dhe tregon numrin e vrojtimit të nevojshëm për të arritur një nivel saktësie dhe precizioni të caktuar. Për këtë qëllim sipërfaqja e ekonomisë pyjore duhet të ndahet fillimisht sipas formës së qeverisjes dhe më pas secila formë qeverisje ndahet në njësi homogjene sipas: (i) tipit të pyllit ose (ii) klases së moshës. Llogaritja e numrit të sipërfaqeve të provës bëhet sipas ekuacionit të mëposhtëm:

$$n = \frac{t^2 \cdot S_{\%}^2}{\Delta_{\%}^2}$$

- ku: t^2 -parametri i Shpërndarjes Student ($t=2$; $P<0.05$)
 $S_{\%}$ - koeficienti i variacionit (e.g. 30% për nënshtresën tip pylli/klase moshë)
 $\Delta_{\%}$ – gabimi i lejuar (shiko tabelën 1)

Në këtë rast metoda e përdorur për llogaritjen e gabimit bazohet në analizën e variancës duke përdorur diferencën e vrojtimit në sipërfaqet të provës të përhershme të cilat janë të njëjta njësi të provës në të 2 inventarizimet e nejpasnjeshme.

Shembulli i mëposhtëm tregon mënyrën për llogaritjen e numrit të sipërfaqeve të provës:

$$S_{\%} = 30\%; t=2; \Delta_{\%} = 10\%$$

$$n = \frac{t^2 \cdot S_{\%}^2}{\Delta_{\%}^2} = \frac{2^2 \cdot 30^2}{10^2} = 36$$

Tabela 1.

Treguesit statistikore për llogaritjen e numrit të sipërfaqeve të provës sipas formës së qeverisjes, tipit të pyllit dhe klases së moshës.

Forma e qeverisjes	Kriteret	Shtresa/nënshtresa	Gabimi standart ($\Delta_{\%}$)	Madhësia e sipërfaqeve të provës	Limiti i Diam bazimetrik	Shënime
Trungishte	- Volumi -Nr drurëve -Rritja e specieve kryesore	-Tipi i grumbullit pyjor -Klasa e moshës	< 10% <20%	(400 m²)	> 27.5 cm	Për filizimin me $d < 2$ cm duhet vetëm numerimi
				(200 m²)	7.5-27.5 cm	
				(25 m²)	2-7.5 cm	
Cungishte	- Volumi -Nr drurëve -Rritja e specieve kryesore	-Tipi i grumbullit pyjor -Klasa e moshës	< 10%	(400 m²)	> 27.5 cm	Nuk do matet as azimuti as distanca
				(200 m²)	7.5-27.5 cm	
				(25 m²)	2-7.5 cm	
Trungishte e përbere	- Volumi -Nr drurëve -Rritja e specieve kryesore	-Tipi i grumbullit pyjor -Klasa e moshës	T < 20% C < 10%	(400 m²)	> 27.5 cm	Nuk do matet as azimuti as distanca
				(200 m²)	7.5-27.5 cm	
				(25 m²)	2-7.5 cm	
Cungishte e përbere	- Volumi -Nr drurëve -Rritja e specieve kryesore	-Tipi i grumbullit pyjor -Klasa e moshës	C < 10% T < 30%	(400 m²)	> 27.5 cm	Nuk do matet as azimuti as distanca
				(200 m²)	7.5-27.5 cm	

				(25 m ²)	2-7.5 cm	
Kullota	-Siperfaqja -Mbulesa e vegetacionit	-kullota -kullota me drure dhe shkurre	10-20% siperfaqes	25 m²	asnje	Informacion i detajuar per siperfaqen kullosore
Shkurre	-Siperfaqja -Numri individeve -Specia	shkurret	10-20% siperfaqes	25 m²	asnje	Informacion i pergjithshem per grumbullin - lartesia dominante dhe mesatare -mosha

Nese numri i siperfaqeve prove per 1 shtrese nuk eshte i mjaftueshem atehere ky numer mund te rritet duke marre siperfaqe prove shtese:

- duke marre siperfaqe te perhershme nese numri i siperfaqeve prove eshte me pak se 70% e numrit te kerkuar te siperfaqeve prove
- siperfaqe prove te perkohshme ne te gjitha rastet e tjera

Fraksioni i kampionimit ne rastin e siperfaqeve prove te vendosura ne menyre sistematike ne intervale uniforme duhet te jete 10%⁶. Metoda jep mundesine per te llogaritur ndryshimin e volumit dhe rritjen e grumbujve ne saje te krahasimit te çifteve te siperfaqeve prove te perhershme midis matjeve te njepasnjeshme. Numri minimal i siperfaqeve prove sipas siperfaqes se grumbullit pyjor duhet te jete:

Siperfaqja e grumbullit pyjor (ha)	< 4 ha	4-10 ha	> 10 ha
Numri minimal i siperfaqeve prove	5 siperfaqe prove	7 siperfaqe prove	10 siperfaqe prove

Nese saktesia e kerkuar nuk arrihet me kete numer minimal siperfaqesh prove per te llogaritur numrin e nevojshem te siperfaqeve prove perdorni ekuacionin ne seksionin D.3.1.3.

D.3.1.4 Tipi dhe madhesia e siperfaqeve prove

Secila siperfaqe prove do te perbehet nga 3 siperfaqe rrethore bashkqendrore me madhesi 25 m², 200 m² dhe 400 m². Kjo forme e organizimit te siperfaqeve prove synon qe te mbuloje variacionin e dimetrave ne grumbullin pyjor.

- Siperfaqja e pare rrethore me madhesi 25 m² (r = 2.82 m) do te sherbeje per matjen e rigjenerimit, drureve me diameter bazimetrik (1.3 m nga toka) nga 2.0 - 7.5 cm, vleresimin e produkteve jo-drusore dhe inventarizimin e kullotave
- Siperfaqja e dyte rrethore me madhesi 200 m² (r = 7.98 m) do sherbeje per matjen e drureve me diameter bazimetrik nga 7.51 deri 27.5 cm.
- Siperfaqja e jashtme rrethore me madhesi 400 m² (r = 11.28 m) do te sherbeje per te matur druret me diameter bazimetrik > 27.5 cm.

⁶ Loetsch F, Haller K.E(1973). Forest inventory. Statistics of forest inventory and Information from Aerial Photographs. Vol 1,pg 113.




Figura 2. Siperfaqet rrethore bashkeqendrore qe do perdoren per matjet ne terren

D.3.1.5 Vendodhja gjeografike dhe vendosja e siperfaqeve prove ne terren

Kordinatat e siperfaqeve prove duhet te regjistrohen ne GPS dhe vendosja e tyre duhet te behet ne terren. Pozicionimi i siperfaqeve prove duhet te behet me nje gabim sa me minimal. Per kete arsye te pakten 5 satelite duhet qe te jene te lidhur me GPS per te vendosur saktesisht qendren e siperfaqe prove. Problemi qendron ne gumbujt shume te dendur dhe ne kete rast duhet te kerkohet ne grumbull gjetja e vendeve me pak bimesi ose zonave te hapura ne menyre qe te behet lidhja me satelitet. Perdorimi i GPS dhe i busulles jane te domosdoshem per te percaktuar drejtimin dhe per tu orientuar ne terren per te gjetur pozicionin e sakte te qendres se siperfaqes prove brenda grumbullit pyjor.

D.3.1.6 Shenimi i qendres se siperfaqes prove

Shenimi i qendres se siperfaqes prove te perhershme duhet te behet ne menyre qe te jene permanente me qellim gjetjen e sakte te pozicionit te siperfaqes prove ne inventarizimet e vazhdueshme. Qendra e siperfaqes prove do te shenohet me nje shufer metalike me gjatesi 20-25 cm dhe diameter 3 cm dhe me pas ngulet ne tokes derisa pjesa e sipërme e shufres te jete rrafsh me token. Ne rastin kur shufra metalike nuk futet dot ne toke duhet te vendoset ne nje pozicion sa me afer atij te vertete dhe te matet dhe shenohet ne formular ose tablet distanca dhe azimuti. Per secilen qender siperfaqe prove te pakten 3 pika referimi sa me afer qendres duhet te identifikohen. Per secilen pike referimi, distanca dhe azimuti i pikes fikse nga qendra e siperfaqes prove duhet te maten. Nje pershkrim i shkurter i seciles pike referimi duhet te behet (psh: shkemb, kryqezim rruges, ndertese) dhe vendodhja e saj duhet te vizatohet ne formular. Ne rastin e siperfaqeve prove te perkohshme qendra nuk shenohet me shufer metalike dhe nuk merret asnje pike reference.

D.3.1.7 Siperfaqet prove ne skaj te grumbullit

Ne rastin kur siperfaqet prove vendosen afer kufirit te grumbullit pyjor perdoret metoda Mirazh e dhene nga Schmid dhe Has. Druret qe rriten ne skaj te grumbullit zakonisht rriten ne menyre te ndryshme nga ata qe ne brendesi te grumbullit per shkak te konkuresces se vogel midis drureve. Qendra e siperfaqes prove matet nga kufiri i grumbullit pyjor. E njejta distance matet nga skaji grumbullit dhe jashte tij dhe me pas me te njejten rreze ndertohet nje siperfaqe e dyte prove. Druret qe ndodhen ne zonen e nderprerjes midis 2 siperfaqeve prove rrethore duhet te rimaten 2 here. Kjo duhet te shenohet edhe ne formularin e terrenit.




Figura 3. Metoda Mirazh e perdorur ne siperfaqet prove ne skaj te grumbullit pyjor

D.3.1.8 Matja e variablave te drureve brenda siperfaqeve prove

Variablat kryesore te drureve te matur brenda siperfaqes prove jane: specia, diametri bazimetrik (1.3 m nga toka), lartesia e drureve (lartesia e çdo 4 drureve ne siperfaqe prove psh: 1,5,9,13 etj), mosha (duke perdorur tryelen), volumi, cilesia/klasa e cilesise dhe gjendja shendetsore. Ne rastin e siperfaqeve prove te perkohshme do te regjistrohet vetem informacioni per speciet, diametrin bazimetrik, lartesia, ndersa per siperfaqet e perhershme do regjistrohet i gjithë informacioni i lartpermendur. Proçedura e matjes brenda siperfaqes prove do te jete:

- a. specialisti vendoset ne qender te siperfaqes prove dhe me busull percakton drejtimin e Veriut magnetik
- b. druri i pare nga do filloje matja do te jete ai me afer veriut ose qe ka kendin azimutal me te vogel
- c. specialisti identifikon specien dhe me pas mat diametrin bazimetrik te drurit(1.3 m nga toka) sipas 2 drejtimeve. Ne matjen e pare te diametrin bazimetrik te drurit, vizorja e kalibrit duhet te drejtohet per nga qendra e siperfaqes prove, kurse matja e dyte duhet te kryhet ne nje kend 90° me pozicionin e pare. Diametri bazimetrik i drurit do te llogaritet si mesatare arithmetike e 2 diametrave bazimetrike te matur.
- d. me pas matet lartesia e drureve brenda siperfaqes prove duke perdorur hipsometrin, Vertex ose dendrometrin Suunto (menyra e matjes se lartesisë se drureve jepet ne aneksin e udhezuesit).Specialisti duhet te mase 1 lartesi ne çdo 4 drure brenda siperfaqes prove duke respektuar kete rradhe matje: 1; 5; 9; 13;...).
- e. mosha do te percaktohet ne nivel nenparcele/grumbulli pyjor nepermjet numerimit te rrateve ne cungje te prere ose nga mostrat e marra me tryele. Per te vleresuar moshen e grumbullit pyjor duhet te merren:
 - I. *ne grumbujt pyjore te thjeshte(1 specie) njemoshar merrni 2-5 mostra me treyle nga druret mbizoterues te zgjedhur ne menyre te rastesishme.*
 - II. *ne grumbujt pyjore te perziere merrni 2-5 mostra me treyle per secilen specie nga druret mbizoterues te zgjedhur ne menyre te rastesishme*
 - III. *ne grumbujt pyjore shumemoshare merrni 2-5 mostra me treyle nga drure mbizoterues te zgjedhur ne menyre te rastesishme nga secila klase moshe.*




Figura 4. Menyra e matjeve brenda siperfaqes prove rrethore

Ne dy rastet e para mosha e grumbullit do llogaritet si mesatare arithmetike, ndersa ne rastin e trete mosha e grumbullit do llogaritet si mesatare e ponderuar e moshes se drureve dhe siperfaqes bazimetrike:

Ky informacion do te regjistrohet direkt ne tabletet te cilet do perdoren nga ekipet e terrenit gjate matjeve. Duke marre ne konsiderate veshtiresite e terrenit dhe veshtiresite ne mjedisin pyjor ne sygjerojme perdorimin e tabelteve me veshje (www.ruggedttabletpc.com) ose modele te tjera te pershtatshme. Formularet e terrenit duhet te ngarkohen paraprakisht ne tablete dhe informacioni per druret brenda siperfaqet prove duhet te regjistrohet direkt ne tablet. Informacioni i regjistruar ne tablet per siperfaqet prove do te transferohet dhe perpunohet nepermjet MS Access pas ri-konfigurimit si nje hap i ndermjetem.

D.3.1.9. Tabelat e volumeve

Llogaritja e volumit dhe rritjeve ne volum kryhet nepermjet programit te ri-konfiguruar MS Access i perdorur ne llogaritjen e volumit dhe rritjeve ne planet e meparshme te mbareshtimit si nje hap i ndermjetem derisa SISP te jete operacional. Rikonfigurimi i MS Access duhet te siguroje transferimin e te dhenave nga Kadastra Pyjore dhe me pas edhe drejt SISP kur te jete funksional.Gjate konfigurimit te programit sygjerojme qe te

perdoren ekuacionet e ndertuara ne kuader te IKP 2004 (shih tabelen e meposhtme) si dhe te rishikohen algoritmet ekzistuese per llogaritjen e volumit.

Speciet	Stacioni	Ekuacioni i Volumit
Abies alba	Mat, Gramshi	$V = 0.00894 - 0.40429 * dbh^3 * h + 0.00000334 * h^4 + 16.45303 * dbh^3$
Abies borisii regis	Drenove ,Hotove Llogara	$V = -0.00037178 + 0.28764 * dbh^2 * h + 0.00002815 * h^3$
Pinuspinea Pinus halepensis	Lushnja, Shkodra	$V = -0.00089978 - 0.00329 * dbh^5 * h + 0.33982 * dbh^2 * h + 1.92278 * dbh^3$
Fraxinus sp	Velipoja	$V = -0.00247 + 3.24126 * dbh^2 + 0.00000032 * h^4 + 0.07715 * dbh^2 * h$
Acer sp	Tirana	$V = 0.012 + 26.38906 * dbh^3 - 83.48778 * dbh^5 + 0.07246 * dbh^5 * h$
Quercus sp	Fani i Vogel	$V = 0.02226 - 0.3529 * dbh + 0.5216 * dbh^2 * h - 0.29616 * dbh^3 * h$
Fagus sp	Bishnice, Cukal, Fushe Zeze, Holte, Orgocke, Qarishte, Stravaj, Tal, Uij.	$V = 0.01193 + 0.35466 * dbh^2 * h - 2.30104 * dbh^6 - 0.00000005 * h^4$

Per ato specie kur nuk ekzistojne ekuacionet lokale do ishte e udhes te hartoheshin ekuacione te reja te volumit dhe te integroheshin ne programin **MS Access**, ose mund te perdoren ekuacione nga vende te tjera me kushte te ngjashme me stacionet ku rriten keto specie.

D.3.2 INVENTARIZIMI DHE KAMPIONIMI NE KULLOTA

D.3.2.1 Konsiderata te pergjithshme

Kullotat jane nje komponent i rendesishem i burimeve natyrore dhe vleresimi i tyre eshte konsideruar mjaft i rendesishem ne fazen e hartimit te planit te mbareshtimit. Per te arritur kete qellim matje te sakta duhet te kryhen ne parcelat kullosore duke ndjekur metodologjine e meposhtme.

D.3.2.2 Tipi i inventarizimit dhe madhesia e siperfaqeve prove

Me qellim qe te kemi te dhena sa me te sakta mbi kullotat, rekomandohet qe te inventarizohet rreth 10-20 % e siperfaqes se parceles kullosore. Siperfaqet prove ne kete rast vendosen sipas nje rrjeti 200 x 200 m. Ne rastin e siperfaqeve te vogla kullosore rekomandohet qe rrjeti te jete me i dendur (50 x 50 m) dhe ne pikëprerjet e tij te vendosen siperfaqet prove me madhesi 25 m² (r=2.82 m). Madhesia e siperfaqes prove duhet te korigjohet sipas pjerrtesise se terrenit nese rrezja matet me shiritmeter. Sipas rrezeve te siperfaqes prove ne drejtimin veri-jug dhe lindje-perendim merren 4 siperfaqe prove katrore me madhesi 1 m² (1 x 1 m) secila. Vendosja e rrjetit te siperfaqeve prove do te jete e njejte me ate te pershkruar ne seksionin 1.2.1.2 te udhezuesit.




Figura 5. Siperfaqet prove per inventarizimin e kullotave

D.3.2.3 Matjet brenda siperfaqeve prove

Matjet brenda siperfaqeve prove ne kullota do te konsistojne:

- **Siperfaqja prove 25 m²**
 - identifikimin e specieve kryesore barishtore ne siperfaqen
 - llogaritja e lartesisë mesatare te bimesise barishtore (m dhe decimeter),
 - perqindja e mbuleses (%)
- **Siperfaqet prove 1 m²**
 - kositet bari ne siperfaqe prove kuadratike 1 x 1 m dhe behet peshimi i barit duke ndjekur skemen e figures 3. Brenda siperfaqes prove katrore kositet bari dhe vendoset ne nje çante. Etiketohet çanta per te ditur se nga cila kullote eshte marre bari. Duhet te kositen te pakten 10-20% e siperfaqeve prove brenda siperfaqes se kullotes.
 - llogaritjet koeficienti i perdorimit te kullotes ku matja e peshes se barit do te kryhet ne 2 periudha (ne fillim te periudhes se kullotjes dhe ne fund te sezonit te kullotjes). Per te llogaritur kete tregues ekipi duhet te kosise vetem 10% te numrit te siperfaqeve prove. Diferenca ne peshen e thate midis dy matjeve ose perqindja e reduktimit te volumit te barit perben sasine e barit te perdorur nga kafshet. Ky tregues na sherben per te llogaritur numrin e kafsheve qe mund te kullosin ne kullote.
 - llogaritja e numrit dhe intesitetit te zjarreve dhe pranise se gureve

D.4. INFORMACIONI MBI SIPERFAQET PROVE (PYLL & SHKURRE)

D.4.1 TE DHENAT IDENTIFIKUESE

I. Bashkia

Perkufizimi: Emri i Bashkise dhe kodi i saj sipas Kadastres Pyjore. Ky kod duhet te gjenerohet edhe ne SISP dhe duhet te perputhet kur PMPK te futet ne sistem.

Specifikimi: Emri i plote i Bashkise dhe kodi i SISP (per shembull me 3 numra, si 123)

II. Ekonomia Pyjore/Njesia e Menaxhimit

Perkufizimi: Emri i Ekonomise Pyjore dhe Kullosore sipas Kadastres Pyjore dhe kodi i saj i atribuar nga SISP ne momentin e futjes se PKPM ne sistem.

Specifikimi: Emri i plote i Bashkise dhe kodi i SISP (per shembull 3 vlera, si 321)

III. Data dhe Koha

Perkufizimi: Eshte data ne te cilen punet e terrenit jane kryer

Specifikimi: data duhet te shenohet ne kete menyre:

- dita (2 numra—per shembull 01=dita e pare e muajit)
- muaji (2 numra—per shembull 01=janar)
- viti (4 numra—per shembull 2018)

IV. Anetaret e Ekipit te Punes

Perkufizimi : Emrat e pjestareve te ekipit te punes ne terren duhet te shenohen. Te shenohen emrat e personave qe kryejne punen e terrenit ne siperfaqet prove specifike dhe qe jane pergjegjes per plotesimin dhe saktesine e matjeve.

Specifikimi:

1. Emri i drejtuesit te skuadres se punes ne terren duhet te shenohet. Drejtuesi ka pergjegjesine per te korrigjuar ekzekutimin e punes ne terren ne perputhje me procedurat dhe perkufizimet e attributeve te dhena ne Manualin e Punes ne Terren. Ai ploteson formularet dhe i kontrollon ata per saktesine e regjistrimit.
2. Emri i personelit ndihmes te skuadres se punes ne terren duhet te shenohet. Stafi ndihmes eshte pergjegjes per matjet e sakta.

V. Numri i parceles dhe kodi i nenparcelave

Perkufizimi: është numri i parcelës sipas kadastrës pyjore; në rastin e planit të ri, vendoset një numër i ri. Është i njëjti koncept për kodin e nenparcelave (me shkronjë).

Specifikimi: numri i parcelave duhet të shenohet me 3 numra (për shembull: 003, 023, 123) dhe kodi i emertimit të nenparcelave me shkronjë (për shembull a/b/c etj.)

VI. Numri i sipërfaqeve prove

Perkufizimi : është numri i sipërfaqes prove i përdorur në Hartën Dixhitale të Pyjeve ose në imazhet satelitore që korrespondojnë me rrjetin e sipërfaqeve prove.

Specifikimi: numri i sipërfaqes prove duhet të shenohet në formatin (leter ose dixhital) me 3 vlera (për shembull 028)

VII. Sipërfaqet prove të përhershme ose të perkohshme

Perkufizimi: Tipe të ndryshme të sipërfaqeve prove

Specifikimi: Lloji i sipërfaqeve prove duhet të shenohet me shkronjë të madhe (**P** për të përhershme dhe **T** për të perkohshme).

D.4.2 MATJET DHE TË DHENAT E MBLEDHURA NË SIPËRFAQET PROVE–PYLL

I. Rrezja e sipërfaqes prove

Perkufizimi: Sipërfaqja prove përbëhet nga tre sipërfaqe rrethore bashkëqendrore për matjen e drurëve.

- Sipërfaqja rrethore e brendshme ka një sipërfaqe horizontale prej 25 m² (rrezja=2.82 m) e përdorur për matjen e rigjenerimit, druret e rinj me diametër bazimetrik nga 2 deri në 7.5 cm, inventarizimin e produkteve jodrusore dhe kullotat.
- Sipërfaqja qendrore e mesit ka një madhësi prej 200 m² (rrezja=7.98 m) dhe përdoret për matjen e drurëve me diametër bazimetrik me të madh se 7.5 cm dhe me të vogël se 27.5cm.
- Sipërfaqja e jashtme rrethore ka një rreze horizontale prej 11.28m që korrespondon me një sipërfaqe prove me madhësi 400 m². Në këto sipërfaqe rrethore do të maten të gjithë druret me diametër bazimetrik me të madh ose të barabartë me 27.5 cm.


Nëse rrezja e sipërfaqes prove do të matet me shiritmeter ajo duhet të korrektohet në përputhje me tabelën vijuese, në rast të një përrësie me të madhë se 10%.

Pjerrësia (%)	Pjerrësia (grade)	Rrezja (m) 400 m ²	Rrezja (m) 200 m ²	Rrezja (m) 25 m ²		Pjerrësia (%)	Pjerrësia (grade)	Rrezja (m) 400 m ²	Rrezja (m) 200 m ²	Rrezja (m) 25 m ²
0-10	0.0	11.28	7.98	2.82		80	38.7	12.77	9.03	3:19
15	8.5	11.35	8.02	2.84		85	40.4	12.93	9.14	3:23
20	11.3	11.39	8.06	2.85		90	42.0	13.09	9.25	3:27
25	14.0	11.46	8.10	2.86		95	43.5	13.25	9.37	3:31
30	16.7	11.53	8.15	2.88		100	45.0	13.42	9.49	3:35
35	19.3	11.61	8.21	2.90		105	46.4	13.59	9.61	3:40
40	21.8	11.71	8.28	2.93		110	47.7	13.76	9.73	3:44
45	24.2	11.82	8.36	2.95		115	49.0	13.93	9.85	3:48
50	26.6	11.93	8.44	2.98		120	50.2	14.10	9.97	3:53
55	28.8	12.05	8.52	3:01		125	51.3	14.28	10.09	3:57
60	31.0	12.19	8.62	3:05		130	52.4	14.45	10.22	3.61
65	33.0	12.32	8.71	3:08		135	53.5	14.63	10.34	3.66
70	35.0	12.47	8.82	3:12		140	54.5	14.80	10.47	3.70
75	36.9	12.62	8.92	3:15		145	55.4	14.98	10.59	3.74

Tabela 2. Percaktimi i sakte i rrezes se siperfaqes rrethore e korrektuar sipas pjerresise se terrenit

Shenim : Distancat e drureve ne kufirin e siperfaqes prove duhet te maten me kujdes per te pare nese jane brenda apo jashte siperfaqes prove. Teorikisht identifikimi i drureve brenda ose jashte siperfaqeve prove percaktohet keshtu :

- Fillimisht- Matet distanca e drureve nga qendra e siperfaqeve prove;
- Se dyti- Matet diametri bazimetrik i drurit
- Se treti - Nese shuma e distances me gjysmen e diametrit te drurit eshte me e vogel se rrezja e siperfaqes prove, druri konsiderohet brenda siperfaqes prove. Praktikisht nese disa drure kufitare ndeshen, atehere 1 dru do te numerohet, druri tjetër jo dhe keshtu me rradhe.



II. Percaktimi i llojit te pyllit

Perkufizimi: lloji i pyllit percaktohet si nje kategori bazuar ne: (i) perberjen; (ii) kushtet ekologjike (sipas Forest Europe; OBU dhe Agjensise Europiane te Mjedisit) dhe (iii) speciet dominante. Kodi i tipit te pyllit shenohet sipas listes se tipeve te pyjeve qe ndodhet ne aneksin e udhezuesit.

Specifikimi: shiko Aneksin 2.

III. Percaktimi i Specieve pyjore

Perkufizimi: kodi i specieve te drureve ose shkurreve shenohet duke u bazuar ne listen e specieve.

Specifikimi: shiko Aneksin 3.

IV. Diametri i drureve

Perkufizimi: diametri i drurit eshte diametri i trungut i matur ne 1.3 m nga toka ose ne lartesine e gjoksit.

Specifikimi: matja e sakte e diametrit eshte mjaft e rëndësishme.

V. Lartesia e drurit

Perkufizimi: Lartesia totale e drurit jepet si distance midis bazes se drurit dhe majes se tij (pikes me te larte).

Specifikimi:

- lartesia e drurit matet ne menyre periodike duke filluar me drurin e 1 brenda siperfaqes prove dhe me pas duke u matur çdo 4 drure (psh: 1,5,9,13,17...). Druri i pare brenda siperfaqes prove eshte ai qe ndodhet me afer veriut te vertete i percaktuar me busull ose qe ka kendin azimutal me te vogel.
- matja kryhet me VERTEX ose me instrumenta te tjere si: hipsometer Blume-Leiss, dendrometer Suunto
- lartesia e drureve te vendosur pjerrtasi nuk duhet te matet dhe nje shenim duhet te kryhet.
- nese matja e lartesisë eshte e pamundur, lartesia e drurit merr vleren 0 dhe jepet arsyeja perse.

Shenim: Nese matja me VERTEX eshte e pamundur, regjistrohet kodi i matur me SUUNTO ne bazen e drurit dhe majen e drurit si dhe distanca horizontale me shiritmeter ne terren.




Figure 6. Matja e lartesisë me Vertex

VI. Klasa e moshës

Perkufizimi: Struktura e moshës së një pylli përfaqëson moshën e drurëve në grumbullin pyjor (psh: shprehet në klase moshë), ose nga raporti i drurëve në klasa të ndryshme moshash. Moshë mesatare e specieve mbizotëruese jepet vetëm për pyjet e lartë dhe për cungishtet.

Specifikimi: Moshë mesatare përcaktohet duke bërë numerimin e rratheve vjetore në cungjet, ose nga kampionet e marra nga druret e gjalla me tryele. Për të përcaktuar moshën e drurit përdoren këto mënyra:

- përdoren druret e rinj të sapo rënë në sipërfaqen provë (nuk duhet harruar se numrit të rratheve në cungje shtohet nr i rratheve që është moshë që i duhet drurit për të arritur lartësinë ku është thyer/rrezuar)
- përcaktohet nëpërmjet numerimit të verticileve në haloret e rinj
- të përdoren të dhenat nga plani i mbareshtrimit për kohën kur është mbjelle
- duke përdorur mostrat e marra me tryele

Duhet të merren:

- në grumbujt njëmoshore: 2 - 5 kampione nga druret dominante të zgjedhur rastesisht
- në grumbujt pyjorë të perziere: 2 - 5 mostra të zgjedhur rastesisht për secilën specie
- në grumbujt shumëmoshore: 2 - 5 mostra nga druret dominante nga secila klasë moshë

Pyje të lartë		Cungishte		Shkurre	
11	0-20 vjeç	21	0-10 vjeç	31	0-5 vjeç
12	21-40 vjeç	22	11-20 vjeç	32	6-10 vjeç
13	41-60 vjeç	23	21-30 vjeç	33	11-15 vjeç
14	61-80 vjeç	24	31-40 vjeç	34	16-20 vjeç
15	81-100 vjeç	25	41-50 vjeç	35	21-25 vjeç
16	101-120 vjeç	26	>50 vjeç	36	26-30 vjeç
17	121-140 vjeç			37	>30 vjeç
18	141-160 vjeç				
19	>160 vjeç				

VII. Marrja e kampioneve me tryele

Moshë mesatare e grumbullit pyjor do të përcaktohet me saktësi deri në 5 vjet për rastin e trungishteve dhe deri 2 vjet për cungishtet. Moshë përcaktohet duke numeruar rrathe vjetore të mostrave të marra dhe përcaktohet në nivel nënparcele. Në disa raste moshë mund të përcaktohet duke numeruar rrathe në cungjet e drurëve në grumbull kur këta kanë dimensione të afërta me ato të drurit mesatar.

Mostrat merren me anë të tryeles në lartësinë 1.3 m nga toka. Në terrere të pjerrta mostrat duhet të merren pingul me pjerrësinë e terrenit. Mënyra e marrjes së mostrave tryele shpjegohet me qartë në aneksin e udhëzuesit.



Figura 7. a-puntoja; b-doreza; c-lamela nxjerrese

VIII. Kurordendesia

Perkufizimi: Perfaqson shkallen e afrimit te kurorave te druveve ne grumbullin pyjor dhe percaktohet nga raporti midis siperfaqes se mbuluar nga projekcioni vertikal i kurorave te druveve ndaj siperfaqes totale dhe shprehet ne perqindje. Duhet te theksohet se ne nje grumbull pyjor kurordendesia duhet te jete > 30% e siperfaqes.

Specifikimi: Kurordendesia merr vlera nga 0.1-1.0 dhe ndahet ne klasa ose kategori si me poshte:

Niveli	Kriteri percaktimit
E ulet	Kurordendesi nga 0,3 - 0,5
Mesatare	Kurordendesi nga 0,5 - 0,7
E larte	Kurordendesi nga 0,7-0.9




Figura 8. Raste te mbuleses se kurordendesise nga 10% (majtas) dhe 30% (djathtas)

IX. Struktura Vertikale

Perkufizimi: Shtresa vertikale e vendosjes se druveve ne grumbull

Specifikimi: Struktura vertikale perfaqson vendosjen e druveve ne kate:

- **Kati i siperm** (> 2/3 e lartesis se druveve)
- **Kati i mesit** (1/3 - 2/3 e lartesis se druveve)
- **Kati i poshtem** (< 1/3 e lartesis se druveve)

Struktura vertikale vleresohet sipas numrit te kateve ne grumbull pyjor dhe per kete klasifikohet:

- 1 e thjeshte (1 kat)
- 2 2 kate
- 3 shume kate




Figura 9 Raste te percaktimit te struktures vertikale (1 shtrese/kat-figura 1); 2 kate/shtresa (figurat 2&3) dhe shumekate (figura 4,5 & 6).

X. Dëmtimet

Perkufizimi: gjate inventarizimit mund te behet vleresimi i specieve dhe i shkalles se demtimit te drureve ne siperfaqen prove.

Specifikimi: duhet te shenohet tipi i demtimit sipas kodeve ne tabelen e meposhtme si dhe intensiteti i demtimit (kodi i dyte ne fig 1 psh: 3)

Tipi i demtimit	Kodi
Demtimit i levores ne pjesen e poshtme te trungut, rrenje	1
Thyerje nga era dhe debora	2
Demtimit nga zjarri	3
Kalbezimi	4
Demtimit nga ripertypetit (lope, dele, dhi)	5

Tipi i demtimit	Kriteri i vleresimit	Niveli demtimit	Kodi
Demtimit i levores ne pjesen e poshtme te trungut, rrenje	Demtimit te vogla, te parrezikshme per shendetin dhe mbijetesen e drurit.	i vogel	1
	Demtimit mesatar, rritje e rrezikut per kalbje, druri qe mund te pritet me vone per shkak te demtimit	mesatar	2
	Demtimit i madh, druri ka te ngjare te pritet ne shfrytezimin tjeter	i madh	3
Thyerje nga era dhe debora	Me pak se 1/4 e kurores se gjalle, deget anesore kane marre funksionin e trungut/kercellit kryesor (gjatesia e kurores se gjalle mund te shikohet duke e krahasuar ate me druret fqinj)	i vogel	1
	Eshte thyer 1/2 e kurores se gjalle/gjelber	mesatar	2
	Eshte thyer me shume se 1/2 e kurores se gjalle/gjelber	i madh	3
Demtimit nga zjarri	Pjesa e poshtme e trungut dhe rrenjet kane demtimit te vogla nga zjarri por qe nuk rrezikojne shendetin dhe jetesen e drurit	i vogel	1
	Demtimit mesatar i trungut dhe rrenjeve me	mesatar	2

	mundesi te rehabilitimit te gjetheve dhe kurores se gjalle.		
	Trungu kryesor dhe rrenjet jane plotesisht te demtuara	i madh	3
Dëmtim nga kalbezimi	Kalbje me ngjyre kafe pa shkatërrim te struktures se drurit	i vogel	1
	Dekompozim i konsiderueshem i drurit deri ne 1/3 e diametrit	mesatar	2
	Dekompozim i konsiderueshem i drurit mbi 1/3 e diametrit	i madh	3
Dëmtim nga ripertypetit (lope, dele, dhi)	Dëmtim vetem i degeve te vogla anesore, trungu nuk ka ose ka pak dëmtime qe nuk jane te rrezikshme per rritjen e drurit	i vogel	1
	Bisqet dhe deget kryesore te demtuara njeheresh	mesatar	2
	Trungu kryesor eshte demtuar disa here ose deget anesore te demtuara disa here madje ne shkalle serioze ose trungu i demtuar nga kafshimi	i madh	3

XI. Druret e tharë

Perkufizimi: druret e thare duhet te regjistrohen si indikator te biodiversitetit

Specifikimi:


1. drure te thare ne kembe – regjistrohet diametri dhe lartesia e drurit
2. drure te thare te rrezuar – regjistrohet diametri dhe gjatesia e drurit

XII. Cilesia e materialit drusor

Perkufizimi: Vleresimi i cilesise se lendes drusore eshte opsional dhe lidhet me mundesite e prodhimit. Cilesia jep informacion mbi vleren ekonomike dhe perdorimin e mundshem te trungut te drurit. Kjo pjese e trungut eshte me ose pa dëmtim dhe keta ndikojne ne cilesine e materialit drusor.

Specifikimi:

1. trungu eshte i cilesise se mire dhe ka nje gjatesi minimale prej 6 m (perqindja e lendes se punimit kundrejt gjatesise totale sipas specieve eshte: halore > 60% (98% lende punimi + 2 % dru zjarri; fletore > 50% (83% lende punimi + 17% dru zjarri).
2. trungu ka nje gjatesi nga 2 deri ne 6 m (perqindja e lendes se punimit kundrejt gjatesise totale sipas specieve eshte: halore >10- 60% (83% lende punimi+17% dru zjarri); fletore > 10-50% (64% lende punimi + 36% dru zjarri)
3. dru zjarri (trung me cilesi te dobet dhe nuk perdoret per qellim industrial) (perqindja e lendes se punimit kundrejt gjatesise totale sipas specieve eshte: halore < 10%; fletore < 10%). Ne kete rast lenda e punimit ze 15% te volumit kurse drute e zjarrit 85% te volumit.



1. cilesi e mire

2. cilesi mesatare

3. dru zjarri

D.4.3. MATJET DHE GRUMBULLIMI I TE DHENAVE NE SIPERFAQET PROVE - SHKURRE

I. Rrezja e siperfaqeve prove ne shkurre

Perkufizimi: te gjithë atributet qe lidhen me informacionin mbi shkurret do te vleresohen ne siperfaqet prove me madhesi 25 m²(r=2.82 m). Rrezja e siperfaqes prove duhet te korigjohet sipas pjerresise se terrenit duke iu referuar tebeles se meposhtme, kur pjerresia eshte mbi 10% .

Pjerresia (%)	Pjerresia (grade)	25 m ² Rrezja (m)		Pjerresia (%)	Pjerresia (grade)	25 m ² Rrezja (m)
0-10	0.0	2.82		80	38.7	3:19
15	8.5	2.84		85	40.4	3:23
20	11.3	2.85		90	42.0	3:27
25	14.0	2.86		95	43.5	3:31
30	16.7	2.88		100	45.0	3:35
35	19.3	2.90		105	46.4	3:40
40	21.8	2.93		110	47.7	3:44
45	24.2	2.95		115	49.0	3:48
50	26.6	2.98		120	50.2	3:53
55	28.8	3:01		125	51.3	3:57
60	31.0	3:05		130	52.4	3.61
65	33.0	3:08		135	53.5	3.66
70	35.0	3:12		140	54.5	3.70
75	36.9	3:15		145	55.4	3.74

II. Mbulesa e shkurreve

Perkufizimi: Perqindja e siperfaqes prove qe mbulohet nga shkurret. Ajo shprehet ne perqindje(%)

III. Speciet shkurre

Perkufizimi: Kodi i specieve shkurre do shenohet sipas listes se specieve ne Aneksin 3.

IV. Diametri mesatar

Perkufizimi: diametri mesatar i trungut te specieve shkurre nga toka

Specifikimi: diametri mesatar jepet ne centimetra

V. Lartesia mesatare

Perkufizimi: lartesia mesatare e individeve te specieve shkurre

Specifikimi: lartesia mesatare jepet ne m dhe decimeter psh: 3.15 m (3m dhe 15 decimetra).

D.4.4. INFORMACIONI PER SIPERFAQET PROVE NE KULLOTA

I. Tipi i kullotave

Perkufizimi: Klasifikimi i kullotave bazuar ne sezonin e kullotjes (sipas altitudes dhe periudhes se perdorimit) e cila lidhet ngushte me periudhen e vegjetacionit.

Specifikimi: duhet te vleresohet sipas ketyre kategorive:

1. kullota verore
2. kullota dimerore

II. Shkalla e mbulimit

Perkufizimi: Shkalla e mbulimit vleresohet sipas mbuleses se bimeve barishtore ne % kundrejt siperfaqes totale te ngastres.

Specification: Llogaritet ne perqindje ne raport me siperfaqen totale te mbuluar nga bimesia barishtore, siperfaqet e zhveshura, shkembore etj.

III. Perberja e specieve

Perkufizimi: Perberja e specieve percaktohet per 3 grupet kryesore (Graminace, Leguminoze, te tjera) ne siperfaqen prove kundrejt mbuleses se bimeve barishtore.

Specifikimi: Perqindja e 3 grupeve kryesore e vleresuar ne siperfaqen prove (25 m²). Vleresimi duhet te behet ne % kundrejt siperfaqes qe mbulohet nga bimesia barishtore.

1. Graminace
2. Leguminoze
3. Te tjera (labiate)

IV. Kostija e barit dhe peshimi

Perkufizimi: Inventarizimi i kullotes behet duke perdorur siperfaqe prove me madhesi 1m² te vendosura brenda siperfaqes rrethore te brendshme sipas rrjetit 200x 200 m.

Specifikimi: Bari kositet dhe peshohet. Bazuar ne matjet e peshes llogaritet biomasa e barit per 1 ha. Kjo do sherbeje per te llogaritur kapacitetin mbajtes te kullotes.

V. Llogaritja e lartesisë

Perkufizimi: Lartesia llogaritet per 3 tipet kryesore te mbuleses (bime barishtore, drure dhe shkurre) brenda siperfaqes prove.

Specifikimi: Lartesia e matur do shprehet ne meter dhe decimeter.

VI. Vleresimi i koeficientit te perdorimit te kullotes

Perkufizimi: vleresimi i sasise se barit te konsumuar nga kafshet gjate periudhes se kullotes.

Specifikimi: Ne perdorimin e kullotes kerkohet te behet balancimi midis sasise se barit qe prodhohet dhe sasise se barit qe konsumohet. Metodologjia synon qe te percaktohet koeficienti i perdorimit te kullotes bazuar ne 2 kositje te barit. Ekipi i terrenit duhet te kosise 10% te siperfaqeve prove te shperndara ne menyre sistematike perpara fillimit te kullotjes dhe pas kullotjes. Kullotja behet me nje numer te mjaftueshem te bagetive ne siperfaqene kullotes. Ky tregues llogaritet si diference midis peshes se thate te biomases midis 2 kositjeve, ose perqindja e reduktimit te volumit konsiderohet si koeficient i perdorimit te kullotes. Metoda eshte e thjeshte dhe siguron nje reduktim te gabimit personal.

$$k_p = \frac{(P_{\text{parakullotjes}} - P_{\text{paskullotjes}})}{P_{\text{parakullotjes}}} \cdot 100$$

ku: $P_{\text{para kullotjes}}$ – pesha totale perpara kullotjes;

$P_{\text{pas kullotjes}}$ – pesha totale e mbeturinave pas kullotjes

VII. Llogaritja e kapacitetit mbajtes te kullotes

Perkufizimi: numri mesatar i kafsheve qe kullosin gjate nje sezoni kullotjeje

Specifikimi: Kapaciteti mbajtes vjetor dhe afatgjate i kullotes na jep nje indikacion mbi numrin e duhur te kafsheve nen nje regjim te caktuar kullotjeje dhe na siguron nje baze per projektimin, parashikimin dhe mbareshtimin ne vijimesi te siperfaqes se kullotave. Ajo llogaritet duke perdorur ekuacionin e meposhtem:

$$k = \frac{P \cdot S}{R \cdot D} * c$$

ku:

k-kapaciteti ne njesi gjedhi, P-prodhimtaria e kullotes; R-konsumi ditor/racioni ditor i barit (kg/dite); D-numri i diteve te qendrimt te kafsheve ne kullote ; S-siperfaqja e kullotes se dobishme; c-koeficienti i korrigjimit
Ky vleresim duhet te kryhet ne nivel ngastre dhe mbi kete baze per tere siperfaqen e kullotave brenda ekonomise pyjore e kullosore.

VIII. Vleresimi i numrit te kafsheve ne kullote

Perkufizimi: Numri kafsheve perfaqson numrin e llojeve specifike dhe klasave te kafsheve qe kullosin ose qe perdorin nje njesi toke per nje periudhe kohore specifike.

Specifikimi: Percaktimi i numrit te kafsheve qe do kullosin ne nje kullote perben nje tregues te rendesishem per vendimarrjen lidhur me menaxhimin e kullotjes. Pavarsisht se cili sistem kullotje zbatohet, tipit te vegjetacionit qe kullotet apo llojit dhe klases se bagetive, numri i kafsheve ka impaktin me te madh ne gjendjen shendetsore te burimeve te bimessie barishtore dhe ne performancen e kafsheve per te gjitha mjetet e mbareshtimit. Ajo shprehet ne Njesi Kafshesh ne Muaj per Hektar dhe llogaritet sipas ekuacionit te meposhtem:

- Numri kafsheve = Biomasa barishtore (kv)/ Sasine e konsumuar nga kafshet ne 1 muaj
- Njesi Bagetish ne Muaj = Numri kafsheve/ Njesine Ekuivalente ne Bageti

IX. Gjendja e zjarreve ne kullote

Perkufizimi: Zjarri mund te jete nje rrezik kryesor per ekosistemet kullosore. Shenjat e zjarrit qe mund te ndeshen ne te shkuaren jane regjistruar.

Specifikimi: Ndahet ne 3 kategori kryesore :

- 0 nuk ka shenja te dukshme zjarri
- 1 Ka shenja zjarri qe jane ndeshur me shume se 1 vit me pare
- 2 Shenja zjarri te ndeshura ne vitin e fundit

X. Mbulesa me gure te levizshem

Perkufizimi: Siperfaqja e mbuluar nga guret e levizshem ne toke e shprehur ne %.

Specifikimi: Ndahet ne 4 kategori

- 0 mungojne (siperfaqja e zene nga guret e levizshem eshte shume e vogel)
- 1 e vogel (siperfaqja e zene nga guret e levizshem eshte < 30%)
- 2 e moderuar (siperfaqja e zene nga guret e levizshem eshte nga 31-60%)
- 3 e larte (siperfaqja e zene nga guret e levizshem eshte > 60%)

D.4.5 PRODUKTET PYJORE JO DRUSORE (BIMET AROMATIKO-MJEKSORE, FRUTAT PYJORE, LULET, FARAT)

Produktet jodrusore do te vleresohen brenda siperfaqeve prove 25 m². Llogaritja do te perfshije keto karakteristika: (i) perqindjen e mbulimit nga PPJD; (ii) identifikimi i specieve.

I. Perqindja e mbulimit

Perkufizimi: Perqindja e mbulimit nga speciet qe prodhojne produkte jodrusore e vleresuar si mbulesa ne % ndaj siperfaqes totale te siperfaqes prove.

Specifikimi: Vleresohet ne % kundrejt siperfaqes totale te mbuluar nga bimet mjeksore dhe te tjera ne raport me siperfaqen prove.

II. Prania e specieve

Perkufizimi: Ne dokumentin standart 4, ka nje liste me speciet qe perdoren per prodhimin e produkteve jo drusore (aromatike, mjeksore dhe me vlere ushqyese)

Specifikimi: speciet kryesore duhet te shenohen dhe per secilen specie duhet te jepet ne % shkalla e mbulimit kundrejt siperfaqes prove si dhe lartesia mesatare. Per bimet mjeksore jepni shperndarjen ne siperfaqe (abdonancen) si dhe % e pjesmarrjes se llojit dominant.

D.4.6 FUTJA E TE DHENAVE DHE KONTROLLI

I. Futja ditore e te dhenave te grumbulluara ne siperfaqet prove ne programin per menaxhimin specifik te te dhenave

Te dhenat e grumbulluara ne siperfaqe prove regjistrohen direkt ne tablet dhe ne fund te dites se punes duhet te ngarkohen direkt ne programin e rikonfiguruar ne MS Access. Keto te dhena perfshijne edhe informacionin per perskrimin parcelar dhe neparcelar etj.

II. Aktivitetet e kontrollit, korigjimi dhe pergjegjesia

Kontrolli cilesor i te dhenave duhet te kryhet per te siguruar kontrollin cilesor gjate kqyerjes se te dhenave te inventarit. Ne vazhdim, keto te dhena grumbullohen gjate vrojtimit ne terren nga grupet e punes dhe vleresimi i cilesise se te dhenave eshte domosdoshmëri. Ne kete rast perdoret metoda e kontrollit per inspektim.

III. Qasja e metodes se kontrollit:

Nje inspektim duhet te kryhet nga nje grup specialistesh pyjesh te kualifikuar, ose nje kompani e kontrollit te cilesise e specializuar per kete natyre pune (te quajtur kontrollor) dhe kjo duhet te behet ne siperfaqet prove pa pranine e ekipeve te matjeve ne terren. Nese plani i mbareshtimit eshte pergatitur nga Stafi i Pyjeve i Bashkise, kontrolli i cilesise dhe vleresimi duhet te behet nga nje grup specialistesh te kualifikuar nga Ministria (1 perfaqses), AKM (1 perfaqses), Fakulteti i Shkencave Pyjore (1 perfaqses) dhe Bashkia (1 perfaqses). Fondi per inspektimin duhet te parashikohet ne buxhetin e hartuar per PMPK. Zakonisht duhet te inspektohet 5-10% e numrit total te siperfaqeve prove dhe ri-matja e siperfaqeve prove duhet te kryhet nga ekipi i kontrollit. Dy grupet e te dhenave ruhen me vehte dhe asnje korigjim nuk kryhet. Ky kontroll kryhet me qellimin e vetem te percaktimit te gabimit ne matjet e perdorura per hartimin e planit te mbareshtimit. Gabimi ne te dhenat e planit te mbareshtimit do te llogaritet duke analizuar te dhenat e siperfaqeve prove te ri-matura. Prezantimi grafik dhe tabelar i cilesise se te dhenave duhet te sigurohet per te shpjeguar diferencat dhe perputhjen midis 2 grupeve te te dhenave. Vleresimi nga pikpamja statistikore i diferences (gabimit) se te dhenave midis grupit te kontrollit dhe ekipit te punes se terrenit duhet te testohet. Pjese e inspektimit duhet te jene edhe hartat per te verifikuar ndarjen e parcelave ne harten e ekonomise pyjore si dhe shenimi i kufijve ne terren. Nese plani i mbareshtimit pergatitet nga nje kompani private, kontrollet periodike duhet te kryhen nga stafi i sherbimit pyjor te bashkise. Vleresimi final i cilesise se planit te mbareshtimit behet nga komisioni i ngritur nga Ministria ne perberje te te cilit jane specialiste te kualifikuar pyjesh perpara se te behet miratimi final.

D.5 INFORMACIONI I FORMULARIT TE TERRENIT

D.5.1. TE DHENAT IDENTIFIKUESE

I. Bashkia

Perkufizimi: Emri i Bashkise dhe Kodi i Bashkise sipas SISP ne momentin e futjes se PMPK ne sistem.

Specifikimi: Emri i plote i Bashkise dhe Kodi sipas SISP (psh: 3 numra si: 123)

II. Ekonomia pyjore dhe zona Kadastrale

Perkufizimi: Emri i Ekonomise Pyjore dhe zona Kadastrale ku ben pjese

Specifikimi: Emri i plote i Ekonomise Pyjore dhe Kodi i Zones Kadastrale

III. Ekonomia e Vjeter Pyjore

Perkufizimi: Emri i ekonomise se vjeter pyjore

Specifikimi: Emri i plote i Ekonomise Pyjore

IV. Data dhe koha

Perkufizimi: Eshte data ne te cilen jane kryer punimet e terrenit.

Specifikimi: Data duhet te shenohet:

- dita (2 numra – psh.: 01 = Dita e 1 e Muajit)
- muaji (2 numra – psh: 01 = Janari)
- year (4 numra – psh: 2018)

V. Emri i Vrojtuesit

Perkufizimi: Emri i drejtuesit te Ekipit te Punes ne terren.

Specifikimi: Duhet te shenohet emri i drejtuesit te ekipit. Ai eshte pergjegjes per plotesimin dhe saktesine e te dhenave.

VI. Emri lokal i Parceles pyjore, numri

Perkufizimi: Eshte emri i parceles dhe numri i saj sipas Kadastres Pyjore dhe ne rast se ndryshon ne planin e ri eshte emri i ri i saj.

Specifikimi: numri i parceles duhet te shenohet me 3 shifra (psh: 003, 023, 123)

VII. Kodi i Nen-parceles

Perkufizimi: Eshte kodi i nenparceles (jepet me shkronje) sipas Kadastres Pyjore dhe ne rast se ndryshon ne planin e ri eshte kodi i ri i saj

Specifikimi: kodi me shkronje i nenparceles jepet me 1 vlere (psh: b)

VIII. Siperfaqja

Perkufizimi: Eshte siperfaqja totale e parceles dhe nenparceles e percaktuar ne plani e ri te mbareshtimit dhe ne planin e vjeter.

Specifikimi: siperfaqja shprehet ne ha, me 4 shifra (psh: 18,35)

IX. Pronesia

Perkufizimi: Eshte pronesia aktuale e parceles/nenparceles dhe ajo e meparshmja

Specifikimi: Shenohet pronesia aktuale (Bashki, Privat, te tjera) dhe nese eshte e nevojshme forma e meparshme e pronesisë.

Pronesia aktuale	Bashki <input type="checkbox"/>	Privat <input type="checkbox"/>	Te tjera <input type="checkbox"/>
-------------------------	---------------------------------	---------------------------------	-----------------------------------

D. 5.2 PERSHKRIMI I STACIONIT

I. Kundrejtimi

Perkufizimi: Kundrejtimi i shpatit është drejtimi i vijës së pjerrësisë më të madhe të shpatit, i matur në gradë. Kundrejtimi i shpatit matet me busull ose mund te percaktohet edhe ne harte dhe shenohet sipas 8 drejtimeve kryesore duke perdorur shkronjat fillestare (V,J,L,P,VL,JL,VP,JP etj)

Specifikimi: Ne klasifikimin e nenparcelave sipas kundrejtimit dallohen: (i) kundrejtimit te dritesuar(J & JP); (ii) kundrejtimit gjysem te dritesuar(JL & P);(iii) kundrejtimit gjysem te hijezuara (L & VP); (iv) kundrejtimit te hijezuara(V & VL).

II. Altituda

Perkufizimi: Perfaqson lartesine nga niveli i detit. Mund te merret nga harta ose nga kordinata Z e GPS.

Specifikimi: shenohet vlere minimale, maksimale dhe mesatare e altitudes me 4 shifra (psh: 1280 ose 0845).

III. Pjerresia

Perkufizimi: Eshte pjerresia mbizoteruese e parceles/nenparceles. Pjerresia matet brenda parceles/ nenparceles dhe shprehet ne grade ose ne % dhe klasifikohet ne 5 klasa:

- pjerresi e vogel (deri 5° ose 9%);
- pjerresi mesatare (5-15° ose 10-27%);
- pjerresi e madhe (16-30° ose 28-58%);
- pjerresi shume e madhe (31-45° ose 59-100%);
- pjerresi ekstreme (> 45° ose > 100%)

Specifikimi: zgjidh nje nga klasat e pjerresise : (0-10 % ose 0-5°; 11-27% ose 6-15°; 28-58 % ose 16-30°, 59-100% ose 31-45°; > 100 % ose > 45°).

IV. Relievi/njesia gjeomorfologjike

Perkufizimi: Relievi i terrenit percaktohet per çdo nenparcele pyjore dhe si i tille zgjidhet forma mbizoteruese e relievit.

Specifikimi: zgjidhet nje nga opsionet e mepostme:

Relievi	Relievi	Relievi	Relievi	Relievi
I sheshte <input type="checkbox"/>	Shpat <input type="checkbox"/>	Kodrinor <input type="checkbox"/>	Fushor <input type="checkbox"/>	Lugine <input type="checkbox"/>

V. Gjeologjia/tipet e shkembinjve

Perkufizimi: tipi gjeologjik mbizoterues ne nenparcelen pyjore

Specifikimi: zgjidhet nje nga opsionet (magmatike, metamorfik, sedimentar, te tjere) nga vrojtimi direkt ne terren ose nga hartat gjeologjike.

VI. Tipi i Tokes

Perkufizimi: Pjesa e sipërme e tokës ku rriten bimët. Tipi/lloji i tokes percaktohet nepermjet hartes pedologjike ose ne baze te profileve ne terren. Profilet kryesore te tokes hapen çdo 500-600 ha per te percaktuar tipin dhe karakteristikat e tokes. Ata kane nje gjeresi 80 cm dhe thellesi deri sa te arrije ne shkembin amnor. Bazuar ne profilin e hapur behet pershkrimi i tokes dhe nentipit te saj.

Specifikimi: Identifikimi i tipeve te tokes sipas klasifikimit te OBU dhe mund te realizohet nga vrojtimi ne terren ose nepermjet Hartes Pedologjike te Shqiperise. Zgjidhet nje nga opsionet e meposhtme:

Tipi tokes	Tipi tokes	Tipi tokes	Tipi tokes	Tipi tokes
Cambisols ⁷ <input type="checkbox"/>	Gleysols <input type="checkbox"/>	Fluvisols <input type="checkbox"/>	Arenosols <input type="checkbox"/>	Phaezoms <input type="checkbox"/>
Luvisols <input type="checkbox"/>	Regosols <input type="checkbox"/>	Vertisols <input type="checkbox"/>	Lithosol <input type="checkbox"/>	Leptosol <input type="checkbox"/>

VII. pH i tokes

Perkufizimi: jepet ne shkalle numerike (nga 0 deri 14) dhe perdoret per te specifikuar aciditetin apo bazicitetin e tokes.

Specifikimi: vlera per tokat acide (0-6), neutrale (7) dhe bazike (8-14). Te dhenat mund te merren nga harta Pedologjike e Shqiperise, ose nga vrojtimit ne kuader te planit te mbareshtimit duke perdorur paisje qe masin pH e tokes.

VIII. Thellesia e tokes

Perkufizimi: perfaqson trashesine e shtreses se tokes nga siperfaqja deri ne ne shkembin amnor dhe qe pershkruhet nga rrenjet e drureve.

Specifikimi: te dhenat mund te merren nga vrojtimit direkt ne parcele/vrojtimit te realizuara ne kuader te planeve te mbareshtimit ose nga Harta Pedologjike e Shqiperise (ose harta te tjera me te detajuara). Per kete zgjidhet nje nga opsionet e meposhtme:

Thellesia e tokes(cm)	Vleresimi i tokes	Perzgjedhja
deri 15 cm	shume e ceket	Sheno me Kryq <input type="checkbox"/>
16-30 cm	e ceket	Sheno me Kryq <input type="checkbox"/>
31-60 cm	mesatarisht e thelle	Sheno me Kryq <input type="checkbox"/>
61-120 cm	e thelle	Sheno me Kryq <input type="checkbox"/>
> 120 cm	shume e thelle	Sheno me Kryq <input type="checkbox"/>

IX. Lageshtia e tokes

Perkufizimi: Prania e ujit ne toke. Llogaritet bazuar ne shtresen e siperme te tokes ne hotizontin (A) dhe kjo behet gjate fazes se pershkrimimit parcelar. Nje sasi toke merret nga horizonti A ne thellesine 15-20 cm dhe shtypet me dore.

Specifikimi: Vleresimi behet me dore ne terren ose nga vrojtimit e kryera me pare ne kuader te Planit te vjeter te Mbareshtimit ose nga Harta Pedologjike e Shqiperise (ose harta te tjera). Zgjidhet nje nga opsionet e tabelës se meposhtme:

⁷ FAO(1988).FAO/UNESCO Soil Map of the World.Revised legend with corrections and updates.World Soil Resources Report 60,FAO,Rome.Reprinted with updates as technical paper,20,ISRIC,Wageningen.

Klasifikimi i tokes sipas lageshtise	Kushtet	Perzgjedhja
E thate	kur nje grusht dheu i marre nga horizonti A dhe i ngjeshur me gishtrinj nuk e njom doren dhe as e freskon ate.	Sheno me Kryq <input type="checkbox"/>
E fresket	E fresket gjate ngjeshjes me dore,te jep pershtypjen e ftohtesise.	Sheno me Kryq <input type="checkbox"/>
E njome	Kur gjate ngjeshjes me dore e njome ate,por nuk le gjurme uji.	Sheno me Kryq <input type="checkbox"/>
E laget	Kur gjate ngjeshjes me dore e njome doren,duke lene gjurme uji, por nuk pikon uji.	Sheno me Kryq <input type="checkbox"/>
Shume e laget	Kur nga dheu gjate ngjeshjes pikon uje.	Sheno me Kryq <input type="checkbox"/>

X. Shkembijte

Perkufizimi: prania e shkembinjve ne tere siperfaqen e nenparcelave. Studiohet bazuar ne profilet pedologjike, ose duke perdorur informacion nga studimet e tokes (hartat gjeologjike), ose plani i meparshem i mbareshtrimit.

Specifikimi: Vleresimi ne vend ndaj siperfaqes totale i shprehur ne perqindje,.Vendosni vleren me 2 shifra (psh: 35) dhe vendos nje kryq ne zgjedhjen per shperndarjen.

XI. Legusha

Perkufizimi: Legusha eshte shtresa e gjetheve pjesisht e dekompozuar,bisqeve etj mbi toke.

Specifikimi: Vleresimi behet ne terren dhe percaktohet thellesia mesatare e legushes.Karakterizimi i legushes sipas trashesise duhet te kryhet si me poshte:

Klasifikimi i legushes	Trashesia (cm)	Perzgjedhja
E trashe	4-5 cm	Sheno me Kryq <input type="checkbox"/>
Mesatare	Pyje fletore: 2-4 cm Pyje halore: 1-2 cm	Sheno me Kryq <input type="checkbox"/>
E holle dhe e vazhdueshme	Pyje fletore: 1-2 cm Pyje halore: 0.5-1 cm	Sheno me Kryq <input type="checkbox"/>
E holle dhe e nderprere	mungon	Sheno me Kryq <input type="checkbox"/>

XII. Thellesia e humusit

Perkufizimi: Humusi eshte materiali i erret, organik qe formohet ne toke kur mbetjet bimore dhe shtazore dekompozohen.

Specifikimi: Vleresimi ne vend i pranise se humusit dhe thellesise mesatare te tij. Vendos nje kryq ne opsionet: mungon; thellesi < 3cm; thellesi nga 3-5 cm dhe thellesi > 5 cm.

XIII. Hidrografia

Perkufizimi: informacion mbi sasine e burimeve ujore, pranise se rrjedhieve ujore,liqeneve etj.

Specifikimi: vleresim ne terren ose nga hartat e PMPK (ose the tjera) i pranise se rrjedhieve ujore, liqeneve dhe burimeve ujore, vleresimi i regjimit ujqor gjate vitit dhe gjendja aktuale(prania e erozionit, depozitimi i sedimenteve).

Tipi	Regjimi Ujqor	Gjendja aktuale
1-Burim <input type="checkbox"/>	1 sezonal 2 gjithe vitin	1 erozion 2 depozitim
2-Rreke <input type="checkbox"/>	1 sezonal 2 gjithe vitin	1 erozion 2 depozitim
3- Perrua <input type="checkbox"/>	1 sezonal 2 gjithe vitin	1 erozion 2 depozitim
4- Liqen <input type="checkbox"/>	1 sezonal 2 gjithe vitin	1 erozion 2 depozitim

XIV. Erozioni

Perkufizimi: Informacion mbi pranine e erozionit te tokes dhe tipeve te tjera, origjina e tij dhe tendenca me mundesine per te futur te dhenat e 2 tipeve.

Specifikimi: Vleresimi ne vend ose nga hartat e planit te mbareshtimit(ose burime te tjera) i pranise se shenjave te erozionit ne shpate te pjerrta, duke percaktuar nivelin e tij sipas ketij klasifikimi: (i)siperfaqesor;(ii) ne thellesi;(iii) me brazda.

Tipi	Perkufizimi
1- Siperfaqesor <input type="checkbox"/>	1 Erozion minimal (zakonisht shpellarje ose tipe me vija)
	2 Shenja te erozionit me largim te shtrese se tokes me pak se 0.1 m thellesi dhe sedimentet e erodura mbeten brenda zones.
2- Ne thellesi <input type="checkbox"/>	1 Shenja te erozionit me largim te shtrese se tokes nga 0.1-1 m thellesi dhe sedimentet e erodura eksportohen jshate zones
	2 Shenja te erozionit me largim te shtrese se tokes > 1m dhe sedimentet e e erodura eksportohen jshate zones

Duhet te vleresohet:

- siperfaqja e mbuluar nga erozioni siperfaqesor dhe ne thellesi (%)
- origjina (1-ujj;2-era; 3- ndikimi i infrastruktures artificiale si: rruge,ndertesa
- tendenca per 10-15 vitet e ardhshme(periudha e vlefshmerise se PMPK) si: 1-qendrushme; 2-aktive; 3-shume aktive

XV. Orteqet

Perkufizimi: informacion mbi pranine e orteqeve

Specifikimi: vleresimi ne vend i shenjave te orteqeve, grumbullimi i informacionit nga planet e meparshme, banoret lokale apo insitucionet qeveritare. Zgjidhni nje nga opsionet: **1**-mungon; **2**- i rralle; **3**- periodik; **4**- çdo vit.

XVI. Zjarret ne pyje

Perkufizimi: Zjarret mund te jene nje rrezik kryesor ne ekosistemet pyjore dhe kullota. Efekti i zjarrit mbi karakteristikat e ekosistemeve zakonisht percaktohet nga mortaliteti i vegjetacionit. Shenjat e zjarreve ne te kaluaren duhet te regjistrohen si dhe te regjistrohen ne harten perkatese te PMPK(ose te tjera) dhe te dhenat e regjistruara per zjarret (gjate 10 viteve te kaluara).

Specifikimi: klasifikimi i efekteve te zjarreve si me poshte:

Efektet	Kushtet
Asnje shenje <input type="checkbox"/>	asnje shenje zjarri
Shume e ulet <input type="checkbox"/>	Nuk ka mortalitet
I ulet <input type="checkbox"/>	Mortaliteti < 25 %
I moderuar <input type="checkbox"/>	Mortaliteti < 60 %
ashpersisht i moderuar <input type="checkbox"/>	Mortaliteti < 90 %
I ashper: <input type="checkbox"/>	Mortaliteti > 90 %

D.5.3. PERSHKRIMI I PYJEVE, SHKURREVE DHE KULLOTAVE

I. Mbulesa e tokes

Mbulesa e tokes: keto klasa jane te ngjashme me ato ne IKP 2018 dhe bazohen ne klasifikimin sipas CORINE & OBU:

Kategorite e perdorimit te tokes	CORINE KODI	Kriteri percaktues	Perzgjedhja
Pyje	3.1	Pyje fletore, halore dhe te perziere	Sheno me kryq
Shkurre dhe/ose shoqerime bimesie barishtore	3.2	Siperfaqe me bimesi barishtore natyrore, ligatinat, sklerofil, siperfaqe tranzitore nga pyll-shkurre	Sheno me kryq
Siperfaqe te hapura me pak ose pa vegjetacion	3.3	Dunat ranore,,sip shkembore,zonat me vegjetacion te rralle	Sheno me kryq
Kullota	2.3	Kullotat	Sheno me kryq
Miniera,siperfaqe ndertimi dhe vend grumbullime	1.3	Karriera minierash, vend-grumbullime mbeturinash, siperfaqe ndertimi	Sheno me kryq
Siperfaqe ujore	5.1	Rrjedhie ujore, trupa ujore	Sheno me kryq
Siperfaqe te djegura	334	Pyje dhe tipe te tjera vegjetacioni te prekur nga zjarri	Sheno me kryq

II. Forma e qeverisjes

Forma e qeverisjes: Ne table perdoret i njeiti klasifikim si ne manualin e IKP 2018

Forma e qeverisjes	Kriteri percaktues	Perzgjedhja
Trungishte	Perfaqson menyren e pergjithshme te qeverisjes se nje pylli qe e bazon riparteritjen me anen e fares dhe drejtimi i saj behet deri ne moshen kur druret arrijne dimensione te medha. Keto pyje duhet te plotesojne 2 kushte: a-te rigjenerohen me fare b-te prodhojne material te vlefshem me dimensione te medha	Sheno me kryq
Cungishte	Cungishtja perfaqson menyren e pergjithshme te qeverisjes se nje pylli qe bazohet ne riparteritjen me lastare dhe drejtohen me qellim perftimin e materialit drusor me dimensione te vogla dhe mesatare. Keto pyje duhet te plotesojne 2 kushte: a-te jene te afte te rigjenerohen me lastare ose pinjolle b-te prodhojne material drusore me dimensione te vogla deri mesatare	Sheno me kryq
Trungishte e perbere	Trungishtja e perbere eshte nje forme e ndermjetme e dy regjimeve kryesore ku riparteritja kryhet kryesisht me fare por edhe me lastare. Ne kete regjim, pyjet e larte(trungishtet) jane dominues dhe zene >50 % te siperfaqes.	
Cungishte e perbere	Cungishtja e perbere eshte nje forme e ndermjetme e dy regjimeve te lartpermendura ku riparteritja kryhet si me fare ashtu edhe me lastare. Ne kete forme qeverisje, cungishtet jane dominuese dhe zene >50 % te siperfaqes.	
Shkurre	Shkurret jane vegjetacion me kercell te degezuar qe fillon nga baza e tyre. Kane nje shtat-lartesi te vogel dhe dallohet lehtesisht nga vegjetacioni barishtor apo drusor.Dallohet nga druret pyjor	Sheno me kryq

	nga kercelli i shkurter dhe mungesa e trungut kryesor.	
Siperfaqe me bimesi barishtore	Siperfaqe toke ku vegetacioni natyror dominohet nga bimet barishtore me pjesmarrje te shkurreve dhe qe menaxhohen si zona per kullotjen e bagetive. Ne keto siperfaqe shkurret kane nje shkalle mbulimi < 10% .	Sheno me kryq
Kullota	Siperfaqe e mbuluar me bimes barishtore dhe bime te vogla te pershtatshme per tu kullotur nga kafshet. Ndahen ne: 1-kullota verore dhe 2-dimerore.	Sheno me kryq

III. Funkzioni kryesor dhe specifik

Funksioni i pyjeve dhe kullotave do percaktohen per secilen siperfaqe prove dhe ky informacion duhet te perdoret per te percaktuar funksionin per nenparcelen pyjore. Menaxhimi i qendrueshem shumefunksional kerkon qe te percaktohet jo vetem funksioni kryesor por edhe funksionet specifik. Eshte e mundur qe te futen me shume funksione specifik, produkte etj. Klasifikimi i perdorur per funksionet kryesore eshte i ngjashem me ate te IKP 2018 dhe kjo jepet ne tabelen e meposhtme:

Funksioni kryesor	Kriteri percaktues	Perzgjedhja
Prodhues	Grumbujt pyjore prodhues sherbejnë jo vetem per prodhimin e lëndes drusore por edhe produkteve te tjera si: frutat, kërpudhat,specie barishtore te përdorura ne mjekësi, baze ushqimore etj.	Sheno me kryq
Mbrojtes	Jane grumbuj pyjore me qellime mbrojtje dhe kane një efekt stabilizues ne mjedisin natyror (qarkullimin e ujit, reshjet, cilesine e ajrit, parandalimin e rreshqitjeve, klimes, ndalimi i erozionit te tokës). Keto perfshijne: a-pyjet qe mbrojne cilesine e ujrave dhe sasine e tyre b-pyje qe mbrojne token nga erozioni dhe ndalojne rreshqitjen e saj c-pyje qe ndikojne ne zbutjen e ekstremeve klimatike si: brezat mbrojtjes detare.	Sheno me kryq
Shoqeror	Jane grumbuj pyjore qe krijojne mjedise te favorshme për shëndetin dhe çlodhjen e shoqërisë, forcon tregun e punës, forcon mbrojtjen kombëtare dhe përmirëson ndërgjegjen mjedisore dhe kulturën e shoqërisë.	Sheno me kryq
Konservues	Jane grumbuj pyjore me vlere shkencore per habitatin dhe kane diversitet te larte biologjik si psh: rezervatet farore, rezervatet gjenetike etj (qe nuk bejne pjese ne zonat e mbrojtura).	Sheno me kryq

Mbareshtimi i qendrueshem dhe shumefunksional i pyjeve kerkon qe te percaktohet, jo vetem funksioni kryesor, por edhe funksionet specifik sipas kriterëve te meposhtme:

Funksioni kryesor (perzgjidh)	Kriteri percaktues	Funksioni specifik
Prodhues	Pylli ofron prodhimin e lendes drusore,produkteve te tjera pyjore (fruta,kerpudha,baze ushqimore etj) dhe qe menaxhohen ne menyre te rregullt.	Brenda siperfaqes se prodhimit percaktoni prodhimet specifik si: Produktet drusore si: 1. dru zjarri 2. lende ndertimi

		<p>3. lende industriale 4. shtylla 5. çipsa</p> <p>Produkte Jo drusore si:</p> <p>1. Frutat 2. Farat 3. Boçet 4. thupra 5. rrenje 6. levore 7. kerpudha 8. bar 9. gjethe 10. humus</p> <p>Produkte te geshtenjes dhe Arres duke percaktuar: 1 origjina natyrore 2 origjina artificiale 3 gjendja aktuale (nese braktisen)</p> <p>Produktet Specifike si: 1. Guret 2. Gelqere 3. Minerale 4. Qymyr druri 5. Te tjera</p> <p>Per bimet mjeksore percaktoni speciet(referojuni standartit 4, maksimumi 5 specie).</p>
Mbrojtes	<p>Jane pyje me funksione mbrojtje te grumbujve pyjore, stabilizimin e tokes rreth zonave urbane, baseneve ujembledhes, parandalimin e rreshqitjeve dhe erozionit te tokes, demtimeve nga ererat dhe demtime nga rrjedhiet ujore dhe sigurimin e funksioneve ekologjike. Pyjet me funksion mbrojtës përfshijnë:</p> <p>a-pyjet qe mbrojne cilesine dhe sasine e ujrave b-pyjet qe mbrojne token nga erozioni dhe parandalojne demtimin e tokes nga rrjedhiet ujore dhe rreshqitjet c-pyjet me funksion mbrojtës nga ngjarjet klimatike ekstreme si psh: brezat pyjore mbrojtës anës vijes detare.</p>	<p>Brenda siperfaqeve me funksion mbrojtës percakto elemente te veçante per tu mbrojtur si:</p> <p>1. toka nga erozioni, rrjedhiet ujore dhe rreshqitjet 2. cilesia dhe sasine e ujrave (liqenet, lerat) nga erozioni dhe rreshqitjet 3. nga ngjarjet klimatike ekstreme infrastruktura, rruget, linjat hekurudhore nga erozioni, rreshqitjet</p>
Shoqeror	<p>Pyjet sherbejne per permirsimin e shendetit dhe rekreacionit te shoqerise, rritjen e tregut te punes ne turizem, njohjen e natyres etj.</p>	<p>Brenda zone me funksion shoqeror dhe rekreacional percaktoni ndonje sektor specifik per te ruajtur ose zhvilluar si:</p> <p>1. turizmi 2. sportet, ngjitjet ne mal, ecjet me biçikletë, kanotazhi, ecjet me kuaj ne natyre etj. 3. aktivitete didaktike, edukuese dhe fasilitetet perkatese te dhena mbi frekuencen e vizitoreve dhe sezonet e vizitave</p>

		Tregimi mbi frekuencen e njerezve duhet te behet: 1 i larte, 2 Mesatar, 3 I ulet Sipas stineve: 1-dimer, 2 pranvere, 3 vere, 4 vjeshte
Konservues	Pyje me vlera shkencore per habitatet dhe speciet,rezervatet farore,burimet gjenetike tashme te identifikuara.	Siperfaqet konservuese jane zakonisht pika te vetme ose siperfaqe te vogla dhe ne te duhet te percaktohet nese jane: 1. Rezervat biogjenetike 2. Zona me Vlera te Larta Konservuese 3. Habitata dhe flora 4. Monumente natyrore 5. Peisazhi 6. Fauna

IV. Fazat e zhvillimit te pyllit

– Fazat e zhvillimit ne pyjet e larte

Perkufizimi: faza e zhvillimit percaktohet sipas lartesisë mesatare, diametrit mesatar dhe moshes se drureve.Keto te dhena nxirren nga inventarizimi ne terren.

Specifikimet:

Faza e zhvillimit	Lartesia e drureve (m)	Diametri bazimetrik (cm)	Mosha(vjet)
Filizeri	< 1.5 m		Deri 5 vjet
Gemushaje	1.5-5 m		6-10 vjeç
Lëmishte	5.1-10 m		11-15 vjeç
Imshtajë e re	6-12 m	6.1-10 cm	15-30 vjeç
Imshtajë e moçme	8-18 m	11-20 cm	31-60 vjeç
Trungishte e re		20.1-35 cm	60-80 vjeç
Trungishte e mesme		35.1-50 cm	81-100 vjeç
Trungishte e moçme		> 50.1 cm	> 100 vjeç

– Fazat e zhvillimit ne Cungishte

Perkufizimi: Faza e zhvillimit percaktohet ne varesi te moshes se drureve

Specifikimi:

Faza e zhvillimit	Kriteri percaktues
Faza e rinise	<11 vjeç
Faza e parapjekurise	11-20 vjeç
Faza e Pjekurise	21-40 vjeç
Faza e Pleqerise	< 40 vjeç

– Faza e zhvillimit te shkurreve

Perkufizimi: Faza e zhvillimit percaktohet ne baze te moshes

Specifikimet

Faza e zhvillimit	Kriteri percaktues
Faza e rinise	< 5 vjeç
Faza e parapjekurise	5.1-10 vjeç
Faza e Pjekurise	10- 15 vjeç
Faza e Pleqerise	> 15 vjeç

V. Te dhenat Dendrometrike

- diametri bazimetrik (matet ne 1.3 m nga toka)
- specia(identifikohet sipas listes se specieve ne aneksin e udhezuesit)

- kurordendësia (vlerësohet me sy te lire mbyllja e kurorave te drureve)
- lartësia e drurit (matet lartësia e çdo 4 drureve brenda sip prove)
- mosha (bazuar ne mostrat a marra me tryele nga 2-5 drure dominante ne grumbullin pyjor njëmoshar dhe 2-5 drure dominante per çdo klase moshe ne grumbujt pyjore shumëmoshar)
- klasa e prodhimit (percaktohet nga pasqyrat e prodhimit sipas: (i) llojit pyjor; (ii) moshes dhe (iii) lartësisë mesatare ose dominante te nenparceles pyjore)
- sipërfaqja bazimetrike (llogaritet ne baze te diametrave bazimetrike te matur nga druret brenda sipërfaqeve prove dhe percaktohet: (i) per sipërfaqe prove; (ii) per 1 ha; (iii) per çdo nenparcele pyjore)
- volumi per ha dhe totali per nenparcele (llogaritet per çdo specie me vehte. Bazuar nga matjet ne terren llogaritet volumi per sipërfaqe prove dhe me pas per 1 ha duke perdorur algoritmat ne programin MS Access ose nga SISP kur te jete funksional)
- volumi per asortimente (percaktohet nga ndarja e volumit te seciles nenparcele sipas klases se cilesise)
- rritja per ha dhe per nenparcele pyjore (llogaritet duke pjestuar volumin per 1 ha me moshen respektive te grumbullit pyjor ose duke perdorur pasqyrat e prodhimit).

VI. Katet e grumbullit pyjor

Perkufizimi: Llogaritet ne % per secilin kat bazuar ne kurordendësinë

Specifikimi: katet jane 3, dhe ndahen:

1. kati i siperm (druret)
2. kati i mesem (nenpylli)
3. kati i poshtem (bimesia barishtore, rigjenerimi, shkurret)

Perqindja e mbuleses se secilit kat llogaritet ne varesi te kurordendësisë se tij duke u bazuar ne menyren e meposhtme:

Kati	Kuror dendësia	Perqindja e katit (%)
kati i siperm (druret)	0.8	$0.8/1.6 * 100 = 50\%$
kati i mesem (nenpylli)	0.5	$0.5/1.6 * 100 = 30\%$
kati i poshtem (bimesia barishtore, rigjenerimi, shkurret)	0.3	$0.3/1.6 * 100 = 20\%$
Totali	1.6	100

VII. Përbërja e grumbullit pyjor

Perkufizimi: Pjesëmarrja e specieve kryesore e regjistruar ne sipërfaqen prove. Shprehet ne te dhjetat te llojeve perberes dhe speciet renditen sipas rendësisë se tyre.

Nje grumbull pyjor klasifikohet:

- i thjeshte nese perbehet vetem nga 1 lloj pyjor, ose kur nje specie e dyte ze me pak se 10% te sipërfaqes (psh: 1.0 Ah).
- i përzierë nëse perbehet nga 2 ose me shume lloje. Grumbujt pyjore te perziere ndryshojne ne saje te pjesmarries se specieve psh:
- grumbull pyjor me 50% bredh, 30% ah & 20% panje (5 Br+3Ah+2 Pa) kalsifikohet si grumbull pyjor miks i bredhit dhe ahut e panjes
- grumbull pyjor me 60% ah, 40% Pise e zeze (6 Ah+4 P.z) klasifikohet si grumbull pyjor i perziere i dominuar nga ahu me pjesmarrje pise te zeze.

Specifikimi: regjistro speciet (sipas Aneksit ...) dhe mbulesen ne perqindje. Informacioni mbi perberjen e specieve te nenparceles pyjore do sigurohet nga matjet brenda sipërfaqeve prove.

VIII. Kurorë-dendësia

Perkufizimi: Kurorë-dendësia (KD) nenkupton shkallen e afrimit te kurorave te drureve ose shkallen e mbylljes se kurorave. Ai i referohet vetem drureve te katit te siperm ne grumbull pyjor. Ne rastin e fletoreve kurordendësia duhet te vlerësohet vetem gjate veres, ndersa per haloret gjate gjithë vitit. Klasifikimi i grumbujve sipas kurordendësisë do te jete:

Nr	Kurordendësia	Percaktimi
1	0.1-0.3	Sipërfaqe me bimesi pyjore
2	0.4-0.6	Pyll me kurorëdendësi te ulet
3	0.7-0.9	Pyll me kurorëdendësi thujse te plote

4	1.0	Pyll me kurorëndendesi te plote
---	-----	---------------------------------

IX. Klasa e moshes

Percaktimi: Klasa e moshes nenkupton numrin e viteve ose amplituden e viteve ku grumbulli pyjor mbetet i pandryshuar nga pikpamja ekonomike. Bazuar ne moshen e drureve, grumbujt pyjore ndahen ne: (i) njemoshare dhe (ii) shumemoshare.

Specifikimi: Ne trunqishte klasat e moshes jane 20 vjet, cunqishte 10 dhe shkurre 5 vjet. Me poshte po japim klasat e moshes sipas trunqishteve, cunqishteve dhe shkurreve.

Trunqishte

Klasa e moshes	Numri viteve ne secilen klase
1	1-20 vjeç
2	21-40 vjeç
3	41-60 vjeç
4	61-80 vjeç
5	81-100 vjeç
6	101-120 vjeç
7	121-140 vjeç

Cunqishte

Klasa e moshes	Numri viteve ne secilen klase
1	1-10 vjeç
2	11-20 vjeç
3	21-30 vjeç
4	31-40 vjeç
5	41-50 vjeç
6	51-60 vjeç

Shkurre

Klasa e moshes	Numri viteve ne secilen klase
1	1-5 vjeç
2	6-10 vjeç
3	11-15 vjeç
4	16-20 vjeç
5	21-25 vjeç
6	> 25 vjeç

X. Volumi

Perkufizimi: volumi shprehet ne m³ per speciet kryesore. Ai llogaritet per 1 ha dhe ne nivel nenparcele/parcele pyjore.

Specifikimi: llogaritet duke perdorur tabelat e volumit per disa specie ose sipas ekuacioneve te volumit sipas IKP(2004) ose duke ndertuar ekuacione te reja volumi bazuar ne matjet e kryera ne terren. Ne rastin e grumbujve pyjore te perziere volumi duhet te llogaritet per secilen specie bazuar ne perqindjen e tyre.

XI. Diametri mesatar

Perkufizimi: Eshte diametri mesatar i siperfaqes bazimetrike (d_g) ose diametri i drurit mesatar te grumbullit pyjor dhe shprehet ne cm.

Specifikimi: Llogaritet per secilen specie bazuar ne siperfaqen bazimetrike dhe numrin e drureve per ha sipas

ekuacionit: $\bar{g} = \frac{G}{N}$; $d_g = \sqrt{\frac{4 \cdot \bar{g}}{\pi}}$

ku:- g_{mes} -siperfaqja bazimetrike mesatare; G-siperfaqja bazimetrike e grumbullit (m²/ha); N-numri total i drureve per 1 ha; d_g -diametri mesatar i siperfaqes bazimetrike(cm).

XII. Lartesia mesatare

Perkufizimi: Eshte lartesia mesatare e grumbullit ne meter

Specifikimi : Llogaritet duke perdorur ekuacionin Lorej si me poshte:

$$h_g = \frac{g_1 \cdot h_1 + g_2 \cdot h_2 + \dots + g_n \cdot h_n}{g_1 + g_2 + \dots + g_n}$$

ku: h_g -lartesia e drurit mesatar te siperfaqes bazimetrike; g_i -siperfaqja bazimetrike e kategorise diametrike(m²); h_i -lartesia mesatare e kategorise diametrike(m).

XIII. Numri i drureve

Perkufizimi: numri drureve per speciet kryesore per 1 ha dhe numri total per nenparcele/parcele.

Specifikimi: regjistrohet numri i drureve sipas specieve dhe perqindja ne raport me totalin

XIV. Siperfaqja bazimetrike

Perkufizimi: Siperfaqja bazimetrike percaktohet per speciet kryesore dhe shprehet ne m². Ajo llogaritet per hektar dhe per siperfaqen totale te nenparceles/ parceles.

Specifikimi: regjistrohet siperfaqja per secilen specie dhe per siperfaqen totale te nenparceles pyjore.

XV. Struktura vertikale

Perkufizimi: Percaktohet ne baze te kateve te kurorave te grumbullit bazuar ne kriteret e meposhtme:

Nr	Kati	Perkufizimi
1	Kati siperem	< 1/3 e lartesisë dominante/zoteruese te grumbullit
2	Kati mesem	1/3-2/3 e lartesisë dominante/zoteruese te grumbullit
3	Kati poshtem	> 2/3 e lartesisë dominante/zoteruese te grumbullit

XVI. Homogjeniteti

Perkufizimi: Grumbulli pyjor eshte homogjen nga pikapmja silvikulurore dhe gjeomorfologjike.

Specifikimi: Kur dy grumbuj pyjore kane te njejte moshe, kurordendesi, perberje llojore, klase prodhimi dhe strukture jane homogjene.

XVII. Tipet e grumbujve

Perkufizimi: Tipi i grumbullit percaktohet sipas perzierjes se llojeve dhe sherben per analizimin statistik te grumbujve dhe percaktimin e objektivave te mbareshtrimit dhe trajtimet silvikulturale.

Specifikimi: Futet kodi me shifra (3 ose 4) nga aneksi

XVIII. Intensiteti i mbareshtrimit

Perkufizimi: Bazohet ne vleresimin e gjendjes aktuale te grumbullit dhe te stacionit.

Specifikimi: Regjistrohet niveli i intensitetit sipas klasifikimit të mëposhtëm:

Niveli i Intensitetit	Specifikimi	Perzgjedhja
I ulet	Pyje qe nuk mund te menaxhohe pasi jane te pa mbërritshëm per shkak te terrenit te veshtire	Sheno me kryq <input type="checkbox"/>
Mesatar	Pyje qe nuk perfshihen ne 2 nivelet e tjera	Sheno me kryq <input type="checkbox"/>
I larte	Pyje lehtesisht te mberritshem dhe qe kane nevojte per trajtime silvikulturale	Sheno me kryq <input type="checkbox"/>

XIX. Origjina e pyllit

Perkufizimi: Origjina percaktohet duke iu referuar specieve mbizoteruese ne grumbullin pyjor(nenparcelen pyjore). Ajo mund te jete natyrore ose artificiale.

Specifikimi: Ne rastin e origjines artificiale (pyllezimet) regjistrohet viti i kryerjes se pyllezimit (psh: 1987),ne rastin e origjines natyrore regjistrohen specifikimet e meposhtme:

Origjina	Specifikimi	Perzgjedhja	Origjina	Perzgjedhja
Natyrore	Me fare	Sheno me kryq <input type="checkbox"/>	Artificiale	Sheno vitin <input type="text"/>
	Me lastare (vegetative)	Sheno me kryq <input type="checkbox"/>		

	E perziere (fara dhe lastare)	Sheno me kryq <input type="checkbox"/>
	E papercaktuar	Sheno me kryq <input type="checkbox"/>

XX. Ripërteritja/rigjenerimi

Perkufizimi: vleresimi i pranise dhe cilesise se ripërteritjes

Specifikimi: regjistroheshen te dhenat e meposhtme per druret me diameter bazimetrik > 2 cm.

Te dhenat	Tipi i rigjenerimit	Perzgjedhja
Origjina e rigjenerimit	Natyrore	Sheno me kryq <input type="checkbox"/>
	Artificiale	Sheno me kryq <input type="checkbox"/>
Lartesia mesatare e filizave ne m dhe dm (psh: 2.35 m)	Drure te rinj < 1,3 m lartesi	Sheno <input type="checkbox"/> , <input type="checkbox"/>
	Drure te rinj > 1,3 m lartesi	Sheno <input type="checkbox"/> , <input type="checkbox"/>
Speciet kryesore	Kodi nga Standarti 2	Sheno <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>
Numri i filizave per m ²	Numer	Sheno <input type="checkbox"/>

XXI. Cilesia e grumbullit

Perkufizimi: Cilesia e grumbullit percaktohet ne baze te raportit midis volumit te lendes se punimit ndaj volumit total.

Specifikimi: sipas tabelës se meposhtme

Klasa e cilesise	Kriteret e percaktimit	Perzgjedhja
3	Lenda e punimit ze me pak se 60% te volumit per haloret dhe 30% per fletoret.	Sheno me kryq <input type="checkbox"/>
2	Lenda e punimit ze 61 - 80 % te volumit per haloret dhe 30 - 50 % per fletoret.	Sheno me kryq <input type="checkbox"/>
1	Lenda e punimit ze > 80 % te volumit per haloret dhe > 50 % per fletoret.	Sheno me kryq <input type="checkbox"/>

XXII. Nderhyrjet per permirsimin e gjëndjes

Perkufizimi: nevoja per nderhyrje ne grumbull pyjor(nenparcele) ne vitin pasardhes.

Specifikimi: sipas tabelës se meposhtme

Niveli perkujdesjes	Kriteret e percaktimit	Perzgjedhja
E ulet	Asnje nderhyrje brenda 5 viteve te ardhshme, cilesi e mire e drureve te se ardhmes	Sheno me kryq <input type="checkbox"/>
Mesatare	Nderhyrjet jane te nevojshme brenda 5 viteve te ardhshme per te permirsuar cilesine, ulur numrin e drureve, rregulluar perzierjen e specieve dhe lenden drusore.	Sheno me kryq <input type="checkbox"/>
E larte	Nderhyrje urgjente sepse gjendja e grumbullit nuk mund te permirsohet me tej.	Sheno me kryq <input type="checkbox"/>

XXIII. Gjëndja shëndetsore

– Drurët e tharë

Perkufizimi: Drurët e thare duhet të regjistrohen si tregues të biodiversitetit. Duhet të shprehet në % ndaj numrit total të druveve.

Specifikimi: Te jepet arsyja kryesore e tharjes së druveve: 1-shpyllezimi, 2-mbikullotja, 3-zjarret, 4-demtuesit, 5-kafshet e egra, 6-shfrytezimi, 7-ererrat, 8-debora, 9-zhvillimet urbane, 10-te panjohura. Futni edhe % e ç'gjethzimit.

– Tipi dhe niveli i dëmtimit

Përkufizimi: Gjatë matjeve në terren (inventarizimi) duhet të behet vleresimi rreth specieve dhe shkallës së dëmtimeve të ndryshme të druveve brenda sipërfaqeve provë.

Specifikimi: Duhet të shenohet shkalla e dëmtimit (me numer) duke shënuar maksimumi 2 tipe dëmtimesh si psh: intensiteti i dëmtimit dhe % e dëmtimit:

Niveli i intensitetit	Perzgjedhja
< 6 %	Sheno me kryq <input type="checkbox"/>
6-25 %	Sheno me kryq <input type="checkbox"/>
26-50 %	Sheno me kryq <input type="checkbox"/>
51-75 %	Sheno me kryq <input type="checkbox"/>
76-100 %	Sheno me kryq <input type="checkbox"/>

XXIV. Prerjet e paligjshme/ilegale

Perkufizimi: Prerjet e paligjshme janë një problem për reduktimin e mbulesës pyjore. Identifikimi duhet të behet direkt në terren (sipas shenjave të prerjeve), ose nga informacioni që ka administrata pyjore lokale.

Specifikimi: duhet të shenohet % e sipërfaqes së dëmtuar, numri i druveve në % ndaj numrit total në nenparcele si dhe ndarja e volumit në asortimente dhe volumi total i prerë ilegalisht në 1 ha.

XXV. Bimesia barishtore

Perkufizimi: jepet në % e sipërfaqes së mbuluar nga speciet kryesore sipas grupeve agronomike

Specifikimi: grupet e specieve sipas veçorive agronomike (graminace, leguminoze, të tjera)

XXVI. Biodiversiteti

Specifikimi: Ndarja sipas vegetacionit aktual dhe potencial, shkalla e natyralitetit, prania e habitateve, speciet e rrezikuara (me kodin e species) dhe rreziku për biodiversitetin.

XXVII. Speciet e kërcënuara

Specifikimi: shenohet kodi i species sipas listës dhe shënohet statusi- i/e rrezikuar

XXVIII. Kullotat

Specifikimi: Shenohet kodi duke përdorur treguesit e mëposhtëm:

- Periudha e përdorimit (verore, dimërore)*
- Përdoruesi (familje ose kolektive) *
- Tipi (kullote, livadh, kullote me drure etj)
- Biomasa (kv/ha)
- Mbulesa % (drure, shkurre, bime barishtore, etj.)*
- Probleme të kullotjes/dëmtimit (mbikullotja, kullotja ilegale, djegia e kullotes etj)
- Bagëtite dhe kapaciteti mbajtës (tipi dhe numri i kafsheve, intensiteti, kapaciteti mbajtës)*

D.6. REKOMANDIMET PËR MENAXHIMIN

Bazuar në vërtetimet në terren dhe inventarizimin, ekspertët duhet të përcaktojnë masat që do zbatohen në të ardhmen. Me poshtë kemi listuar masat e nevojshme që duhet të planifikohen në kuadër të PMPK. Ekspertët që do anagazhohen nga Bashkia për hartimin e këtij plani duhet të vendosin masat në skedën e përshkrimit parcellar. Këto indikacione duhet të jenë në koherencë me planin e nderhyrjeve (tipin e nderhyrjeve,

madhesine, vitin e zbatimit etj). Keto masa ndahen ne 2 grupe kryesore: 1-masa qe lidhen me menaxhimin e pyjeve dhe kullotave ; 2-masa qe lidhen me infrastrukturen.

I. Menaxhimi dhe masat

- Funkzioni kryesor dhe specifik (i propozuar)
- Perdorimi i territorit (i propozuar)
- Tipi i grumbullit pyjor (i propozuar)
- Sistemi i mbareshtrimit (i propozuar)

II. Pyllezimi/ripyllezimi

- Pergatitja e terrenit per mbjellie
- Mbjellia (fidane, fare, % e siperfaqes, speciet)
- Masat per mirembajtien (pleherimi, vaditja, krasitja e degeve te thara, zëvendesimi i fidaneve te thare etj)
- Masat per mbrojtje (gardhimi)

III. Masat ne trungshte

- Pastrime dhe rrallime (percakto prioritetin, siperfaqen, dhe intensitetin ne % per nje tip te vetem te nderhyrjes)
- Prerje suksesive (percakto prioritetin, siperfaqen, dhe intensitetin ne % per 1 faze te vetme)
- Prerje shfrytezimi (percakto prioritetin, siperfaqen, dhe intensitetin ne % per nje tip te vetem te nderhyrjes)

IV. Masat ne cungishte dhe shkurre

- Permirsimi i cungishteve te degraduara (percakto prioritetin, siperfaqen, dhe intensitetin ne % per nje tip te vetem te nderhyrjes)
- Prerje shfrytezimi ne cungishte/shkurre (percakto prioritetin, siperfaqen, dhe intensitetin ne % per nje tip te vetem te nderhyrjes)

V. Masat per konservim/ruajtje

- Plane specifike (perzgjidh kerkimin, edukimin, informimin, monitorimin)
- Masat: perzgjidh gardhimin, panelet etj.

VI. Restaurimi i siperfaqeve te degraduara

- Masat per erozionin
- Masat per rreshqitjet
- Masat pergjate perrenjve dhe lumenjve
- Masat ne siperfaqe te djegura

Specifikimi: Identifikoni nepermjet numrit tipin e nderhyrjes. Nese eshte nje nderhyrje e re jepni siperfaqen e pershkruar si dhe gjatesine.

Kodi	Tipi i nderhyrjes
1	Nderhyrje me impakt te vogel (nderhyrje bio-inxhinjerike)
2	Mbjellie e drureve dhe barit
3	Gabionat
4	Pritat me mure betoni
5	Pritat me mur guri
6	Te tjera

- Ndikimet mjedisore te nderhyrjeve
 - Ndikimi i shfrytezimeve pyjore mbi faunen, floren, perdorimin e territorit, biodiversitetin etj
 - Ndikimi pyllezimeve mbi faunen, floren, perdorimin e territorit, biodiversitetin etj
 - Ndikimi i ndertimit te rrugeve pyjore mbi floren, faunen, perdorimin e territorit, biodiversitetin etj
 - Ndikimi i kullotjes mbi floren, faunen, perdorimin e territorit, biodiversitetin etj
 - Ndikimi i njeriut mbi floren, faunen, perdorimin e territorit, biodiversitetin etj

VII. Permirsimi i kullotave dhe infrastruktura

- Permirsimi i kullotave (percaktoni masat dhe jepni siperfaqen ne ha)
 - pastrimi nga shkurret/bimet e keqia
 - largimi i gureve, pleherimi
 - mbjellia e bimeve barishtore, etj.
 - pleherimi
- Infrastruktura e kullotave (perzgjidhni gjatesine, numrin)
 - gardhet
 - pikat e furnizimit me uje te pijshem(lera, korita, hauze)
 - baraka/streha te barinjve

VIII. Infrastrukturat

Specifikimi: Me poshte jepen kategorite kryesore te te infrastruktures se planifikuar dhe menaxhuar nga PMPK. Per secilen kategori eshte e mundur te percaktohen keto te dhena duke bere edhe perzgjedhjet perkatese:

Treguesit	Perzgjidhja
tipi (tipi i nderhyrjes)	Sheno me kryq <input type="checkbox"/>
mirembajtje (nese eshte nderhyrje per mirembajtje)	Sheno me kryq <input type="checkbox"/>
E re (nese eshte nderhyrje e re)	Sheno me kryq <input type="checkbox"/>
numri aktual (numri i nderhyrjeve ne strukturat aktuale)	Sheno me kryq <input type="checkbox"/>
Numri i propozuar (numri i nderhyrjeve te propozuara)	Sheno me kryq <input type="checkbox"/>
km aktual (km nderhyrje te mirembajtjes mbi rruget aktuale ose shtigjet)	Sheno me kryq <input type="checkbox"/>
km e propozuar (km e nderhyrjeve te propozuara ne rruget e reja apo shtigjet)	Sheno me kryq <input type="checkbox"/>

Tipet kryesore dhe kodet numerike per secilen kategori jepen ne tabelen e meposhtme:

Kategoria	Tipet dhe Kodet
Ndertesat	1 magazina te lendes drusore, impiante perpunimi te lendes, zyra 2 ngrehina per mjetet ne pyje dhe per punetoret 3 streha, restorante 4 kasolle
Rruget, mjetet e transportit	1 rruge kryesore per kamiona 2 rruge dytesore per kamiona 3 rruge per traktora 4 rruge per rreshqitje 5 teleferik
Shtigjet	1 per kembesor, ecje ne natyre, ecje me kuaj 2 didaktike 3 tradicionale/historike
Zonat per piknik	1 zona per piknik 2 zona per piknik me ngrehina 3 stola
Zona didaktike	1 zona didaktike (panelet, stola, etc.) 2 muze te vegjwl (natyren, ekologji, historia e drurve, etj.) 3 kulla vrojtimi, fasilite per vrojtimin e zogjve
Rreshqitjet	1 struktura per kontrollin e rreshqitjeve
Pritat	1 prite (liqen artificial per furnizimin me uje) 2 prite (liqen artificial per prodhim energjie)
Uje	1 kanal

	2 burime
Kontroll zjarresh	<ul style="list-style-type: none"> 1 pike furnizimi uji (per paisjet nga toka) 2 pike furnizimi uji (per paisjet nga ajri) 3 korridoret 4 kullat e vrojtimit
Te tjera	<ul style="list-style-type: none"> 1 fidanishte 2 impiante biomase 3 Mundesi per te futur nderhyrje te tjera te veçanta per planin e mbareshtrimit.

E. PUNA NE ZYRE – RAPORTIMI DHE PLANIFIKIMI I AKTIVITETEVE

E.1. PERGATITJA E RAPORTIT

E.1.1. UDHEZIMET BAZE PER PERGATITJEN E RAPORTIT TE PMPK

Proçesi i përgatitjes së PMPK duhet të respektojë disa standarde dhe të sigurojë produkte finale homogjene (raportet, hartat etj) me qëllim perpunimin e të dhenave, krahasimin midis dy planeve të njepasnjeshme të mbareshtrimit, transferimin e të dhenave në SISP si dhe ruajtjen e koherencës me IKP. Pjesa e shkruar e raportit, tabelat dhe hartat duhet të përgatiten sipas udhëzimeve të mëposhtme.

- Kronologjia e përmbajtjes së PMPK duhet të ruhet dhe nëse për 1 nga kapitujt nuk ka informacion ai nuk duhet të hiqet dhe në këtë rast mjafton të shkruhet "nuk është e rëndësishme për ekonominë pyjore" ose "Nuk ka të dhena ose informacion".
- Raporti duhet të shkruhet në formatin A4 (297 x 210 mm) dhe nëse është e nevojshme që të printohen hartat ato duhet të kenë një format maksimumi A0 (1189 x 841 mm). Nëse është e nevojshme gjatë printimit duhet të ruhet ky format për hartat dhe mirë është që hartat të prodhohen nëpërmjet platformës së informacionit SISP.
- Kopjet e PMPK duhet të printohen në letër të bardhë në një dosje plastike me 2 rrate metalike dhe kopjet dixhitale të planit duhet të ruhen në SISP.

Të dhënat e grumbulluara nga sipërfaqet prove do të përpunohen nëpërmjet programit të rikonfiguruar MS Access dhe po kështu edhe informacioni për përshkrimin parcelar/nenparcelar (duke përdorur databesin standard and burimet që janë pa pagesë për GIS) dhe me pas duhet të transferohet në SISP. Për më tepër shkruarimi i raportit të planit të mbareshtrimit duhet të jetë "**shkruaj qarte dhe shkurt**".

Standarti për Faqen e Parë:

Emri i Bashkisë; Emri i Ekonomisë Pyjore; Plani i Mbareshtrimit të Pyjeve dhe Kullotave për periudhën 20.. - 20...data; Emri; vula dhe firma e kontraktorit.

Standarti për Faqen e Dytë:

Emri i Bashkisë; Emri i Ekonomisë Pyjore; Plani i Mbareshtrimit të Pyjeve dhe Kullotave për periudhën 20.. - 20...Kodi SISP; Emri; vula dhe firma e Personit Përgjegjës të Ekipit të Punës në terren; emrat e anëtarëve që kanë hartuar planin e mbareshtrimit me firmë dhe vule; data e aprovimit të Planit.

E. 2. PERMBAJTIA E RAPORTIT TE PLANIT TE MBARESHTRIMIT

- Përmbledhje ekzekutive
- Harta e vendodhjes së Ekonomisë Pyjore/NJM

E.2.1 HYRJE

E.2.1.1. Qëllimi dhe objektivat e Planit të Mbareshtrimit të Pyjeve dhe Kullotave (PMPK)

E.2.1.2. Ecuria e punës dhe përgjegjësitë

E.2.1.3. Metodologjia e Punës

E.2.1.4. Informacioni i përdorur në hartimin e PMPK

E.2.2 PERSHKRIMI I PERGJITHSHEM I EKONOMISË PYJORE

E.2.2.1. Informacion i pergjithshem rreth Ekonomise pyjore

Pershkruaj statusin civil dhe administrativ te Bashkise, emrin e Ekonomise Pyjore, siperfaqen totale te ekonomise pyjore dhe periudhen e vlefshmërise se planit te mbareshtimit (nga 20.. deri 20..). Shpjego arsyet per hartimin e nje plani te ri (plani i meparshem i skaduar, kufijte e rinj etj) dhe jep nje pershkrim te shkurter te ekonomise se meparshme pyjore (emri dhe siperfaqja totale).

E.2.2.2. Pronesia, administrimi dhe organizimi

Jepni nje tablo te pronesise dhe te perdoruesve ne te shkuaren dhe ndryshimet qe lidhen me kete çështje. Pershkruaj te drejtat e banoreve ne perdorimin e burimeve pyjore dhe kullosore (kullotje, mbledhje bimesh mjeksore, legushe etj) dhe jep nje liste te perdoruesve. Pershkruaj shkurtimisht perfshirjen e grave dhe burrave (banoreve lokale) ne te kaluaren (duke dhene ne menyre me specifike rolin e tyre dhe pjesmrrjen efektive), perdorimin e produkteve pyjore (drusore dhe jo drusore), produktet e kullotave si dhe te dhena per mbareshtimin e tyre.

E.2.2.3. Vendodhja gjeografike dhe ndarja administrative

Jepni siperfaqen totale te ekonomise pyjore dhe numrin e parcelave dhe nenparcelave (ne forme tabelare) dhe ne nje diagrame jepni shperndarjen e siperfaqes sipas pyjeve, shkurreve, kullotave, siperfaqeve inproduktive dhe formave te tjera. Jepni nje harte te ekonomise pyjore dhe kullosore me kufijte me ngjyre te gjelber, kordinatat gjeografike, rruget kryesore, rrjedhiet ujore dhe trupat ujore (elementet baze te hartes, shiko seksionin 4) **maksimumi 1 faqe ne formatin A4**. Përshkruaj shkurtimisht kufijtë e ekonomise pyjore dhe kullosore dhe nenvizo diferencat me ekonomine e meparshme nese ka dhe po keshtu edhe ndryshimet ne vlerat mjedisore, ekonomike dhe ne infrastrukture (mund ti pershkruani edhe nepermjet hartave keto ndryshime).

E.2.2.4. Konteksi i Bashkise dhe Ekonomise Pyjore

Pershkruani kontekstin e pergjithshem te Bashkise dhe ekonomise pyjore duke iur referuar territorit te bashkise, gjendjes social-ekonomike etj mbi te gjitha ne lidhje me bashkite fqinje, zonat e mbrojtura etj (shiko Aneksin 12).

E.2.2.5. Historiku i Mbareshtimit te Pyjeve dhe Kullotave ne Ekonomine Pyjore

Jepni nje pershkrim te shkurter te te dhenave kryesore ne lidhje me ekonomine e meparshme pyjore dhe percaktoni ndryshimet duke iur referuar gjendjes aktuale ne siperfaqe. Jepni komentet tuaja dhe shkaqet per keto ndryshime. Te dhenat mund te jene:

- siperfaqja totale e ekonomise dhe % e mbuleses pyjore dhe shkurreve
- tipet kryesore te pyjeve, fazat e zhvillimit, format e qeverisjes
- funksionet kryesore dhe shperndarja e siperfaqes sipas funksioneve
- periudha e vlefshmerise se planit te meparshem te mbareshtimit
- nderhyrjet e zbatuara dhe rezultatet e tyre

E.2.2.6. Situata demografike dhe social-ekonomike

Pershkruaj te dhenat demografike aktuale si: (i) numri total i banoreve; (ii) klasat e moshes; (iii) raporti femra/meshkuj referuar bashkise dhe nese eshte e mundur edhe ne nivel njesie administrative apo fshati. Keto te dhena te jepen ne forme tabelare per ekonomine pyjore dhe per ate fqinje.

Pershkruaj gjendjen aktuale te banoreve lokale (gra dhe burra) te perfshire ne aktivitetet ne pyje dhe kullota, turizem, rekreacion, aktivitete didaktike lidhur me te gjitha funksionet dhe gjendjen lokale, specifikoni rolin e tyre dhe aktivitetet, per te vleresuar masat qe do zbatohen ne te ardhmen si dhe ndikimin e ndryshimeve demografike ne te ardhmen.

E.2.2.7. Marketingu i produkteve pyjore drusore dhe jodrusore

Te jepet nje tablo e shkurter mbi gjendjen aktuale dhe asaj ne te kaluaren te sasise dhe cilesise se produkteve drusore dhe jo drusore, ndermarrjet pyjore, punetoret qe kane punuar ose punojne ne pyje, sharrat/gadrrat dhe perdoruesit e tjere te produkteve drusore. Te jepen te dhena per strukturat pyjore (barrakat,magazinat etj) dhe te pasqyrohen ato ne harten e planit te mabreshtrimit. Te pershkruhet niveli i mekanizimit te punimeve ne pyjet e ekonomise pyjore si dhe te pershkruhet niveli i aftesive profesionale te punetoreve lokale.

E.2.2.8. Gjuetia dhe peshkimi

Jepni nje tablo te gjendjes se faunes, gjuetise dhe peshkimit ne termat e sasise (nese eshte e mundur), impaktin mbi ekosistemet pyjore dhe kullosore, menaxhimin e tyre si dhe trendin e ketyre produkteve ne treg. Vleresoni kushtet per permirsimin e faunes se eger,peshkimit dhe gjuetise.

E.2.2.9. Fasilitetet rekreacionale dhe didaktike

Te pershkruhet prania e strukturave per zhvillimin e turizmit rural brenda territorit te ekonomise pyjore dhe ne zonat fqinje me te (zonat per piknik, kampingjet,hotelet,restaurantet etj) dhe vendodhja e tyre. Te pershkruhen edhe zonat didaktike dhe jepni nje tablo te aktiviteteve didaktike qe lidhen me pyjet dhe kullotat (nga shkollat, shoqatat lokale etj). Po keshtu te pershkruhen shtigjet dhe rrugicat me interes te veçante per ecjet ne mal, garat me biçikleta, xhirot me kuaj etj, ne brendesi te territorit te ekonomise pyjore dhe ne ekonomite pyjore fqinje. Po keshtu te jepen disa te dhena per punesimin e grave dhe burrave ne aktivitete dhe role te ndryshme si dhe numrin e turisteve, frekuencen e tyre dhe potencialin e ekonomise pyjore per zhvillimin e turizmit natyror.

E.2.2.10. Prania e zonave te mbrojtura, specieve dhe stacioneve

Te jepet prania e zonave te rendesishme te identifikuar nga vrojtimit direkte ne terren si: rezervatet gjenetike, speciet e rrezikuara. Po keshtu te sigurohet ky informacion edhe nga studimet e kryera, literatura ose nga informacioni i administrates dhe banoreve lokale. Te jepet ne harten e ekonomise pyjore vendodhja e ketyre zonave te rendesishme dhe e zonave te mbrojtura (elementet tematike te hartave te planit te mbareshtrimit, seksioni 4, maksimumi ne formatin A4). Prania e tyre eshte e rendesishme per te vleresuar dhe kordinuar aktivitetet si: permirsimi dhe zhvillimi i shtigjeve dhe rrugicave, aktivitetet didaktike qe te propozohen gjate hartimit te planit te mbareshtrimit.

E.3. GJENDJA AKTUALE E PYJEVE DHE KULLOTAVE

E.3.1. MBARESHTIRIMI DHE FUNKSIONET E PYJEVE DHE KULLOTAVE

E.3.1.1. Perdorimi i territorit (aktual & propozimet)

Jepni nje informacion te shkurter per siperfaqen e ekonomise pyjore sipas kategorive te perdorimit te territorit si dhe propozimet per ndryshimet respektive. Jepni shpjegimet per keto ndryshime si dhe tendencen e tyre ne te ardhmen.

E.3.1.2. Forma e qeverisjes (aktuale dhe propozimet)

Jepni siperfaqen aktuale dhe te propozuar ne perqindje sipas formave te qeverisjes. Shpjegoni ndryshimet dhe tendencen e tyre ne te ardhmen dhe cilat jane pasojat per planin e mbareshtrimit.

E.3.1.3. Ndarja e ekonomise pyjore ne parcela dhe nenparcela

Jepni ne forme tabelare listen e te gjitha parcelave dhe nenparcelave qe perbejne ekonomine pyjore sipas Kadasres Pyjore ose AIFIS sipas rendit numerik (parcelat) dhe atij me shkronje(nenparcelat).Pershkruani kriteret e perdorura per ndarjen dhe jepni te dhena te tjera te rendesishme sipas tabelës se meposhtme.

Parcela n.	Kodi nengatsres	Vendodhja	Sip(ha)	Pronesia	Perdorimi tokes	Funksioni kryesor

E.4. KUSHTET STACIONALE

E.4.1. KLIMA

Paraqit dhe analizo te dhenat mbi temperaturën (mesataret mujore, vjetore, maksimumet dhe minimumet), periudhen e vegjetacionit, reshjet (vjetore, mesataret mujore, maksimumet 24 oreshe), treguesit e thatesires(Gausen,De Martone), lageshtine, erërat (frekuenca, drejtimet kryesore, periudha), dëbora/orteqet (trashesia e debores, periudha me debore dhe ngrica, orteqet). Keto te dhena te organizohen ne tabela dhe diagrama . Jepni te dhena mbi ngjarjet klimatike ekstreme gjate viteve te fundit ne territorin e ekonomise pyjore si: permytjet, stuhite e akullit, valet e te nxehtit, periudhat e me thatesirë etj. Shpjegoni ndikimet e ketyre kushteve klimatike ekstreme mbi rritjen e pyjeve dhe kullotave dhe pasojat e tyre per planifikimin.

E.4.2. TOPOGRAFIA DHE MORFOLOGJIA

Ne kete pike te jepet altituda minimale, maksimale dhe mesatare mbi nivelin e detit, kundrejtimi kryesor. Pershkruaj morfologjiine dominuese te ekonomise pyjore dhe situaten qe lidhet me menaxhimin e masave ose interesin per peisazhin, ecjet ne natyre dhe pershkruaji ato nepermjet fotove. Pershkruaj pjerresine e ekonomise pyjore (minimale,maksimal dhe mesatare) dhe pershkruaj zonat me kufizime per mbarështrim. Shpjego veshitresite dhe pasojat per planifikimin afat-gjatë.

E.4.3. GJEOLIGJIA

Jepni disa te dhena mbi vendodhjen e formacioneve kryesore gjeologjike qe ndeshen ne territorin e ekonomise pyjore si dhe tipet e shkembinjve te identifikuar gjate fazes se pershkrimimit parcelar. Vendos nje harte gjeologjike si dhe sheno kufijte e ekonomise pyjore me ngjyre te gjelber. Pershkruaj nese formacionet gjeologjike mund te krijojne probleme dhe pasoja per procesin e planifikimit.

E.4.4. TOKAT

Te pershkruhen tipet e tokes, reaksioni kimik, thellesia, struktura, lageshtia, lendet ushqyese. Vrojtmet ne terren duhet te kryhen nepermjet hapjes se profileve te tokes dhe klasifikimi i tipeve te tokes te behet sipas sistemit OBU & Bazes Boterore te Referencës se Tokave. Te dhenat mund te merren edhe nga harta pedologjike e Shqiperise (ose harta te tjera te vlefshme) te cilat mund te perditesohen nese konsiderohen si jo te sakta ose te vjetra. Nje ekstrakt nga keto harta me kufijte e Ekonomise pyjore duhet te jepet ne Planin e Mbarështrimit. Te jepen disa foto te kushteve mesatare dhe te kushteve qe lidhen me reduktimin e thellesise ose cilesise se tokave me fokus pranine e gureve ose ndonje reduktim te perberesve organike dhe shkaqet qe lidhen me keto ndryshime. Shpjegoni nese kushtet pedologjike mund te krijojne probleme apo pasoja gjate planifikimit.

E.4.5. RRJETI HIDROLOGJIK DHE BURIMET E FURNIZIMIT ME UJE

Pershkruani rrjetin hidrologjik dhe gjendjen e burimeve te furnizimit me uje (te jepet vendodhja e tyre ne harte). Te vleresohet regjimi hidrik i ujrave ne territorin e ekonomise pyjore dhe shpjegoni problemet per menaxhimin e tyre, identifikoni gjendjen kritike, si dhe jepni te dhena per ndonje permbytje ne te shkuaren si dhe jashte kufijve te ekonomise pyjore, por qe jane pjese e te njejtit basen lumor ,duke patur nje qasje dhe nje tablo te qarte rreth kontekstit dhe funksionit mbrojtës te pyllit. Percakto pranine e trupave ujore, funksionet e tyre, nevojat per mbrojtje dhe mundesine per perdorim ne rast zjarresh.

E.4.6. EROZIONI NE SHPATE DHE RRJEDHIET UJORE

Analizo gjendjen e erozionit ne shpate ne ekonomine pyjore, percakto tipet kryesore te erozionit, vendodhjen e tyre, gjendjen e shpateve dhe tokes. Jepni disa vlerësime te evolucionit ne vitet e fundit dhe ne te ardhmen si dhe jep nje tablo te shkaqeve si: degradimi vegjetacionit, zjarret ne pyje, mbikullotja etj. Analizo gjendjen e perrenjve dhe rrjedhieve ujore si dhe percaktoni problemet kryesore ne shtretërit e lumenjve, si dhe pershkruani gjendjen e vegjetacionit përgjatë rrjedhieve ujore. Vendosni disa foto qe tregojne gjendjen e rrjedhieve ujore, zonat e degraduara etj dhe percaktoni vendodhjen e tyre ne harten perkatese (harta e zonave te degraduara, Standartet 1). Shpjego nderlikimet e mundshme dhe pasojat per planifikimin afat-gjatë

E.4.7. RRËSHQITJET

Analizo pranine e rreshqitjeve te tokes ne territorin e Ekonomise Pyjore, duke percaktuar tipet kryesore te rreshqitjeve, vendodhjen e tyre dhe jepni nje vleresim mbi rreziqet e mundshme per njerezit, infrastrukturen (rruget, pritat, ndertesat), siperfaqet pyjore, rrjedhiet ujore. Jep nje vleresim te evolucionit te rreshqitjeve ne vitet e fundit dhe ne te ardhmen si dhe pershkruaj shkaqet (erozioni ne thellesi, realizimi i infrastruktures, degradimi i vegjetacionit, zjarret ne pyje etj) dhe nderhyrjet qe jane zbatuar. Po keshtu jepni disa foto te ketyre ç'rregullimeve dhe vendodhjen e rreshqitjeve kryesore ne harten perkatese (harta e zonave te degraduara,Standartet 1). Shpjego nderlikimet dhe pasojat per planifikimin.

E.5. VEGJETACIONI DHE BIODIVERSITETI

E.5.1. BREZAT BIOKLIMATIKE

Jepni ne forme tabelare brezat bioklimatike prezente ne ekonomine pyjore dhe siperfaqen e tyre duke perdorur te njejtin klasifikim me ate te IKP 2018. Ky klasifikim te kryhet sipas mënyrës së mëposhtme:

- Brezi i pyjeve dhe shkurreve mesdhetare kserofile dhe perhere te gjelber
- Brezi i pyjeve dhe shkurreve fletore termofile
- Brezi i pyjeve dhe shkurreve fletore mezofile
- Brezi i vegjetacionit barishtor alpin dhe xhuxh (ne zonat e larta malore)
- Vegjetacioni i pyjeve dhe shkurreve azonale

E.5.2. PYJET DHE KULLOTAT

Jepni nje pershkrim te shkurter te shperndarjes se pyjeve dhe kullotave ne ekonomine pyjore bazuar ne informacionin e pershkrimit parcelar, ne termat e siperfaqes se mbulimit sipas hartes se planit te mbarështrimit. Jepni te dhenat e meposhtme ne forme tabelare dhe me diagrame :

- siperfaqja totale e ekonomise pyjore ne hektar
- siperfaqja e mbuluar nga pyjet ne ha
- siperfaqja e mbuluar nga pyjet ne %
- siperfaqja e mbuluar nga shkurret ne ha
- siperfaqja e mbuluar nga shkurret ne %
- siperfaqja e mbuluar nga kullotat ne ha
- siperfaqja e mbuluar nga kullotat ne %
- siperfaqja e mbuluar nga format e tjera(siperfaqe inproduktive,trupat ujore) ne ha dhe ne %

Kjo tabelë mund të merret direkt nga SISP kur të jetë funksional.

Sip totale (ha)	Pyje (ha)	Pyje (%)	Shkurre (ha)	Shkurre (%)	Kullota (ha)	Kullota (%)	Te tjera (ha)	Te tjera (%)

E.5.3. TIPET E PYJEVE

Një përshkrim i shkurtër i tipeve të pyjeve brenda zonës pyjore i ndarë në kategoritë e përcaktuara në hartën e tipeve të pyjeve të planit të mbarestrimit (standarti,3). Organizojini të dhënat në formë tabelare dhe grafike duke dhënë:

- sipërfaqen e tipeve të pyjeve në ha
- përqindjen në raport me sipërfaqen totale të pyjeve
- përqindjen në raport me sipërfaqen totale të ekonomisë pyjore

Kjo tabelë mund të merret direkt nga SISP kur të jetë funksional.

Tipi i pyjeve	Sip(ha)	% sipërfaqes pyjore totale	% sip totale të njësise së mbarestrimit
Dominuar nga <i>Fagus sylvatica</i> L.			
Dominuar nga <i>Pinus sylvestris</i> L.			

E.5.4. TIPET E KULLOTAVE

Jepni shpërndarjen e kullotave dhe sipërfaqen e tyre sipas periudhës së përdorimit (verore ose dimërore) dhe bëni identifikimin e tyre në hartën e planit të mbarestrimit. Organizoni në formë tabelare ose paraqitini në formë diagrame këto të dhëna : (i) sipërfaqen e kullotave sipas përdorimit në ha; (ii) përqindja në lidhje me sipërfaqen totale të ekonomisë pyjore; (iii) përqindjen në lidhjen me sipërfaqen totale të kullotave. Tabela e mëposhtme mund të përfillohet direkt nga SISP kur të jetë funksional.

Tipi i kullotes	Sipërfaqja ha	% ndaj Sip totale të Kullotave	% ndaj Sip totale të ekonomisë pyjore
Kullota verore			
Kullota dimërore			

E.5.5. TIPET POTENCIALE TE VEGJETACIONIT

Përkruani speciet kryesore, speciet indikatorë, homogjenitetin dhe shpërndarjen e tyre në ha dhe në %.

E.5.6 BIODIVERSITETI

Të dhënat mbi biodiversitetin do të grumbullohen nga vrojtimi në terren gjatë fazës së përshkrimit të parcelar dhe ky informacion ruhet në SISP. Të dhënat kryesore duhet të fokusohen në:

- biotopet (shiko Standartin 5)
- habitatet
- speciet e kërcënuara (shiko Aneksin 10)
- vegjetacionin potencial (shiko Aneksin 11)
- rezervat biogjenetike

Është e nevojshme që të grumbullohen edhe të dhëna nga studime të tjera dhe të integrohen në planin e mbarestrimit si: raportet ekologjike, planet e vjetra të mbarestrimit dhe publikime të tjera (si psh: Rrjeti i Natyrës 2000 për habitatet) dhe informacioni lokal. Përcaktoni një listë me elementet ekzistues të biodiversitetit në Ekonominë Pyjore duke iu referuar kategorive të mëparshme dhe parcelave dhe paraqitini ato në hartën e planit. Përkruaj rëndësinë dhe impaktin mbi ekosistemet.

E.5.7. PRANIA E VLERAVE KONSERVUESE TE LARTA (VKL)

Prania e ketyre vlerave ne territorin e ekonomise pyjore do te identifikohen gjate fazes se pershkrimt parcelar dhe duhet te paraqiten ne harten tematike te PMPK. Nje udhezues i plote per te identifikuar keto vende dhe vlera mund te jete lista e meposhtme e vlerave konservuese te larta.

- VKL1: Diversiteti i Specieve
- VKL 2: Ekosistemet ne nivel peisazhi dhe mozaiket
- VKL 3: Ekosistemet dhe habitatet
- VKL 4: Sherbimet e ekosistemeve kritike
- VKL 5: Nevojat e komuniteteve
- VKL 6: Vlerat kulturore

Përcaktoni VKL ekzistuese ne territorin e Ekonomise Pyjore dhe përshkruani elementët dominues dhe vlerat e tyre (shiko Aneksin 10 per specifikimet).

E.5.8. RREZIQET PER BIODIVERSITETIN DHE EFEKTET MBI PLANIFIKIMIN

Percakto gjendjen aktuale te elementeve ekzistues te biodiversitetit dhe tipet e rreziqeve duke iu referuar te dhenave të pershkrimt parcelar.

E.5.9. MUNDESITE PER AKTIVITETET DIDAKTIKE DHE KERMIM SHKENCOR

Ne lidhje me elementet e biodiversitetit dhe vlerat ekzistuese te Ekonomise Pyjore, percaktoni kushtet aktuale te stacioneve prezente si: mbritshmerine nepermjet rrugeve dhe shtigjeve, pranine e kasolleve, strehave, zonave per piknik etj. Jepni disa te dhena lidhur me interesin e grave dhe burrave, mesuesve te shkollave, turisteve, eksperteve dhe kërkuesve shkencore për zhvillimin e aktiviteteve didaktike.

E.6. ANALIZA E PYJEVE DHE KULLOTAVE

E.6.1. ANALIZA E TË DHENAVE PËR PYJET

E.6.1.1. Analiza e tipeve të pyjeve

Paraqisni ne tabele rezultatet e analizes se tipeve te pyjeve duke dhene per secilen nenparcele te dhenat me kryesore si: klasa e moshes, forma e qeverisjes, volumi etj. Ky informacion merret nga SISP. Bëni komentet tuaja për këto te dhena si dhe per kushtet e tipeve te pyjeve ne lidhje me gjendjen shendetsore, strukturen vertikale, klasen e moshes, perberjen llojore etj.

Parcela nr	Kodi nen-parceles	Tipi i Pyllit	Sip (ha)	Klasa e moshes	Forma e qeverisjes	Volumi (m ³ /ha)	Vol. total (m ³)

E.6.1.2. Shperndarja e siperfaqes dhe volumit sipas formes se qeverisjes

Paraqisni te dhenat ne forme tabelare te cilat merren nga programi MS Access i rikonfiguruar ose nga SISP.

Trungishte

Parcela nr	Kodi nen-parceles	Tipi i Pyllit	Sip (ha)	Klasa e moshes	Volumi (m ³ /ha)	Vol. total (m ³)

Cungishte

Parcela nr	Kodi i nen-parceles	Tipi i Pyllit	Sip (ha)	Klasa e moshes	Volumi (m ³ /ha)	Vol. total (m ³)

Pyje te perziere

Parcela nr	Kodi i nen-parceles	Tipi i Pyllit	Sip (ha)	Klasa e moshes	Volumi (m ³ /ha)	Vol. total (m ³)

Shkurre

Parcela nr	Kodi i nen-parceles	Tipi shkurreve	Sip (ha)	Klasa e moshes	Volumi (m ³ /ha)	Vol. total (m ³)

E.6.1.3. Struktura e pyjeve sipas klasave të moshës dhe klasave të prodhimit

Paraqisni ne forme tabelare te dhenat per secilen forme qeverisje në lidhje me:

- siperfaqen totale kundrejt klases se moshes;
- volumin per hektar kundrejt klases se moshes;
- siperfaqen e specieve ne raport me klasat e moshes;
- volumi i specieve kundrejt klasave te moshes;
- siperfaqen totale per klasa prodhimi;
- volumin total per klasa prodhimi;
- siperfaqja sipas specieve kundrejt klasave te prodhimit
- volumin sipas specieve kundrejt klasave te prodhimit

E.6.2. ANALIZA E TË DHËNAVE TË KULLOTAVE

E.6.2.1. Gjëndja e kullotave

Bëni nje pershkrim te perberjes se specieve, gjëndjes së shkurreve dhe mbuleses se drureve ne siperfaqen kullosore, pranine e gureve, demtimet ne vegetacionin drusor nga kafshet, pranine e erozionit dhe rreshqitjet, reduktimi/limitet per kullotjen etj. Shpjego implikimet dhe pasojat per planifikim (parcelat/nenparcelat me funksione mjedisore/ mbrojtese lidhur me erozionin dhe rreshqitjet).

E.6.2.2 Madhesia e siperfaqes se kullotave dhe vendodhja e tyre

Jepni siperfaqen totale te kullotave, vendodhjen e tyre ose kushtet e fragmentimit brenda ekonomise pyjore e kullosore. Tregoni listen e nenparcelave/parcelave te kullotave bazuar ne pershkrimin parcelar, formen e pronesise, perdoruesit dhe te drejtat e perdorimit, fshatrat me te afert, menyren e perdorimit (kolektiv ose familjar). Keto te dhena gjenerohen nga tabelat e perftuara nga SISP.

Parcela nr	Kodi nenparceles	Sip (ha)	Pronesia	Perdoruesi	Fshati	Perdorim familjar	Perdorim kolektiv

E.6.2.3. Altituda, pjerresia, kundrejtimi, kushtet hidrologjike

Jepni amplituden e ndryshimit te lartesisë mbi nivelin e detit (altituda minimale, maksimale, mesatare), kundrejtimin dominues dhe pershkruani praninë e perrenjve dhe rrjetit hidrologjik brenda kullotave. Pershkruani lerat dhe burimet e furnizimit me uje per bagetite, percaktoni zonat me kufizime per kullotjen. Shpjegoni nderlikimet dhe pasojat per procesin e planifikimit.

E.6.2.4. Mbritshmëria

Bëni nje pershkrim te mbritshmerise ne zonat kryesore te kullotave, lidhjen me rrjet rrugor, distancën e kullotave nga fshatrat dhe kontrollo nese mbritshmeria eshte funksionale ne gjendjen që është dhe ç'fare ndikimi ka ne mbarështrimin e kullotave (si mund te perdoret per nderhyrje). Vleresoni nevojat per te zgjeruar rrjetin rrugor si dhe nevojat per te permirsuar gjendjen dhe kushtet e sigurise se rrugeve ekzistuese.

E.6.2.5 Grumbullimi i te dhenave per zonat e djegura ne kullota(10 vitet e fundit)

Ne kuader te grumbullimit te te dhenave per zjarret ne pyje dhe kullota, pergatisni nje liste te ngjarjeve dhe jepni te dhena lidhur me kullotat ne nje tabele te thjeshte duke perfshire ne te keto informacione: data; vendodhja; siperfaqja e djegur; perdorimi i territorit; forma e qeverisjes; shkaqet; demtimet; parcelat/nenparcelat kullosore. Shpjegoni pasojat ne cilesine e barit, erozionin dhe evolucionin e vegjetacionit. Bëni nje vleresim nese këto ngjarje jane te lidhura me menaxhimin e kullotave.

E.7. REZULTATET E INVENTARIZIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

E.7.1 REZULTATET E INVENTARIZIMIT TË PYJEVE

E.7.1.1. Analiza statistikore e Inventarizimit

Me qellim vleresimin e saktesisë se inventarizimit eshte e nevojshme te analizohen parametrat statistike kryesore:

- shmangia standart e vlerave te volumit midis siperfaqeve prove
- koeficienti i variacionit te te dhenave te volumit brenda siperfaqeve prove
- gabimi standart ne vlerë abosulte dhe % i llogaritur nga raporti i shmangies standart me rrenjen katrore te numrit te siperfaqeve prove

Keto parametra do te sigurohen nga programi MS Access dhe rezultatet e perpunimit statistikor do te perfshihen ne kete seksion.

E.7.1.2. Volumi dhe rritja ne volum e grumbujve pyjore

Volumi ne kembe do te llogaritet per secilen nenparcele dhe specie per 1 ha dhe per komplet siperfaqen pyjore. Volumi ne kembe duhet te ndahet ne asortimente dimensionale (lende e holle, e mesme dhe e trashe), dru zjarri, dege dhe mbeturina. Volumi ne kembe per 1 ha dhe per nenparcele sipas specieve duhet te llogaritet per secilen klase diametrike. Rritja ne volum do te llogaritet per secilen specie per 1 ha dhe per tere siperfaqen pyjore.

E.7.1.3. Struktura Vertikale

Analizoni shkurtimisht strukturen vertikale te pyllit dhe efektet mbi evolucionin e tipeve te pyjeve, mbrojtien e tokes etj. Jepni te dhena ne forme tabelare. Analizoni gjendjen e ripertitjes, origjinen, speciet kryesore, tipet e pyjeve qe kane me shume interes per tu rigjeneruar, lartesia mesatare, dendesia (numri i bimeve/m²).

E.7.1.5. Cilësia e materialit drusor

Jepni rezultatet e nxjerra nga vleresimi cilesor i grumbujve pyjore duke perdorur informacionin e regjistruar ne formularet e terrenit te siperfaqeve prove te perhershme dhe beni nje vleresim te karakteristikave silvikulturore dhe cilësisë së grumbujve pyjore.

E.7.1.6. Biomasa dhe Faktoret e Ekspansionit te Biomases

Faktoret e Ekspansionit te Biomases (BEF) te percaktuar tashme per disa specie ne nivel kombetar do te perdoren per llogaritjen e biomases mbitokesore duke perdorur te dhenat e volumit. Ne raste te tjera per speciet kur nuk ekzistojne BEF propozojme te perdoren faktoret nga studime te tjera per te njejtat specie nga vende qe kane kushte stacionale te ngjashme, ose te perdoren vlerat e propozuara nga Paneli Per Ndryshimet Klimatike ne vitin 2006. Te njejtat vlera referimi mund te perdoren edhe per densitetin e specieve.

E.7.1.7. Analiza e rolit te ekonomise pyjore ne sekuestrimin e karbonit

Bazuar ne vlerat e biomases se llogaritur duke perdorur metodologjine e propozuar ne piken 8.III, fraksioni i karbonit te merret 47-50 % e peshes se thate. Ndersa sasia e dioksidit te karbonit te sekuestruar nga speciet ne rastin e ekonomise pyjore te llogaritet nga shumezimi i sasise se karbonit me koeficientin 3.66. Bazuar ne rezultatet e perftuara, jepni nje vleresim te rolit te ekonomise pyjore ne sekuestrimin e karbonit.

E.7.2. GJËNDJA SHËNDETSORE DHE FITOSANITARE

Përshkruani dëmtimet nga zjarret, druret e thare, gjendjen fitosanitare, si dhe vleresoni shkaqet, efektet ne biodiversitet dhe gjendjen shëndetsore te grumbujve pyjore.

E.7.2.1. Drurët e tharë

Jepni rezultatet e nxjerra nga analiza per frekuencen dhe gjendjen e druveve te thare bazuar ne te dhenat e siperfaqeve prove. Perdorini keto te dhena per te nxjerre konkluzione per vlerat e biodiversitetit dhe ndikimin aktual ne gjendjen shëndetsore të pyjeve, ekuilibrin e ekosistemeve pyjore si dhe ne mbareshtimin e pyjeve.

E.7.2.2. Dëmtimet e tjera

Jepni rezultatet e nxjerra nga analiza e tipeve te demtimeve dhe shpjegoni pasojat e tyre mbi ekosistemet pyjore dhe mbareshtimin e pyjeve.

E.7.3. PRERJET E PALIGJSHME

E.7.3.1 Prerjet e paligjshme, gjendja aktuale dhe efektet ne procesin e planifikimit

Përshkruani dëmtimet e evidentuara gjate vrojtimit ne terren, pershkrimi parcelar, ose nga burime te tjera, problemet si dhe tendencën e tyre. Nëse ekzistojne te dhena vjetore të prerjeve ilegale ky informacion mund të perdoret për te analizuar tendencën e prerjeve të paligjshme ne siperfaqen e ekonomise pyjore.

E.7.3.2. Impakti i prerjeve ilegale ne planifikimin dhe mbareshtimin e pyjeve

Shpjegoni impaktin e prerjeve te paligjshme ne mbareshtimin afat-gjate te ekonomise pyjore.

E.7.4 REZULTATET E INVENTARIZIMIT TE KULLOTAVE

E.7.4.1. Tipi dhe cilesia e kullotave

Jepni rezultatet per siperfaqen e kullotave ne hektare dhe siperfaqen e tyre sipas periudhes se perdorimit (verore/dimerore) si dhe perqindjen kundrejt siperfaqes totale te kullotave. Ky informacion mund te sigurohet direkt nga programi ne MS Access ose nga ALFIS kur te jete funksional.

E.7.4.2. Perdoruesit e kullotave dhe koha

Pershkruani cilet jane perdoruesit e kullotave dhe jepni te dhena per kohen e perdorimit te kullotave.

E.7.4.3. Llojet e bagetive

Bëni një përshkrim të blegtorisë në kullotat e ekonomisë pyjore, llojet e kafshëve që kullojnë dhe nëse është e mundur jepni disa të dhëna sasiore (ose nga intervistat me banorët lokalë (grate dhe burrat) dhe nga takimet në procesin e pjesëmarrjes së aktoreve). Jepni të dhëna për shpërndarjen e bagetive në kullota.

E.7.4.4. Përdorimi aktual dhe kapaciteti mbajtes i kullotave

Jepni disa të dhëna mbi numrin aktual të bagetive, llojet e kafshëve që kullojnë, kapacitetin mbajtes të llogaritur dhe shpjegoni sesi ky kapacitet mund të rritet në aspektin afat-gjate.

E.7.4.5. Infrastruktura aktuale

Jepni një përshkrim të shkurtër të infrastrukturave ekzistuese në kullotat e Ekonomisë Pyjore (gardhet, lerat, ndërtesat, rruget etj) dhe vendosini ato në Hartën e Infrastrukturave të Planit të Mbarështrimit dhe bëni një vlerësim të gjendjes dhe nevojave për mirëmbajtje.

E.7.4.6. Problemet mbi kullotjen dhe furnizimin e blegtorisë me baze ushqimore

Të bëhet krahasimi duke marrë në konsideratë nivelin e kullotjes, nëse numri i krereve që kullojnë është më i lartë, i barabartë, ose më i vogël se kapaciteti mbajtes. Kjo nënkupton mbikullotje, kullotjen e rregullt dhe kullotje nën kapacitetin mbajtes. Të bëhet vlerësimi i nevojave të bagetive për baze ushqimore dhe nëse është e mundur jepni disa të dhëna rreth kostove dhe sasive. Përmendni disa nga problemet që ekzistojnë në sipërfaqen e kullotave dhe jepni opinionin tuaj nëse këto probleme mund të zgjidhen dhe si.

E.8. OBJEKTIVAT E MBARËSHTRIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

E.8.1. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME PËR PLANIFIKIMIN AFAT-GJATË

Plani i Mbarështrimit të Pyjeve dhe Kullotave duhet të identifikojë objektivat afat-gjate të mbarështrimit, jo vetëm në periudhën e vlefshmerisë së tij, por edhe në dekadat në vijim. Këto objektiva duhet të jenë të përgjithshme, por njëkohësisht edhe të mundshme për tu realizuar si: (i) shtimi i sipërfaqes pyjore dhe volumit në kembe; (ii) përmirësimi i prodhimit të kullotave; (iii) reduktimi i sipërfaqeve të degraduara; (iv) përmirësimi i kushteve ekonomike të grave dhe burrave lokalë nëpërmjet mbarështrimit të pyjeve dhe kullotave dhe të mirave që sigurohen prej tyre si: produktet drusore dhe jodrusore, produktet blegtoriale etj; (v) mirëmbajtjen dhe rritjen e vitalitetit dhe gjendjes shëndetsore të ekosistemeve pyjore dhe kullores; (vi) zhvillimin e aktiviteteve rekreative dhe turistike; (vii) përmirësimin e funksioneve prodhuese etj. Menaxhimi shumë-funksional duhet të nxitet në mënyrë që të arrihen rezultate konkrete si dhe të rritet gama e të mirave dhe produkteve që sigurohen për shoqërinë (shiko Aneksin 13).

E.8.2. OBJEKTIVAT KOMBETARE PËR ZHVILLIMIN E PYJEVE DHE KULLOTAVE

Në planin e mbarështrimit, referojuni programit të qeverisë për zhvillimin e sektorit pyjor dhe kullor, strategjisë për zhvillimin afatshkurtër dhe afatgjatë të pyjeve dhe kullotave si dhe programeve qeveritare për pëllëzimin dhe reduktimin e gazeve serë.

E.8.3. PAJTUESHMERIA E PMPK ME PLANIFIKIMIN RAJONAL DHE ATË NË NIVEL BASHKIE

Pyjet dhe kullotat janë pjesë integrale e territorit të secilës bashkie dhe për këtë arsye duhet të përfshihen në "*Strategjinë e Zhvillimit të Territorit*" dhe në "*Planin e Zhvillimit të Territorit të Bashkisë*" i cili njihet me emrin "Plani i përgjithshëm i zhvillimit të Bashkisë" (plane të zhvillimit të bashkive etj). Pyjet dhe kullotat janë elemente që përshkruhen në kapitullin e dytë të ketyre planeve, në seksionin 2 me titull: "Karakteristikat mjedisore të bashkisë". Plani ka të bëjë me disa aspekte që janë ngushtësisht të lidhura me pyjet dhe kullotat.

Disa nga problemet me te rëndësishme qe trajtohen ne kete plan jane: *pronesia e pyjeve dhe kullotave; perdorimi i territorit; ndarja e territorit ne sisteme urbane, natyrore, bujqesore dhe ujore.*

Në një kapitull të veçantë me titull "*Drejtimet per zhvillimin e territorit te Bashkise bazuar ne treguesit e sistemeve*" duhet te jepet strategjia dhe vizioni per zhvillimin e sistemit natyror duke perfshire ketu pyjet dhe kullotat. Prandaj informacioni qe sigurohet nga planet e mbarështrimit të hartuar për secilën njësi menaxhimi brenda territorit të bashkisë duhet të integrohen në këtë plan zhvillimi duke nënkuptuar se këto plane duhet të jenë në pajtuesmeri edhe me Planin e Zhvillimit te Territorit te Bashkise.

E.8.4. OBJEKTIVAT KRYESORE TE PMPK

Përshkruani shkurtimisht objektivat kryesore të PMPK brenda kriterit objektiv afat-gjatë, por duke iu referuar periudhës së vlefshmërisë së planit, bazuar në njohjen e gjëndjes lokale sipas të dhënave të grumbulluara gjatë hartimit të planit e lidhur me një tablo të përgjithshme të kontekstit dhe objektivave të territorit të Bashkisë.

E.8.5. OBJEKTIVAT SPECIFIKE TË EKONOMISË PYJORE/NJM

Bazuar në objektivat kryesore përcaktoni objektivat specifike të planit të mbareshtimit bazuar në gjëndjen aktuale dhe përshkruani procesin e përcaktimit të këtyre objektivave.

E.8.5.1. Objektivat specifike mbi përdorimin e tokës, funksionin dhe formën e qeverisjes/mbarështrimit

Shpjegoni ndryshimet në përdorimin e tokës dhe në formën e mbarështrimit të ekonomisë pyjore. Cilat janë funksionet kryesore specifike të propozuara dhe jepni disa arsye përse janë bërë këto propozime.

E.8.5.2. Objektivat specifike mbi tipet e pyjeve

Shpjegoni drejtimin për zhvillimin e grumbujve pyjore në lidhje me: përbërjen e specieve; volumin në këmbë; qëndrueshmërinë; strukturën; cilësinë; moshën dhe rigjenerimin. Përshkruani strukturën e grumbujve pyjore sipas klasave të moshes, rritjes dhe klasave të prodhimit.

E.8.5.3. Objektivat specifik silvikulturale

Përshkruani objektivat specifik silvikulturale në lidhje me ripyllezimin, rrallimet, prerjet përfundimtare dhe ripërtëritëse.

E.8.5.4. Objektivat specifik për kullotat

Përshkruani objektivat specifik për përmirsimin e kullotave në aspektin afat-gjatë, tipet e kafshëve, numrin e krerëve, cilësinë e kullotave etj.

E.8.5.5. Objektivat specifik mbi biodiversitetin

Përshkruani objektivat specifik të biodiversitetit bazuar në vrojtimet ekologjike dhe ato të terrenit.

E.8.5.6. Objektivat specifik mbi gjëndjen shëndetsore

Përshkruani objektivat specifik me qëllim ruajtjen dhe përmirsimin e gjëndjes shëndetsore të grumbujve në nivel ekonomie pyjore dhe rruget për reduktimin e prerjeve ilegale.

E.8.5.7. Objektivat specifik mbi faunen

Përshkruani objektivat afat-gjatë të mbarështrimit të faunes dhe gjuetisë, përmirsimin e habitateve, etj.

E.8.5.8. Objektivat specifik për pyjet me funksion prodhues

Përcaktoni objektivat specifik të grumbujve pyjore me funksion prodhimi në aspektin afat-gjatë.

E.8.5.9. Objektivat specifik për pyjet me funksion mbrojtës

Përcakto disa nga objektivat specifik për grumbujt pyjore me funksion mbrojtës në aspektin afat-gjatë.

E.8.5.10. Objektivat specifik për pyjet me funksion rekreacioni

Përcakto disa nga objektivat specifik për grumbujt pyjor me funksion rekreacioni në aspektin afat-gjatë.

E.8.5.11. Objektivat specifik për pyjet me funksion konservues

Përcakto disa nga objektivat specifik për grumbujt pyjore me funksion konservues në aspektin afat-gjatë.

E.9. MASAT/AKTIVITETET E PLANIFIKUARA NË KUADËR TË MBARËSHTRIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

E.9.1. PRERJA VJETORE E LEJUAR/MUNDËSIA VJETORE E SHFRYTËZIMIT

Rregullimi i prodhimit, pavarisht sistemit silvikulturor të përdorur, siguron një bazë të mirë për një shfrytëzueshmëri afatgjatë në balancë me rritjen e grumbujve pyjore. Kjo kërkon një kontroll për tu siguruar që prerja vjetore/mundësia vjetore e shfrytëzimit nuk është as më e madhe dhe as më e vogël se rritja vjetore. Metodatat e përdorura për llogaritjen e mundësisë vjetore të shfrytëzimit jepen në aneksin e udhëzuesit.

E.9.2. PRERJA VJETORE SILVIKULTURORE

Prerja vjetore silvikulturore përfshin sasinë e volumit të materialit drusor, që nxirret nga masat ose trajtimet silvikulturore në 1 vit si: rrallimet (tipi 1-re dhe tipi 2-te), prerjet përfundimtare. Ky volum shprehet në metër kub për 1 ha ose në metër kub. Përkrahja të gjitha tipet e ndërhyrjeve dhe renditi ato: (i) sipas urgjencës; (ii) klasave të moshës dhe (iii) volumit për secilën nëngaster.

E.9.3. PLANIFIKIMI VJETOR I MASAVE

E.9.3.1. Masat në Pyje

Përkrahja në një tabelë, ndërhyrjet e planifikuara vit pas viti për çdo 5 vjet në pyje. Jepni numrat dhe kodet e parcelave dhe nenparcelave ku do kryhen ndërhyrjet, sipërfaqet ku do kryhen, intensitetin e punës etj.

Planifikimi vjetor i ndërhyrjeve – Pyjet

Viti	Kodi nenparcelës	Sip (ha)	Metoda e trajtimit silvikulturor	Sipërfaqja që do ndërhyet (ha)	Volumi materialit që sigurohet (m ³)	Shenim
2018	7b	20	Prerje rrafsh	18	120	
2019	9a	10	Rrallime	4	15	heqja e 15% të numrit të drureve
2020	17b	45	Pastrime	10	240	heqja deri 25% të numrit të drureve ekzistues
2021	43a	35	Pyllezime	15		
2026		m ³	Sisteme malore	65		
2027	11a	25	Prerje rrafsh	7	105	

E.9.3.2. Masat në kullota

Përshkruani në një tabelë, ndërhyrjet e planifikuara vit pas viti për çdo 5 vjet në kullota. Jepni numrat dhe kodet e parcelave dhe nenparcelave të prekura nga ndërhyrjet, sipërfaqet ku do kryhen, intensitetin e ndërhyrjeve etj.

Plani vjetor i ndërhyrjeve – Kullota

Viti	Kodi i nenparcelës	Sip (ha)	Ndërhyrjet	Njësia (ha)	Volumi materialit që sigurohet (m ³)	Shënim
2018	19	17	Gradhim	ml	120	
2019	16a	15	Heqje guresh dhe permirsim kullote	ha	5	
2020	13c	25	Ndertim korite			
2021	45a	20	Ndertim lere	m ³	105	
2026	57b	15	Heqje guresh dhe permirsim kullote	ha	7	
2027	35a	5	Heqje guresh dhe permirsim kullote	ha	2.5	

E.9.3.3. Masat në infrastrukture dhe në zonat e degraduara, rekreacionale dhe didaktike

Përshkruani në një tabelë, ndërhyrjet e planifikuara vit pas viti për çdo 5 vjet në zonat e degraduara, rekreacionale dhe didaktike. Jepni numrat dhe kodet e parcelave dhe nenparcelave të prekura nga ndërhyrjet, sipërfaqet ku do kryhen, sasinë dhe intensitetin e punës.

Plani vjetor i ndërhyrjeve – Infrastrukture

Viti	Kodi i nenparcelës	Sip (ha)	Lloji i ndërhyrjes	Sip ndërhyrjes (ha) Interv.	Gjatësia (m)	Shënim
2018	8a	16	Restaurimi sipërfaqeve djegura	7		Ndertim pritash me material drusor dhe hedhje fare
	16a	14	Permirsimi i shtigjeve të kembesoreve, sipërfaqeve për piknik		2300	Restaurimi i shtigjeve, paneleve turistike, 2 sipërfaqe për pikin përgjatë shtigjeve.

Bëni një vlerësim të efekteve të pritshme në zhvillimin e: (i) ekonomive lokale; (ii) punësimin e banorëve në aktivitetet në pyje/kullota/turizem/rekreacion dhe (iii) përmirsimin e aftësive profesionale nëpërmjet trajnimit.

E.9.4. MASAT AFAT-GJATA

E.9.4.1. Masat silvikulturale në trungishte

Bëni një listë të gjithë masave silvikulturore të parashikuara për tu zbatuar gjatë periudhës së vlefshmërisë së planit të mbarestrimit duke u fokusuar në këto masa:

a - masa për favorizimin/stimulimin e rigjenerimit natyror në sipërfaqet me bimesi pyjore me kurordendesi nën 30%:

- gervishtje e sipërfaqe se tokes
- dendësimin e sipërfaqes pyjore nëpërmjet pyllëzimit

Për secilen nga keto punime referenca për normat e punes do te jetë Libri i Normave fq 222-228 për pyllëzimet dhe fq 238 për gervishtjen e sipërfaqes pyjore. Ky informacion duhet të jepet në përputhje me tabelën e mëposhtme ku informacioni në 2 kolumnat e fundit duhet të plotësohet nga stafi i shërbimit pyjor i Bashkise në përputhje me masat e parashikuara në PMPK.

Nenparcela pyjore Kodi	Sip per rigjenerim (ha)	Metoda per rigjenerim	Kostoja per 1 ha(Leke)	Kostoja totale (Leke)
4c	20	Gervishtja e shtreses se sipërme te tokes dhe shperndarja e farave	35 000	700 000
5a	30	Ripyllezimi me Pishë mesdhetare	970 000	2 9100 000

Në fund të planifikimit është e rëndësishme të bëhet një vlerësim i sipërfaqes mesatare të mbuluar nga rigjenerimi natyror dhe renditja e ndërhyrjeve sipas urgjencës.

b - trajtime silvikulturore: Këto masa do të aplikohen në parcelat pyjore bazuar në vrojtimin e kryer në terren. Planifikimi i trajtimeve silvikulturore që do të kryhet në parcelat pyjore duhet të paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Nenparcela pyjore Kodi	Sipërfaqja (ha)	Metoda e trajtimit silvikulturore	Volumi perftuar (m ³)	Kostoja totale (Leke)	
				Per 1 ha	Sip totale
7b	20	Ricungimi	120	45 000	900 000
9a	10	Rrallime (hiqet 15% e numrit ekzistues te drureve)	15	39 000	390 000

c - masa të tjera:

Në këtë pike duhet të trajtohen masat për luftimin e sëmundjeve, dëmtuesve dhe masat e tjera që duhen zbatuar sipas specifikave të ekonomisë pyjore. Disa nga masat e propozuara varen nga forma e qeverisjes se pyjeve si: krasitja,luftimi kimik ose biologjik etj..

E.9.4.2. Masat silvikulturore në cungishte

Përshkruani masat silvikulturore në cungishte që do të zbatohen në grumbujt pyjore cungishte, sipërfaqja që do përshkruhet me prerje,intensiteti i ndërhyrjes dhe jepni disa të dhëna për kostot e punimeve. Këto masa janë të ndryshme për cungishtet e thjeshta dhe të përbëra:

a - masat në cungishte të thjeshta

- I. trajtimi me prerje nga poshte (cungishtja e thjeshte është trajtimi më i rëndësishëm i regjimit të cungishtes dhe konsiston në prerjen rrah/rrafsh të grumbullit të ri pyjor i cili është në gjëndje të ripërtërihet në mënyrë vegjetative nëpërmjet lastarve ose pinjollëve (që dalin nga cungjet apo rrënjët).
- II. trajtimi i cungishtes me amësor (ky trajtim ndryshon nga mënyra e parë sepse pas çdo shfrytëzmi në parcelë lihet një numer prej 50-100 drure për 1 ha).
- III. trajtimi i cungishtes kopshtore (në këtë rast prerja rrah e cungishtes zëvendësohet me prerjen me të zgjedhur të tipit kopshtor, ku nga secili cung hiqen disa prej lastareve dhe në fund fitohet një masiv me lastarë me mosha të ndryshme).

b - masat në cungishtet e përbëra

Cungishtja e përbër ose cungishtja nën cungishte qëndron midis 2 formave të regjimeve (cungishtes dhe cungishtes) dhe përfaqson një sistem silvikultural ku druret e zgjedhur si standart, priten për të formuar një grumbull shumëmoshar dhe ku heqja e individëve bëhet në mënyrë selektive gjatë rrotacionit të cungishtes. Këta grumbuj jane forma më e vjetër e pyjeve kopshtore dhe përbëhen nga 2 elementë të dallueshëm: 1-kati i poshtem njëmoshar që formohet nga bisqet dhe trajtohet si cungishte; 2-kati i sipërm shumëmoshar i përbërë nga drurë më të lartë, që e kanë origjinën si nga lastaret ashtu edhe nga fara dhe janë të shpërndarë në mënyrë sa më uniforme dhe që trajtohen si cungishte.

c- konvertimi i cungishtes në trungishte

Aktualisht mund te perdoren 2 menyra konversioni: direkte dhe indirekte.

Metoda e konversionit direkt perfshin:

- I. konvertimin me anën e mplakjes (lënien e grumbullit pa u prerë deri kur mbërrin moshën e pjekurisë në mënyrë që ripërtëritja të bëhet me farë)
- II. konversioni miks/i perziere (kombinohet konversioni nëpërmjet mplakjes me atë në rrugë artificiale)
- III. konversioni me anen e rimëkëmbjes në rrugë artificiale i të gjitha vendprerjeve që janë caktuar për tu hequr çdo vit.

Metoda e konvertimit indirekt bazohet ne heqjen e specieve aktuale dhe futjen e specieve të reja në masiv. Kërkon që të vlerësohet nëse çdo specie e re përshtatet me kushtet e masivit/habitatit. Kjo metodë aplikohet duke kaluar në një trajtim të ndërmjetëm siç është cungishtja e përbërë..

E.9.4.3. Masat silvikulturore në shkurre

Përshkruaj sipërfaqen me shkurre që do të preket nga trajtimet silvikulturore të mëposhtme:

- I. pastrime;
- II. rrallime
- III. prerje rrafsh kur moshja është mbi 15 vjeç.

Jepni disa të dhëna për volumin e përftuar, intensitetin dhe frekuencën e ndërhyrjeve.

E.9.4.4. Pyllëzimi, ripyllëzimi

Pyllëzimi dhe ripyllëzimi janë masa të cilat do përcaktohen gjatë vrojtimit në terren për secilën nënparcelë pyjore. Planifikimi i këtyre masave do të jetë i përvitshëm dhe gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së planit të mbarështrimit. Informacioni mbi planifikimin e pyllëzimeve ose ripyllëzimeve duhet të përfshijë:

Nënparcela pyjore (kodi)	Sip (ha)	Sipërfaqja e planifikuar për pyllëzim (ha)	Metoda e mbjellies	Skema e mbjellies	Kostoja e pyllëzimit (Leke)	
					1 ha	Total
14/a	40	15	Pishe e bute (Fidane ne qeska ose kontenjere)	2 x 2 m	700000	10500000

Megjithëse gjate planifikimit duhet të bëhet edhe parashikimi i densitetit të mbjellies dhe specieve me qëllim llogaritjen e kostove, sipas pretendimeve të stafit pyjor në bashki këto elemente duhet të shmangen pasi gjëndja në sipërfaqen pyjore mund të ndryshojë pas disa vitesh. Sipas sygjërimit të bërë prej tyre duhet që në planin e mbarështrimit të përcaktohet vetëm lloji i ndërhyrjes (psh: pyllëzim) dhe informacioni tjetër që lidhet me këtë ndërhyrje të përcaktohet nga personat përgjegjës(stafi i pyjeve të bashkisë) që do të hartojnë projektin e pyllëzimit.

E.9.4.5. Masat në kullota

Përshkruani masat e planifikuara në kullota ku objekti kryesor i këtyre ndërhyrjeve është përmirsimi i cilësisë së barit (heqja e gurëve, plehërimi) dhe realizimi i infrastrukturës përkatëse. Në këtë sektor prioritet duhet të jepini mirëmbajtjes së infrastrukturës ekzistuese dhe ri-përdorimit të burimeve lokale. Punimet më kryesore do të jenë ato të përcaktuara edhe në skedën e nënparcelave kullosore:

a- punimet e infrastrukturës

- gardhimet (për mbrojtjen e sipërfaqeve sensitive, të degraduara ose të djegura)
- rrugët e aksesit (përmirsimi i lidhjes midis fshatrave dhe mundësia e përdorimit për realizimin e ndërhyrjeve)
- lerat (përmirsimi/mirëmbajtja e lerave ekzistuese dhe propozimi për ndërtimin e lerave të reja)
- strehat për kafshët (kryesisht në kullotat verore për mbrojtjen e bagëtive nga kushtet ekstreme të motit)
- kasollet/stanet e barinjve sidomos në zonat malore dhe zonat e largëta

- punime të tjera (ndërrhyrjet me impakte të vogla për kontrollin e erozionit, urat e vogla dhe pritat)

b-punimet për përmirsimin e vegjetacionit

- prerja e shkurreve dhe heqja e bimeve të padëshirueshme në mënyrë manuale ose mekanike
- heqja e gurëve
- futja e specieve të reja (mbjellia e shkurreve që përdoren për ushqimin e bagëtive)
- plehërimi

E.9.4.6. Gjëndja dhe masat në infrastrukturën e ekonomisë pyjore

Duke iu referuar masave të planifikuara në parcelat dhe nënparcelat pyjore dhe të paraqitura edhe në hartën e ndërhyrjeve të Ekonomisë pyjore, bëni një përshkrim të karakteristikave kryesore të punimeve që do kryhen duke i klasifikuar ato në: (i) punime për mirëmbajtjen e infrastrukturës ekzistuese dhe; (ii) punime për ndërtimin e infrastrukturave të reja. Sektorët më kryesor për realizimin e këtyre ndërhyrjeve janë:

- rrugët pyjore
- ndërtesat (barakat, strehat, etj.)
- gardhet
- lerat dhe rezervuarët që mund të përdoren në disa raste për fikjen e zjarreve
- pritat e vogla, gabionat, muret mbajtës etj

Rëndësi ka mirëmbajtja e rrugëve pyjore (për shkak të rreziqeve që lidhen me ekzistencën e rrugëve, por edhe mundësitë e përdorimit për shfrytëzimin e parcelave pyjore, mbritshmërinë e tyre etj). Në këtë rast duhet të vlerësohet/kontrollohet:

- prania e ujrave dhe gjëndja e punimeve për kontrollin e ujrave sipërfaqësore
- gjëndja e skarpateve, shpateve dhe rreziqet e erozionit dhe rrëshqitjeve

Gama e punimeve për mirëmbajtjen duhet të fokusohet në problemet e stabilizimit të shpateve dhe skarpateve të rrugëve, studimin e gjëndjes së rrjetit hidrologjik, përcaktimin e prioritetëve për ndërhyrje në shpate dhe përgjatë rrjedhieve ujore dhe përrrenjve. Zakonisht realizimi i rrugëve të reja pyjore duhet të planifikohet në lidhje me problemet e mbritshmërisë dhe nevojave për ndërhyrje silvikulturore ose tipe të tjera ndërhyrjesh që janë prioritare si: restaurimi i sipërfaqeve të degraduara, problemet që lidhen me zjarret në pyje, përmirsimin e kullotave etj, duke kryer planifikimin e ndërhyrjeve për kontrollin e ujrave dhe stabilizimin e shpateve. Nëse është e mundur, të bëhet parashikimi i sistemeve me impakte të vogla në mjedis (teknikat bio-inxhinjerie) duke siguruar ripërdorimin e burimeve lokale si: guret apo materialin drusor dhe akoma më mirë është kur këto punime janë të mirë koordinuara me ndërhyrje si rrallimet pyjore dhe ripërdorimin e pjesëve të materialit drusor me cilesinë me të dobët, në realizimin e punimeve për rehabilitimin e sipërfaqeve të djegura nga zjarri. Është mirë që të hartohet një listë me speciet autoktone më të përshtatshme për këto punime.

E.9.4.7. Masat specifike për aktivitetet rekreacionale dhe didaktike

Bazuar në gjëndjen aktuale të ekonomisë pyjore dhe kontekstin e bashkisë, përshkruani ndërhyrjet e planifikuara për të ruajtur dhe përmirësuar sipërfaqet/zonat rekreacionale dhe didaktike. Këto ndërhyrje janë:

- restaurimi i shtigjeve dhe rrugicave, paneleve për eskursionet, shenjat dhe sinjalet orientuese
- ruajtja dhe mirëmbajtja e strukturave rekreacionale ekzistuese (zonave për piknik, strehat, stolat etj)
- krijimi i strukturave të reja rekreacionale (zonave për piknik, strehat, stolat)
- krijimi i zonave didaktike
- gardhet (përreth parkingjeve të makinave, zonave me vlera natyralistike e historike të larta)

Jepni një tablo të shkurtër të nevojave dhe mundësive për organizimin e trajnimeve të udhërrëfyesve turistike dhe shoqatave të udhërrëfyesve, duke përfshirë edhe shkollat në programet didaktike.

E.10. VLERËSIMI EKONOMIK

E.10.1. VLERESIMI I EFEKTEVE TË MASAVE TË PLANIFIKUARA NË PYJE DHE KULLOTA

Bëni një pershkrim të shkurtër dhe një vlerësim të efekteve të masave të planifikuara në pyje dhe kullota dhe ndikimin në: (i) cilësinë/sasinë e grumbujve pyjorë (ii) cilësinë/sasinë e bimësise barishtore (iii) cilësinë/sasinë e produkteve drusore dhe jodrusore (iv) cilësinë/sasinë e produkteve blegtorale.

Po kështu bëni një vlerësim të efekteve të masave të planifikuara mbi: (i) konservimin/përmirsimin e tokës; (ii) restaurimin e zonave të degraduara; (iii) mirëmbajtjen e rrjetit rrugor pyjor/ndërtesat /infrastrukturën e pyjeve dhe kullotave; (iv) aktivitetet rekreacionale; (v) konservimin /përmirsimin e vlerave koservuese dhe zonave me këto vlera.

E.10.2 Planifikimi i të ardhurave/përfitimeve

Bëni një vlerësim sasior të të ardhurave të pritshme nga masat e planifikuara duke iu referuar produkteve drusore, jodrusore dhe blegtorale që do të sigurohen. Bëni një vlerësim cilësor të ndikimeve mbi reduktimin/parandalimin e rreziqeve dhe përmirsimin e cilësisë së territorit duke iu referuar rehabilitimit të zonave të degraduara, stabilizimit të tokës etj.

E.10.3 Planifikimi i kostove/shpenzimeve

Bëni një vlerësim të shpenzimeve/kostove për administrimin dhe zbatimin e punimeve/ndërrhyrjeve të propozuara.

E.10.4 Analiza kosto-përfitim

Bazuar në përfitimet e pritshme dhe shpenzimet për zbatimin e tërë masave duhet të bëni një analizë të diferencës midis këtyre dy komponenteve. Në rastin e një bilanci pozitiv apo negativ midis përfitimeve dhe shpenzimeve jepni sygjerimet tuaja për përmirsimin e mëtejshëm të gjëndjes së burimeve pyjorë dhe kullosore në territorin e ekonomisë pyjorë.

F. LIDHJA MIDIS PLANIT TË MBARËSHTRIMIT TË PYJEVE E KULLOTAVE DHE SISP

Më poshtë jepet lidhja midis PMPK dhe SISP tashmë të përshkruar në Udhëzues sipas ecurisë kronologjike të rrjedhës së punës në hartimin e planit.

F.1. PROÇESI I VALIDIMIT TË PMPK NË SISP

Kur plani i mbarështrimit është gati, konsulenti duhet të paraqesë PMPK për miratim dhe pranim. Miratimi i planit të ri të mbarështrimit dhe futja në SISP konsiston në keto procese :

- korigjimi i të dhënave gjeo-hapsinore
- plotësimi dhe korigjimi i informacionit të përgjithshëm të attributeve

Kryesisht, funksionalitetet edituese duhet të garantojnë korrektësinë e të dhënave të futura në mënyrë që të shmangen gabimet sa më shumë të jetë e mundur. Gjatë përgatitjes së planit të mbarështrimit të pyjeve dhe kullotave mund të ketë mangësi në lidhjen logjike midis të dhënave për shkak të lënies jashtë të informacionit. Për shembull, në hartimin e planit të ri të mbarështrimit, hapi i parë është plotësimi i bazës së të dhënave mbi gjëndjen e pyjeve dhe më pas të përcaktohen objektivat dhe ndërhyrjet në bazën e të dhënave të planit të mbarështrimit. Hartuesi i planit të mbarështrimit duhet të përcaktoj objektivat dhe ndërhyrjet për secilën nënparcelë pyjore dhe kjo duhet bërë një e nga një. Sistemi informacionit paraqet listen e nënparcelave pa objektivat e përcaktuara. Në të njëjtën kohë, sistemi shmang miratimin e planit nëse informacioni nuk është i plotë. Miratimi i planit të ri duhet të kalojë në këto etapa:

- 1) Të kontrollohet plotësimi i të gjithë informacionit të futur në SISP lidhur me ekonominë pyjore për të cilin është hartuar plani i mbarështrimit.
 - a. zgjedhim ekonominë pyjore për të cilën është hartuar plani i mbarështrimit
 - b. miratohen shtresat bazë të kadastrës pyjore që i përkasin ekonomisë pyjore
 - c. miratohet baza e të dhënave për gjëndjen e pyjeve për ekonominë pyjore përkatëse
 - d. miratohet baza e të dhënave të PMPK që lidhet me ekonominë pyjore
 - e. raportohen rezultatet para miratimit duke shfaqur një listë me të gjitha gabimet e mundshme (raporti i miratimit/validimit)
- 2) Korigjohen gabimet e gjetura
 - a. Për çdo gabim në raport, duke përdorur GIS bëhet ndërhyrja në bazën e të dhënave për të korigjuar gabimet.
- 3) Duke ndjekur të njëjtën mënyrë si në pikën 1, bëhet e mundur kontrolli i plotësimit të bazës së të dhënave të planit të mbarështrimit, për të parë nëse gabimet janë korigjuar.
- 4) Në fund plani i mbarështrimit paraqitet për miratim final në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

Pas miratimit të planit të mbarështrimit zbatimi i tij është përgjegjësia e Zyres së Pyjeve të Bashkisë. Kjo zyre ka për detyrë të paraqesë listen e planeve të mbarështrimit për miratim, të kryejë vlerësimin e planit të hartuar nga ekspertët private dhe të shikojë nëse plani është i sakte dhe dokumentacioni shoqëruar i planit është i plotë brenda 15 ditësh. Vetëm pasi plotësohen këto kushte Bashkia bën publikimin e tij në sistem. Në të kundërt zyra e pyjeve të Bashkisë njofton ekspertët duke dhënë listën me gabimet e gjetura dhe në sistem zgjedh opsionin "editim/korigjim" për planin e mbarështrimit.

F.2. MIRATIMI I PLANIT TË MBARËSHTRIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

Kërkesat bazë për miratimin e planit të mbarështrimit janë:

- Kur të përfundojë hartimi i planit të mbarështrimit, një përmbledhje ekzekutive duhet të përgatitet duke nxjerrë në pah karakteristikat e tij si: objektivat e planit, treguesit e fondit pyjor dhe kullësor, mundësinë vjetore të shfrytëzimit, ndërhyrjet silvikulturore dhe efektiviteti ekonomik i zbatimit të planit të mbarështrimit si dhe pjesëmarrja e komunitetit lokal në hartimin e tij.
- Veçoritë kryesore të planit të mbarështrimit duhet të shpjegohen dhe diskutohen me stafin e shërbimit pyjor të bashkisë dhe me aktoret e tjera nepermjet një prezantimi në powerpoint.

- Plani dërgohet në Ministrinë e Turizimit dhe Mjedisit për miratim i shoqëruar me letrën mbështetëse të hartuar nga Drejtoria e Pyjeve e Bashkise.
- Një komision⁸ ngrihet nga ministria (1 përfaqësues nga MTM,1 përfaqësues nga AKM dhe 1 përfaqësues nga FSHP/UBT), për të kryer kontrollin cilësor të planit të mbarështrimit dhe për të siguruar që cilësia e planit është e mirë dhe se plani është hartuar në përputhje me rregulloret, udhëzuesin si dhe respekton të drejtat e paleve te treta.

Miratimi final i planit të mbarështrimit për pyjet publike dhe private bëhet nga Ministri i MTM⁹ pas vlerësimit pozitiv të komisionit.

⁸ Rrregullorja Nr 4, date 19/09/2008 "Per funksionimin e komisionit teknik per shqyrtimin e planeve te mbarështrimit te Pyjeve"

⁹ Udhezimi Nr 3, date 22/06/2007 "Mbi procedurat per miratimin e Planeve te Mbarështrimit te Pyjeve dhe Kullotave Komunale" ..

G. MONITORIMI I ZBATIMIT TE PMPK

SISP bën të mundur monitorimin vjetor të ndërhyrjeve që kryhen në përputhje me planin e mbarështrimit si dhe rastet e ngjarjeve ekstreme si psh: zjarret në pyje, rrëshqitjet, përmbytjet, që ndikojnë në gjëndjen e territorit dhe menaxhimin e planit. Monitorimi i zbatimit të PMPK do të bëhet sipas procedurës së pritshme të futjes së informacionit në SISP për çdo ndërhyrje duke futur këto të dhëna: (i) tipi i masave; (ii) sipërfaqja ku është kryer ndërhyrja (si psh: gjatesia e rrjetit të ri rrugor); (iii) kostoja e ndërhyrjeve; (iv) kontraktori; (v) punësimi i grave dhe burrave (mundësia për të ndare dhe për të menaxhuar ndërhyrjet e parashikuara në planin e mbarështrimit duke respektuar pjesmarrjen gjinore sipas ligjit 9970/2008) duke siguruar edhe një informacion me të perditesuar. Në SISP do të futen të gjitha ngjarjet që do të ndodhin në territorin e ekonomisë pyjore si: zjarret në pyje, problemet fitosanitare, rrëshqitjet etj.

G.1. RISHIKIMI PERIODIK I ZBATIMIT TË PLANIT TË MBARËSHTRIMIT

Megjithatë progresi në zbatimin e aktiviteteve specifike është një nga problemet kyç në rastin e një plani mbarështrimit, ky i fundit duhet të rishikohet në mënyrë të rregullt çdo vit si pjesë e procesit të ruajtjes dhe kontrollit mbi qeverisjen e pyjeve. Është e dobishme të kryhet periodikisht një rishikim tërësor i planit të mbarështrimit gjatë periudhës së vlefshmërisë së tij. Tendencat afat-shkurtër në progresin e zbatimit të planit të mbarështrimit mund të kryhet pas një periudhe 2, 3 ose me shumë vitesh në varësi të subjektit dhe këto tendencat duhet të pasqyrohen gjatë zbatimit të planit të mbarështrimit.

G.2. RISHIKIMI AFAT-MESËM I PLANIT TË MBARËSHTRIMIT

Duke përdorur të dhënat e gjeneruara nëpërmjet sistemit të monitorimit, por edhe duke u mbështetur në vërtetimet e shpeshta të stafit pyjor bashkiak, menaxheri i pyjeve dhe ekipi i mbarështrimit duhet të kryejnë një rishikim afat-mesëm të planit të mbarështrimit për të vlerësuar aktivitetet e planit të mbarështrimit. Një plan që ka një periudhë vlefshmërie prej 10 vjetësh duhet të rishikohet në vitin e 5-të të zbatimit. Nevojitet fleksibilitet për kohën kur duhet kryer rishikimi në varësi të kushteve lokale. Rishikimi afat-mesëm ka si qëllim kryerjen e një vlerësimi dhe gjykimi mbi progresin dhe ecurinë e zbatimit të planit të mbarështrimit. Ai duhet të ekzaminojë efektivitetin e performancës së planit të mbarështrimit në raport me ndërhyrjet e propozuara dhe planifikimin e punimeve ose ndërhyrjeve. Nëse ndryshimet në zbatimin e porositve specifike konsiderohen të rëndësishme dhe konsistente nga njëri vit në tjetrin është me rëndësi që ekipi që kryen rishikimin, të identifikojë edhe arsyet përse progresi nuk ka qënë siç duhet. Stafi i pyjeve i bashkisë duhet të bëjë një miratim të ri të planit të mbarështrimit në rast se ndryshimet dhe ndërhyrjet në plan janë të shumta dhe ndikojnë në ecurinë/ritmin e planit të mbarështrimit, buxhetin operacional dhe rrjedhën e të ardhurave të pritshme nga shfrytëzimi apo aktivitete të tjera. Veç kësaj në vlerësimin e progresit të planit të mbarështrimit rishikimi afat-mesëm duhet të evidentojë edhe lidhjen dhe praktikitetin e aktiviteteve specifike të propozuara dhe nëse është e nevojshme të propozojë edhe amendime.

G.3. RISHIKIMI FINAL I PLANIT TË MBARËSHTRIMIT

Në fund të periudhës së vlefshmërisë së planit të mbarështrimit, kryesisht në vitin e fundit, një rishikim tërësor i aktiviteteve të planit duhet të kryhet. Rishikimi final i planit të mbarështrimit duhet të kryhet në të njëjtën mënyrë si rishikimi afat-mesëm, por duke përfshirë të gjithë periudhën kohore të vlefshmërisë së planit të mbarështrimit. Duhet të analizohet efektiviteti dhe performanca e planit të mbarështrimit kundrejt objektivave të tij, plani i ndërhyrjeve në fillim dhe sa është zbatuar ai dhe cili ka qënë buxheti. Rishikimi final i planit do të krijojë një bazë shumë të mirë për planin tjetër të mbarështrimit që duhet të hartohet për ekonominë pyjore.

PROJEKTI I SHERBIMEVE MJEDISORE (ESP) No. P128412

**ZHVILLIMI I UDHËZUESIT PËR HARTIMIN E PLANEVE TË INTEGRUARA TË MBARËSHTRIMIT
TË PYJEVE DHE KULLOTAVE**

SEKSIONI H - STANDARTET

STANDARTI 1 – PËRGATITJA E HARTAVE

1. HYRJE

Në lidhje me rëndësin që hartat tematike kanë në procesin e planifikimit është e nevojshme që të përcaktohen:

- tematika e hartave në përshatje me kushtet e reja të territorit
- elementet grafike standart, ngjyrat dhe emërtesat
- dixhitalizimi i hartave dhe integrimi i tyre në sistemin GIS

SISP menaxhon direkt hartat dhe elementët e dhënë më poshtë (vijat, ngjyrat, emertimet etj) mund të jenë standart i sistemit të informacionit për përgatitjen e hartave. Përpara se sistemi të jetë operacional, përgatitja e hartave duhet të realizohet në sistemin GIS duke respektuar standartet e mëposhtme.

Hartat mund të ndërtohen nëpërmjet GIS duke përdorur sistemin e ri zyrtar KRGJSH 2010 kompatibel me sistemin koordinativ UTM. Hartat mund të ndërtohen në shkallët 1:25 000 ose 1:10 000 në rastin kur sipërfaqja është e vogël. Hartat dhe ortofotot që janë të disponueshme në faqen e ASIG (www.asig.gov.al) mund të përdoren direkt edhe nga SISP.

Hartat me të rëndësishme për planin e mbareshtrimit janë:

- Harta e Ekonomise pyjore
- Harta e funksioneve të pyjeve
- Harta e tipeve të pyjeve, shkurreve dhe kullotave
- Harta e rrjetit rrugor, infrastrukturës dhe zonave të degraduara
- Harta e ndërhyjeve që do kryhen

Prania e ortofotove mund të përmirsojë cilësinë e punës, sidomos në ndarjen parcelare, përcaktimin e kufijve dhe shtresëzimin e sipërfaqes pyjore në njësi homogjene. Në të gjitha rastet, hartat duhet të përgatiten duke përdorur standartet në lidhje me: vijat, ngjyrat dhe emertimet të cilat janë përcaktuar dhe do prezantohen më poshtë.

2. HARTA E EKONOMISE PYJORE

Është harta baze tematike e cila përcakton kufijtë e ekonomise pyjore dhe ndarjen e saj në parcela dhe nënparcela. Kufijtë e ekonomisë pyjore, ndarja në parcela dhe nënparcela do jenë të njëjtë me ato ekzistues. Në çdo rast parcela identifikohet me numër, ndërsa nënparcela me shkronjë.

Disa të dhëna që duhet të merren parasysh:

- Ngjyra (e zezë) dhe trashësia e vijave për parcelat dhe nënparcelat është e njëjtë me atë të Udhëzuesit të 2001 (0.5 dhe 0.25 mm).
- Numri i parcelës duhet të shkruhet vetëm 1 herë në qendër të parcelës dhe trashësia e numrit është 0.5 mm dhe lartësia e tij 8 mm.
- Shkronja e nënparcelës duhet të shkruhet vetëm 1 herë në qendër të nënparcelës ku trashësia e numrit është 0.5 mm dhe lartësia e tij 5 mm.

Shkalla e hartës mund të jetë 1:10 000 ose 1:25 000, por për parcelat në pronësi private mund të përdoret edhe shkalla 1:2 500 e cila kërkohet nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për regjistrimin e pronës.






Harta e ekonomise pyjore duhet të përmbajë këto informacione:

- rrjetin e sipërfaqeve prove të përhershme dhe të përkohshme
- pronësinë me teksture grafike të limituar për pronësinë private për të bërë dallimin nga pronësinë publike (pa ngjyrë ose teksture)






- zonat e mbrojtura në rast se janë prezente në brendësi të ekonomisë pyjore, por edhe në rast të kufijve të ekonomive fqinje (duhet informacion për të patur sinergji)
- rrugët kryesore, duke u kufizuar tek rruget me akses kryesor
- rrjedhiet ujore dhe trupat ujore (liqene, rezervuaret)

Tabela e mëposhtme përcakton ngjyrat (me referim specifik të RGB) dhe simbolet e përdorura, përmasat dhe trashësinë në mënyrë që të lehtësojnë leximin e hartës.

Elementët bazë

Pershkrimi	Trashësia & RGB	Ngjyra
Kufiri i ekonomisë pyjore	trashësia 0,7 RGB 0,176,80	
Kufiri dhe numri i parcelës	trashësia 0,5, lartësia e numrit 8 mm RGB 0,0,0	
Kufiri dhe shkronja e nënparcelës	trashësia 0,25, lartësia e numrit 5 mm RGB 0,0,0	
Zonat e mbrojtura	trashësia 0,5 RGB 47,192,239	
Prona private	trashësia 0,25 RGB 0,0,0	
Prona publike	pa ngjyre	






Elementët tematikë

KODI	Pershkrimi	Trashësia & RGB	Ngjyra
101	Sipërfaqet provë të përhershme	Lartësia e numrit 0,4 mm RGB 173,123,16	
102	Sipërfaqet provë të përkohshme	trashësia 0,25, lartësia e numrit 0,4 mm RGB 173,123,16	
103	Rrjedhiet ujore	trashësia 0,25 RGB 51,153,255	
104	Trupat ujqorë	RGB 51,153,255	
105	Rrugët kryesore	trashësia 0,25 RGB 255,0,0	
106	Të tjera (specifiko)	simboli, trashësia dhe ngjyra duhen zgjedhur	

3. HARTA E FUNKSIONEVE

Kjo hartë përcakton funksionet kryesore të pyjeve dhe kullotave të ekonomisë pyjore. Klasifikimi i përdorur është i njëjti me atë të IKP 2018 dhe do përdoret edhe në përshkrimin parcelar dhe nënparcelar. Është një hartë e re, me shumë sesa futja e një simboli ose shkronje e cila lidhet me funksionet e pyjeve dhe kullotave në nivel parcele dhe nënparcele dhe është lehtësisht e realizueshme nëpërmjet sistemeve dixhitale (elementët bazë janë të njëjtë).

Elementët bazë

Përshkrimi	Trashësia dhe RGB	Ngjyra
Kufiri i ekonomisë pyjore	trashësia 0,7 RGB 0,176,80	
Kufiri dhe numri i parcelës	trashësia 0,5, lartësia e numrit 8 mm RGB 0,0,0	
Kufiri dhe shkronja e nënparcelës	trashësia 0,25, lartësia e numrit 5 mm RGB 0,0,0	
Zonat e mbrojtura	trashësia 0,5 RGB 47,192,239	
Prona private	trashësia 0,25 RGB 0,0,0	
Prona publike	pa ngjyre	

Elementët tematike

KODI	Përshkrimi	Trashësia dhe RGB	Ngjyra
101	Funksion prodhues	RGB 204,192,217	PRO
102	Funksion mbrojtës	RGB 219,229,241	PRT
103	Funksion social	RGB 255,255,102	SOC
104	Funksion konservues	RGB 204,255,153	CON

Elementet bazike janë të njëjta me hartën 1. Për të plotësuar hartën e funksioneve me elementet tematike është e nevojshme të krijohet vetëm 1 shtresë e re në sistemin GIS.

4. HARTA E TIPEVE TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

Kjo hartë pershkruan tipet e pyjeve dhe kullotave ne lidhje me qellimet e PMPK. Harta e propozuar lidhet me speciet kryesore dhe ndahet ne 4 zona duke iu referuar: vegjetacionit mesdhetare, pyjeve mezofile dhe termofile dhe pyjeve të zones alpine. Kjo ndarje integrohet edhe me tipet e tjera të perdorimit të territorit si: kullota, livadhe, siperfaqe inproduktive, siperfaqe te zhveshura, siperfaqe shkembore, zona bregdetare, duna ranore dhe zonat e prekura nga zjarret.

Kodet e tipeve te pyjeve jane bazuar ne klasifikimin e Udhezuesit të vitit 2001 dhe eshte bere integrimi me kodet e reja te percaktuara me kritere te ngjashme.

Per zgjedhjen e ngjyrave baza fillestare është Harta e Pyjeve ne shkallen 1: 250,000 ne nivel kombetar duke shtuar disa elemente të sygjerruar nga stafet e sherbimit pyjor bashkiak. Në pergjithsi pyjet e dushqeve do shënohen me ngjyre kafe, pyjet fletore me ngjyre te gjelber,haloret me ngjyre te kuqe/vjollce, shkurret me ngjyre bojeqielli/blu.

Per te lehtesuar interpretimin e tipeve te pyjeve eshte mire qe te futet nje etikete me nje kod specifik per secilin tip sipas legjendës së meposhtme. Eshte e mundur qe te lexohen tipet edhe kur printimi behet bardhe e zi.

Harta eshte organizuar në bazë të specieve dominante. Kur kemi një pyll të perziere eshte e mundur te perdoret i njejti standart vetem duke bere modifikimin e ngjyres qe mbush zonen. Ne rast se kemi 1 specie dominante mbushja me ngjyre do jete e plote dhe ne kete rast do perbehet vetem nga 1 ngjyre dhe emërtesë/etikete (psh: pyje te dominuar nga Pisha e eger(*Pinus halepensis Mill*)-do te jete e kuqe me emertimin DPH). Ne rast se kemi 2 specie duhet të perdorni nje teksture me vija vertikale me 2 gjeresi te ndryshme (vijat me te gjera per llojin dominant dhe ato më të ngushta per llojet e tjera), duke perdorur te njëjtat ngjyra dhe emërtesa si në tabelën e mëposhtme. Për të lehtësuar leximin e bazes topografike eshte mire qe te perdorim komanden "transparencë" per te reduktuar intensitetin e ngjyrave (reduktohet rreth 50%).


Elementet baze

Përshkrimi	Trashësia dhe RGB	Ngjyra
Kufiri i ekonomisë pyjore	trashësia 0,7 RGB 0,176,80	
Kufiri i parcelës dhe numri	thickness 0,5; lartësia e numrit 8 mm RGB 0,0,0	
Kufiri dhe shkronja e nënparcelës	trashësia 0,25; lartësia e numrit 5 mm RGB 0,0,0	
Zonat e mbrojtura	trashësia 0,5 RGB 47,192,239	
Prona private	trashësia 0,25 RGB 0,0,0	
Prona publike	Bosh (pa ngjyrë)	

Elementët tematike

Kodi	Përshkrimi	RGB	Ngjyra & emërtesa
Zona Mesdhetare e specieve përherë të gjelbra			

DQI	Pyje te dominuar nga <i>Quercus ilex</i> L.	RGB 153,102,0	DQJ
DQC	Pyje te dominuar nga <i>Quercus coccifera</i> L.	RGB 216,148,80	DQC
DPH	Pyje te dominuar nga <i>P.halepensis</i> Mill.	RGB 247,59,59	DPH
DPP	Pyje te dominuar nga <i>P.pinea</i> L.	RGB 148,0,107	DPP
DMAU	Shkurre te dominuara nga <i>Arbutus unedo</i> L.	RGB 14,194,147	DMAU
DMCC	Shkurre te dominuara nga <i>Cotinus coggygia</i> Scop.	RGB 113,212,235	DMCC
DMED	Shkurre te dominuara nga <i>Euphorbia dendroides</i> L.	RGB 139,178,195	DMED
DMPS	Shkurre te dominuara nga <i>Paliurus spina-christi</i> Mill.	RGB 171,160,186	DMPS
Zona e Pyjeve dhe shkurreve fletore termofile			
DQM	Pyje te dominuar nga <i>Quercus macrolepis</i> Kotchy.	RGB 197,164,105	DQM
GQF	Pyje te dominuar nga <i>Quercus frainetto</i> Ten.	RGB 221,185,85	GQF
GQC	Pyje te dominuar nga <i>Quercus cerris</i> L.	RGB 204,102,0	GQC
DQT	Pyje te dominuar nga <i>Quercus trojana</i> Webb.	RGB 204,153,0	DQT
GCB	Pyje te dominuar nga <i>Carpinus betulus</i> L.	RGB 153,255,51	GCB
GCO	Pyje te dominuar nga <i>Carpinus orientalis</i> Mill.	RGB 153,204,0	GCO
GFO	Pyje te dominuar nga <i>Fraxinus ornus</i> L.	RGB 138,224,114	GFO
GBJ	Shkurre te dominuara nga <i>Buxus sempervirens</i> L. and <i>Juniperus oxycedrus</i> L.	RGB 51,102,255	GBJ
GJP	Shkurre te dominuara nga by <i>Juniperus oxycedrus</i> L. and <i>Prunus spinosa</i> L.	RGB 51,204,255	GJP
GJC	Shkurre te dominuara nga <i>Juniperus communis</i> L.	RGB 151,215,207	GJC
Zona e pyjeve dhe shkurreve fletore mezofile			
GQP	Pyje te dominuar nga <i>Quercus petraea</i> L.	RGB 255,135,107	GQP
AFS	Pyje te dominuar nga <i>Fagus sylvatica</i> L.	RGB 176,255,97	AFS
GAP	Pyje te dominuar nga <i>Acer pseudoplatanus</i> L.	RGB 51,204,51	GAP
ABP	Pyje te dominuar nga <i>Betula pendula</i> Roth.	RGB 204,255,153	ABP
APT	Pyje te dominuar nga <i>Populus tremula</i> L.	RGB 187,254,0	APT
APN	Pyje te dominuar nga <i>Pinus nigra</i> Arn.	RGB 255,0,0	APN
AAA	Pyje te dominuar nga <i>Abies alba</i> Mill.	RGB 204,0,0	AAA

HPS	Pyje te dominuar nga <i>Pinus sylvestris</i> L.	RGB 173,142,252	HPS
HPE	Pyje te dominuar nga <i>Picea abies</i> Karst.	RGB 255,80,80	HPE
HPP	Pyje te dominuar nga <i>Pinus peuce</i> Griseb.	RGB 255,0,102	HPP
GCS	Pyje te dominuar nga <i>Castanea sativa</i> Mill.	RGB 120,162,0	GCS
GCC	Pyje te dominuar nga <i>Coryllus colurna</i> L.	RGB 153,204,0	GCC
GOC	Pyje te dominuar nga <i>Ostrya carpinifolia</i> Scop.	RGB 61,185,108	GOC
Zona e vegjetacionit Alpin			
APM	Pyje te dominuar nga <i>Pinus mugo</i> Turra.	RGB 201,105,196	APM
AJN	Pyje te dominuar nga <i>Juniperus nana</i> Wild.	RGB 182,221,232	AJN
AJF	Shkurre te dominuara nga <i>Juniperus foetidissima</i> Wild.	RGB 146,202,220	AJF
AVM	Shkurre te dominuara nga <i>Vaccinium myrtillus</i> L.	RGB 153,153,255	AVM
Kullotat dhe Livadhet			
P	Kullotat	RGB 204,255,153	P
M	Livadhet	RGB 204,255,153	M
Te tjera			
BDS	Plazhet, dunat dhe ranishtet bregdetare	RGB 196,188,150	BDS
BR	Sip shkëmbore dhe zona me vegjetacion të rralle	RGB 166,166,166	BR
U	Siperfaqe inproduktive	RGB 148,179,150	U
BA	Siperfaqe të djegura	trashesia 0,3 RGB 238,0,176	
Elementët e biodiversitetit dhe vlerat konservuese			
BIO	Biotopet	Vetem kodi, me ngjyre te zeze	BIO
HAB	Habitatet	Vetem kodi, me ngjyre te zeze	HAB
HCV	Vlerat Konservuese te Larta	Vetem kodi, me ngjyre te zeze	HCV
RES	Rezervat Biogjenetike	Vetem kodi, me ngjyre te zeze	RES






5. HARTA E RRJETIT RRUGOR, INFRASTRUKTURËS DHE ZONAVE TË DEGRADUARA

Është një hartë e re e cila synon të përcaktojë rrjetin për mbritshmërinë me rrugë të ekonomisë pyjore, praninë e strukturave mbështetëse për aktivitetet e ndryshme për menaxhimin shumëfunksional të pyjeve, praninë e sipërfaqeve të degraduara dhe masat për parandalimin e degradimit. Ajo ndahet në seksionet e mëposhtme:






- Rrugët pyjore dhe shtigjet
- Infrastrukturat (për funksionet sociale dhe rekreacionale, punimet pyjore, kullotat, masat për parandalimin e zjarreve, problemet në rrjedhiet ujore, shpatet etj.)
- Sipërfaqet e degraduara në shpatë për shkak të aktivitetit human (gurore, vend- gërmime minerale etj)



Elementë të hartës janë përcaktuar në formën e simboleve, vijave me dimensione të ndryshme për secilin nga specifikimet e lartpërmendura. Për të ndihmuar leximin e hartës bazë topografike është më mirë që të përdoret komanda "transparencë" për të reduktuar intensitetin e ngjyrave (rreth 50%) për mbushjen e sipërfaqeve.

Elementët bazik














Përshkrimi	Trashësia dhe RGB	Ngjyra
Kufiri i ekonomisë pyjore	trashësia 0,7 RGB 0,176,80	
Kufiri i parcelës dhe numri	trashësia 0,5, numri i lartësisë 8 mm RGB 0,0,0	
Kufiri dhe shkronja e nënparcelës	trashësia 0,25, numri i lartësisë 5 mm RGB 0,0,0	
Zonat e mbrojtura	trashësia 0,5 RGB 47,192,239	
Prona private	trashësia 0,25 RGB 0,0,0	
Prona publike	Lihet bosh	

Elementet tematike-RRUGA





	Përshkrimi	Trashësia dhe RGB	Ngjyra
101	Rrugë kryesore për kamionë	trashësia 0,5 RGB 255,0,0	
102	Rrugë dytësore për kamionë	trashësia 0,5 RGB 0,0,182	
103	Rrugë për traktorë	trashësia 0,4 RGB 236,98,76	
104	Rrugë kryesore për rreshqitjen e materialit drusor	trashësia 0,3 RGB 109,0,0	
105	Rrugë dytësore për rrëshqitjen e materialit drusor	trashësia 0,3 RGB 105,50,130	



106	Rrugë mushke	trashësia 0,2 RGB 0,182,0	
107	Shtigje këmbësorësh, rrugica	trashësia 0,2 RGB 182,130,17	

Elementët tematikë- INFRASTRUKTURA

Kodi	Përshkrimi	Trashësia dhe RGB	Ngjyra
201	Burim uji	RGB 0,192,188	
202	Trupa ujour	RGB 51,153,255	
203	Kanal ujour	trashësia 0,3 RGB 1,188,255	
204	Strehë, kasolle, restorant, etj.	RGB 228,214,28	
205	Sipërfaqe rekreacioni dhe didaktike	RGB 255,128,0	
206	Strehë për kafshët	RGB 109,0,109	
207	Gardhe për kullotat dhe rrypëllëzimet	trashësia 0,3 RGB 95,73,122	
208	Garazhde për mjetet e mekanizuara në pyje dhe vend strehime për punëtorët	RGB 148,54,72	
209	Magazinë dhe impiante përpunimi të materialit drusor	RGB 255,164,233	
210	Teleferike dhe sisteme transporti me litarë	trashësia 0,3 RGB 203,111,137	
211	Të tjera (specifiko)	simbolin, trashësine dhe ngjyren	
Punimet për mbrojtjen e tokës dhe përmbytjeve nga uji			
212	Punime përgjatë rrjedhieve ujore ose trupave ujorë	trashësia 0,3 RGB 112,48,60	
213	Punime në shpate të pjerrta (rrëshqitjet, erozioni etj.)	trashësia 0,3 RGB 115,174,82	
214	Punime përgjatë rrugëve pyjore (argjinatura)	trashësia 0,3 RGB 89,45,0	

Elementet tematike Sipërfaqet e degraduara

Kodi	Përshkrimi	Trashësia dhe RGB	Ngjyra
301	Sipërfaqet e djegura	RGB 255,0,0	
302	Sipërfaqet e eroduar	RGB 255,255,0	
303	Rrëshqitjet sipërfaqësore	RGB 153,102,51	
304	Vende depozitimi të mbetjeve të ngurta	RGB 192,101,56	

305	Gurore	RGB 148,0,107	
306	Sipërfaqe të nxjerries së mineraleve	RGB 179,179,179	
307	Të tjera (specifiko)	simbolin, trashësinë dhe zgjidh ngjyrën	

Simbolet që përfaqsojnë elementët e degradimit duhet të përmasohen sipas madhësisë së elementëve në terren. Në rastin e sipërfaqeve të djegura, të gërryera, apo të rrëshqitura, është mirë që të shënohet zona ku këto ngjarje takohen. Nëse të dhënat për keto ç'rregullime në ekonominë pyjore nuk disponohen, por njëri nga keto ngjarje është evident në sipërfaqe, shënojeni atë me një simbol (trekëndësh) me të njëjtën ngjyrë dhe me të njëjtin dimension me atë të zonës. Është mirë që të ruhet ky informacion.






6. HARTA E NDËRHYRJEVE

Është një hartë shumë e rëndësishme pasi përmbledh të gjitha masat që do zbatohen në ekonominë pyjore gjatë 10 viteve (ose me shume) të ardhshëm. Kjo hartë duhet të jetë e ndarë në këto seksione:

- asnjë ndërhyrje: zonat pyjore pa ndërhyrje duhet të jenë pa ngjyrë ose simbole
- trajtimet silvikulturore që tregojnë ndërhyrjet kryesore në plantacionet e reja, trungishte, cungishte, punimet e kujdesimit (prerjet fitosanitare), rehabilitimi i pyjeve të dëmtuar etj.
- rrugët pyjore dhe strukturat (rrugët e reja, mirembajtja, struktura dhe impiantet për prodhimin e lëndës së punimit)
- ndërhyrjet për parandalimin e zjarreve në pyje (pikat e furnizimit me ujë, korridoret etj.)
- ndërhyrjet për rehabilitimin e tokave dhe rrjedhieve ujore (punimet në shpate, përgjatë rrjedhieve ujore dhe rrugëve auto)
- ndërhyrjet rekreative (shtigjet e reja dhe mirëmbajtja e tyre, fasilitetet për rekreacion/qëllime didaktike, barakat, baret etj)
- masat në shkurre dhe kullota (përmirsimi i sipërfaqeve me bimësi barishtore, strukturat e reja dhe mirëmbajtja e tyre).

Ndërhyrjet do të raportohen me ngjyra dhe fushë me një transparencë deri 50% , derisa të jetë e mundur që të shikohet tematika e hartës në sfond.















ELEMENTËT BAZE

Përshkrimi	Trashësia dhe RGB	Ngjyra
Kufiri i ekonomisë pyjore	trashësia 0,7 RGB 0,176,80	
Kufiri i parcelës dhe numri i saj	trashësia 0,5, lartësia e numrit 8 mm RGB 0,0,0	
Kufiri dhe shkronja e nënparcelës	trashësia 0,25, lartësia e numrit 5 mm RGB 0,0,0	
Zonat e mbrojtura	trashësia 0,5 RGB 47,192,239	
Prona private	trashësia 0,25 RGB 0,0,0	
Prona publike	të lihet bosh	

Elementet tematike

Kodi	Ndërhyrjet	Trashësia dhe RGB	Ngjyra
101	Pa ndërhyrje	të lihet pa ngjyre	
Trajtimet silvikulturore			
Ndërhyrjet biologjike			

201	Ripyllëzime	RGB 205,255,205	REF
202	Pyllëzime	RGB 101,255,101	AFF
203	Plantacione me lloje me rritje të shpejtë	RGB 153,255,153	FGT
204	Gardhime, mbrojtje nga fuana e egër	trashësia 0,3 RGB 112,48,60
Masat në trungishte			
205	Masat për kujdesimin e grumbujve të rinj (rrallimet e tipit te pare)	RGB 204,236,255	YGT
206	Rrallimet e tipit te dyte	RGB 229,223,236	THC
207	Prerjet selektive	RGB 204,192,217	SEC
208	Prerjet suksesive	RGB 178,161,199	SUC
209	Prerjet dritësuese	RGB 153,85,255	LIC
210	Prerjet përfundimtare	RGB 95,73,122	FIC
Masat në cungishte			
Përmirsimi i cungishteve të degraduara			
211	Pastrime	RGB 214,227,188	CLCc
212	Rrallime	RGB 194,214,155	THCc
213	Konvertimi në trungishte	RGB 118,146,60	CHF
Shfytëzimet në cungishte			
214	Rrallimet e tipit te parë	RGB 191,176,155	PCT
215	Rrallimet e tipit te dyte	RGB 161,138,167	COT
216	Prerjet rrah	RGB 251,212,180	CLC
217	Prerjet me breza	RGB 250,191,143	STC
218	Prerjet me çeltira	RGB 227,108,10	SPC
Për të gjithë tipet e pyjeve			
219	Prerjet sanitare	RGB 255,255,0	HEC
220	Rehabilitimi i dëmtimeve nga ngjarjet klimatike, zjarret në pyje, rrëshqitjet, orteqet etj.	RGB 255,255,153	RES
Rrugët pyjore dhe Strukturat			
301	Rruget pyjore ekzistuese (mirembajtje)	trashësia 0,4 RGB 49,132,155	_____
302	Rruge te reja pyjore	trashësia 0,4

		RGB 255,255,0	
303	Barakat për mekanizmat pyjorë dhe punëtorët	RGB 148,54,72	
304	Magazinat për lëndën drusore dhe impiantet e përpunimit të drurit	RGB 255,164,233	
Ndërhyrjet për parandalimin e zjarreve në pyje			
401	Pikat e furnizimit me ujë për mjetet e terrenit	RGB 0,192,188	
402	Trupat ujorë për furnizimin e mjeteve ajrore (helikopterë)	RGB 51,153,255	
403	Korridorët për zjarret në pyje	trashësia 0,3 RGB 203,11,137	
Ndërhyrjet për rehabilitimin e tokave dhe rrjedhieve ujore			
501	Punimet përgjatë rrjedhieve ujore ose trupave ujorë	trashësia 0,3 RGB 23,54,93	
502	Punimet në shpate (sipërfaqet e djegura, rrëshqitjet, erozioni etj.)	trashësia 0,3 RGB 212,101,10	
503	Punimet përgjatë rrugëve pyjore (argjinaturat)	trashësia 0,3 RGB 81,38,8	
Ndërhyrjet rekreacionale			
601	Shtigjet e reja dhe rrugicat (qëllime edukative, ecje të lirë, ecje me biçikletë, kuaj etj)	trashësia 0,3 RGB 255,0,0	
602	Mirmëbajtja e shtigjeve të reja dhe rrugicave, përmirsimi me fasilitete rekreacionale dhe edukuese	trashësia 0,3 RGB 153,51,255	
603	Strehat e reja, kasollet, restorantet etj.	RGB 78,97,40	
604	Sipërfaqet e reja rekreacionale dhe didaktike	RGB 255,128,0	
Masat në shkurre dhe kullota			
701	Prerjet në shkurre, heqja e barërave të këqija dhe pastrimi	RGB 204,0,0	SHC
702	Heqja e gurëve	RGB 255,204,0	SCL
703	Përmirsimi i sipërfaqeve barishtore (hedhje fare, plehërim etj)	RGB 204,255,51	IMG
704	Infrastruktura e kullotave të reja (kasollet, gardhet, lerat etj.)	trashësia 0,3 RGB 153,51,255	
705	Mirëmbajtja e infrastrukturës së kullotave (kasollet, gardhet, lerat, etj.)	trashësia 0,3 RGB 255,153,51	
706	Të tjera (specifiko)	simboli, trashësia dhe ngjyra duhet të zgjidhen	

Për të lehtësuar leximin e hartës topografike është më mirë që të përdoret komanda "transparencë" për të reduktuar intensitetin e ngjyrave (zakonisht me 50%) për sipërfaqet e mbushura.

STANDARTI 2 – LISTA E SPECIEVE

Kodi	Emri shqip	Emi shkencor
I. Vegjetacioni Riparian/Aluvial		
Drure halore		
PIT	Pisha brutia	Pinus brutia Ten.
PIE	Pisha e eger	Pinus halepensis Mill.
PID	Pisha e detit	Pinus pinaster Ait.
PIB	Pisha e bute	Pinus pinea L.
Shkurre halore		
DEK	Dellinja e kuqe	Juniperus oxycedrus L.
DKM	Dellinja e kuqe ssp kokermadhe	Juniperus oxycedrus L. ssp macrocarpa
Drure Fletore		
FRF	Frasheri fletengushte	Fraxinus angustifolia Vahl.
PLB	Plepi I bardhe	Populus alba L.
PLZ	Plepi I zi	Populus nigra L.
PLK	Plepi hibrid	Populus x canadensis Moench.
RR	Rrenja	Quercus robur L.
SAL	Shelgu I bardhe	Salix alba L.
RAP	Rrapi	Platanus orientalis L.
VFV	Vidhi fletevogel	Ulmus minor Miller
Shkurre fletore		
SQE	Shqopa e eger	Erica manipuliflora Salisb
HIP	Hipofaja	Hippophae rhamnoides L.
MER	Mersina	Myrtus communis L.
XIN	Xine	Pistacia lentiscus L.
MAF	Ferre	Rubus ulmifolius Schatt.
SPU	Shelgu I kuq	Salix purpurea L.
MOR	Morenxa	Smilax aspera L.
MAK	Marina	Tamarix parviflora DC.
II. Pyje dhe shkurre Sklerofile perhereblerta		
Drure Halore		
SLV	Selvia	Cupressus sempervirens L.
PIE	Pisha e eger	Pinus halepensis Mill.
PID	Pisha e detit	Pinus pinaster Ait.
PIB	Pisha e bute	Pinus pinea L.
Shkurre halore		
DEK	Dellinja e kuqe	Juniperus oxycedrus L.
Drure Sklerofile perhereblerta Mesdhetare		
MLL	Mallagjери	Arbutus andrachne L.
ULL	Ulliri I eger	Olea oleaster Hoffm. & Link
IL	Ilqja	Quercus ilex L.
VAL	Valanidhi	Quercus macrolepis Kotschy
Shkurre Sklerofile perhereblerta Mesdhetare		
MAR	Marja	Arbutus unedo L.
XHI	Xhixhibanozi	Ceratonia siliqua L.
LO	Lofata	Cercis siliquastrum L.
SQB	Shqopa	Erica arborea L.
QUD	Rriell si dru	Euphorbia dendroides L.
DAF	Dafina	Laurus nobilis L.
DR	Driza	Paliurus spina-christi Mill.
MRN	Mreta fletengushte	Phillyrea angustifolia L.
MRM	Mreta fletegjere	Phillyrea latifolia L.

CFA	Cfaka	Phlomis fruticosa L.
XIN	Xine	Pistacia lentiscus L.
BAF	Bafer	Pistacia terebinthus L.
SHG	Shege e eger	Punica granatum L.
USH	Ushinthi	Pyracantha coccinea Roem.
PRR	Pralli	Quercus coccifera L.
TRB	Trendafil i gjarperit	Rosa sempervirens L.
RSH	Rrushkulli	Ruscus aculeatus L.
SHE	Sherebela	Salvia officinalis L.
XA	Gjineshtra	Spartium junceum L.
III. Pyje dhe shkurre Termofile		
Drure halore		
PIZ	Pisha e zeze ssp austriake	Pinus nigra Arn. austriaca
PIZP	Pisha e zeze ssp pallasiane	Pinus nigra Arn. ssp pallasiana
Shkurre halore		
DEK	Dellinje e kuqe	Juniperus oxycedrus L.
VE	Dellinje e larte	Juniperus excelsa Bieb.
FI	Fidhesi	Juniperus phoenica L.
Drure Fletore		
KRM	Kreke	Acer campestre L.
KRV	Krekez	Acer monspessulanum L.
PAF	Panje flete-gjere	Acer obtusatum Waldst et Kit
UL	Ulez	Acer tataricum L.
QA	Qarr	Quercus cerris L.
SHP	Shparth	Quercus freaintto Ten.
BN	Bungebute	Quercus pubescens Willd.
BL	Bulger	Quercus trojana Webb in Loudon
AK	Robinie	Robinia pseudoacacia L.
BLG	Bliri fletegjere	Tilia platyphyllos Scop.
Shkurre fletore		
BSH	Bushi	Buxus sempervirens L.
SHK	Shkoza e bardhe	Carpinus betulus L.
SHZ	Shkoza e zeze	Carpinus orientalis Mill.
FSH	Fshikekartha	Colutea arborescens L.
THA	Thana	Cornus mas L.
LAB	Lajthia	Corylus avellana L.
LAE	Lajthia e eger	Corylus colurna L.
CE	Cermedelli	Cotinus coggygria Scop.
MUZ	Murrizi njeberthamesh	Crataegus monogyna Jacq.
MUP	Murrizi peseberthamesh	Crataegus pentagyna Waldst&Kit.ex Willd.
GRA	Grathateli	Erica carnea L.
BOS	Boshtra	Forsythia europea Deg. et Bald.
FRB	Frasheri i bardhe	Fraxinus ornus L.
UR	Urth	Hedera helix L.
LAV	Dorezonja	Lonicera caprifolium L.
ME	Melleza	Ostrya carpinifolia Scop.
KUL	Kullumbria	Prunus spinosa L.
GO	Gorica	Pyrus amygdaliformis Pall.
DA	Dardha e eger	Pyrus communis L.
BEL	Pjerrez	Rhamnus alaternus L.
TRE	Trendafil i eger	Rosa canina L.
MJ	Mjedhra	Rubus idaeus L.
IV. Pyje dhe Shkurre Mesofile		
Drure halore		
AR	Arnen	Pinus peuce Gris.

BE	Bersheni	Juniperus foetidissima Willd.
BRB	Bredhi I bardhe	Abies alba Mill.
PIN	Pisha e zeze	Pinus nigra Arnold.
BRM	Bredhi I maqedonise	Abies borisii-regis Matt.
HA	Hartina	Pinus silvestris L.
HO	Hormoqi	Picea excelsa Link
Shkurre halore		
DEZ	Dellinja e zeze	Juniperus communis L.
TIS	Tisi	Taxus baccata L.
Drure gjethegjera renese		
PAG	Panja flete-rrap	Acer platanoides L
PAM	Panja e malit	Acer pseudoplatanus L.
GEK	Geshtenja e eger	Aesculus hippocastanum L.
VEZ	Verri I zi	Alnus glutinosa L.
VEB	Verri I bardhe	Alnus incana L.
MSH	Meshtekna	Betula pendula Roth.
GE	Geshtenja	Castanea sativa Mill.
AH	Ahu	Fagus silvatica L.
AHM	Ahu moesian	Fagus sylvatica L. ssp. moesiaca
PLE	Plepi i eger	Populus tremula L.
BUN	Bunga	Quercus petraea Liebl.
SCP	Shelgu I eger	Salix caprea L.
BLV	Bliri si zemer	Tilia cordata Mill.
BLA	Bliri I argjendte	Tilia tomentosa Moench
Shkurre gjethegjera renese		
ASH	Ashja	Ilex aquifolium L.
BOR	Trasheger ligatinash	Vaccinium uliginosum L.
BUB	Butine e bute	Viburnum lantana L.
FRZ	Frasheri I zi	Fraxinus excelsior L.
FGJ	Herdhaqen gjethegjere	Euonymus latifolius (L) Mill.
FM	Fshikakuqi	Euonymus verrucosa Scop.
LAD	Dorzonje dru-forte	Lonicera xylosteum L.
MUH	Murrizi I heldraikit	Crataegus heldreichii Boiss.
STK	Shtogu i kuq	Sambucus racemosa L.
STZ	Shtogu i zi	Sambucus nigra L.
VAE	Vodheza	Sorbus aucuparia L.
VAB	Vodhvicja	Sorbus aria L.
VJA	Veshtull	Viscum album L.
HEL	HELMARINE	Atropa bella-donna L.
V. Bimesia Alpine		
Drure halore		
ROB	Rrobulli	Pinus heldreichi Christ.
KER	Kerleke	Pinus mugo Turra.
Shkurre halore		
DEZN	BDelliqeza	Juniperus communis L. ssp. nana
Shkurre fletore		
PJD	Pjerez dliruese	Rhamnus catharticus L.
Boronice	Bilberry	Vaccinium myrtillus L.
ZOV	Zogel	Frangula alnus Mill.
RRA	Rrush ariu	Arctostaphylos uva-ursi (L.) Sprengel
AKR	Arithe e kretes	Astragalus creticus Lam.

STANDARTI 3 – LISTA E TIPEVE TE PYJEVE DHE KULLOTAVE

KODI	PERSHKRIMI
DQI	Pyje te dominuar nga <i>Quercus ilex</i> L.
DQC	Pyje te dominuar nga <i>Quercus coccifera</i> L.
DPH	Pyje te dominuar nga <i>P.halepensis</i> Mill.
DPP	Pyje te dominuar nga <i>P.pinea</i> L.
DMAU	Pyje te dominuar nga <i>Arbutus unedo</i> L.
DMCC	Shkurre te dominuara nga <i>Cotinus coggygia</i> Scop.
DMED	Shkurre te dominuara nga <i>Euphorbia dendroides</i> L.
DMPS	Shkurre te dominuara nga <i>Paliurus spina-christi</i> Mill.
DQM	Pyje te dominuar nga <i>Quercus macrolepis</i> Kotchy.
GQF	Pyje te dominuar nga <i>Quercus frainetto</i> Ten.
GQC	Pyje te dominuar nga <i>Quercus cerris</i> L.
DQT	Pyje te dominuar nga <i>Quercus trojana</i> Webb.
GCB	Pyje te dominuar nga <i>Carpinus betulus</i> L.
GCO	Pyje te dominuar nga <i>Carpinus orientalis</i> Mill.
GFO	Pyje te dominuar nga <i>Fraxinus ornus</i> L.
GBJ	Shkurre te dominuara nga <i>Buxus sempervirens</i> L. and <i>Juniperus oxycedrus</i> L.
GJP	Shkurre te dominuara nga <i>Juniperus oxycedrus</i> L. and <i>Prunus spinosa</i> L.
GJC	Shkurre te dominuara nga <i>Juniperus communis</i> L.
GQP	Pyje te dominuar nga <i>Quercus petraea</i> L.
AFS	Pyje te dominuar nga <i>Fagus sylvatica</i> L.
GAP	Pyje te dominuar nga <i>Acer pseudoplatanus</i> L.
ABP	Pyje te dominuar nga <i>Betula pendula</i> Roth.
APT	Pyje te dominuar nga <i>Populus tremula</i> L.
APN	Pyje te dominuar nga <i>Pinus nigra</i> Arn.

AAA	Pyje te dominuar nga <i>Abies alba</i> Mill.
HPS	Pyje te dominuar nga <i>Pinus sylvestris</i> L.
HPE	Pyje te dominuar nga <i>Picea abies</i> Karst.
HPP	Pyje te dominuar nga <i>Pinus peuce</i> Griseb.
GCS	Pyje te dominuar nga <i>Castanea sativa</i> Mill.
GCC	Pyje te dominuar nga <i>Corylus colurna</i> L.
GOC	Pyje te dominuar nga <i>Ostrya carpinifolia</i> Scop.
APM	Pyje te dominuar nga <i>Pinus mugo</i> Turra.
AJN	Shkurre te dominuara nga <i>Juniperus nana</i> Wild.
AJF	Shkurre te dominuara nga <i>Juniperus foetidissima</i> Wild.
AVM	Shkurre te dominuara nga <i>Vaccinium myrtillus</i> L.
P	Kullota
M	Livadhe
BDS	Plazhe, duna dhe ranishte
BR	Siperfaqe shkembore dhe zona me vegjetacion te rralle
U	Siperfaqe inproduktive
BA	Siperfaqe te djegura
BIO	Biotopet
HAB	Habitatet
HCV	Siperfaqe me vlera konservuese te larta
RES	Rezerva Biogjenetike

STANDARTI 4 – LISTA E BIMEVE MJEKSORE DHE PRODUKTEVE PYJORE JO DRUSORE

Nr.	Emri lokal	Emri shkencor	Herb	Lule	Gjethe	Rrenjet	Fruti
1	Sherbelë	Salvia officinalis			X		
2	Trumëz	Saturea montana	X				
3	Rigon i bardhë	Origanum vulgare viridis	X				
4	Murriz	Crataegus sp.		X			
5	Zhumbricë	Thymus sp.	X				
6	Dëllinjë e kuqe	Juniperus oxycedrus					X
7	Lulebasani	Hypericum perforatum	X				
8	Kullumbri	Prunus spinosa					X
9	Kin fushe	Centaurium umbrellatum	X				
10	Trëndafil i egër	Rosa canina					X
11	Kamomilë	Matricaria chamomilla		X			
12	Luleshqerrë	Bellis perennis		X			
13	Mëlllagë e egër	Malva sylvestris		X	X		
14	Lulëkuqe	Papaver rhoeas		X			
15	Hithër	Urtica dioica	X				
16	Barblete	Melissa officinalis	X				
17	Caj mali	Sideritis roeseri	X				
18	Netull	Verbascum thapsiforme		X			
19	Dafinë	Laurus nobilis			X		
20	Bli	Tilia officinalis		X			
21	Shtog i zi	Sambucus nigra		X			
22	Gram	Graminis				X	
23	Dëllinjë e zezë	Juniperus communis					X
24	Xhërrokull	Colchicum autumnale					X
25	Mjedhër	Rubus sp.			X		
26	Rrigoni i kuq	Origanum vulgare	X				
27	Boronice	Vaccinium myrtillus					X
28	Salep	Orchis sp.				X	
29	Shqeme	Rhus coriaria			X		
30	Luleshtrydhe	Fragaria vesca					X

STANDARTI 5 –LISTA E BIOTOPEVE

Biotopet	KODI
Grumbujt afersisht natyrore	PN
Grumbuj te rralle	SR
Grumbujt me shperndarje te madhe qe kane mbetur si ishuj te vegjel per shkak te mbishfrytezimit	HV
Habitata te kafsheve dhe specieve te rralla ose the kercenuara	KR
Siperfaqe toke qe i eshte ndryshuar destinacion (1 ose disa here)	ND
Siperfaqe me vegjetacion pyjor ne kufijte ekstreme te shperndarjes ne kufirin pyll-kullote	EV
Biotope te mjediseve ujore (te lagetata)	ML
Biotope te mjediseve te thata	MT
Shoqerime bimore te shtreterve te perrenjve e lumenjve	SL
Shoqerime bimore perreth liqeneve(rezervuarve)	PL
Siperfaqe suksesioni natyror	SN
Monumente natyrore biotike	MB
Monumente natyrore jobiotike	MA
Te tjera	T

PROJEKTI I SHERBIMEVE MJEDISORE (ESP) No. P128412

**ZHVILLIMI I UDHEZUESVE PER HARTIMIN E PLANEVE TE INTEGRUARA TE MbaresHTRIMIT
TE PYJEVE DHE KULLOTAVE**

SEKSIONI I - ANEKSET

ANEKSI 1 - FORMATI PER LLOGARITJEN E KOSTOVE PER HARTIMIN E PLANIT TE MBARESHTRIMIT TE PYJEVE DHE KULLOTAVE

VLERESIMI I KOSTOVE PER HARTIMIN E PLANIT TE MBARESHTRIMIT TE PYJEVE DHE KULLOTAVE				
Bashkia e Ekonomia Pyjore				
Siperfaqja totale e Ekonomise Pyjore (ha)		0,00		
1. Pagesa per specialistets (inxhinjere pyjesh)				
a) Trungishte		ha	0,00	
		leke/ha	ha	tot.leke
per 100 ha e pare	0,00	0,00	0,00	0,00
per 150 ha pasues	0,00	0,00	0,00	0,00
per 250 ha pasues	0,00	0,00	0,00	0,00
per 750 ha pasues	0,00	0,00	0,00	0,00
per 1000 ha pasues	0,00	0,00	0,00	0,00
per siperfaqen pasuese	0,00	0,00	0,00	0,00
			<i>Totali trungishte</i>	0,00
b) cungishte dhe pyllezimet e reja		ha	0,00	
		leke/ha	ha	tot.leke
per 100 ha e pare	0,00	0,00	0,00	0,00
per 150 ha pasues	0,00	0,00	0,00	0,00
per 250 ha pasues	0,00	0,00	0,00	0,00
per 750 ha pasues	0,00	0,00	0,00	0,00
per 1000 ha pasues	0,00	0,00	0,00	0,00
per siperfaqen pasuese	0,00	0,00	0,00	0,00
			<i>Totali per cungishte dhe pyllezime te reja</i>	0,00
c) pyje te perziere (cungishte dhe trungishte)		ha	0,00	
		leke/ha	ha	tot.leke
per 100 ha e pare	0,00	0,00	0,00	0,00
per 150 ha pasues	0,00	0,00	0,00	0,00
per 250 ha pasues	0,00	0,00	0,00	0,00
per 750 ha pasues	0,00	0,00	0,00	0,00
per 1000 ha pasues	0,00	0,00	0,00	0,00
per siperfaqen pasuese	0,00	0,00	0,00	0,00
			<i>Totali pyje te perziere</i>	0,00
d) kullota		ha	0,00	

		leke/ha	ha	tot.leke
per 100 ha e pare		0,00	0,00	0,00
per 150 ha pasues		0,00	0,00	0,00
per 250 ha pasues		0,00	0,00	0,00
per 750 ha pasues		0,00	0,00	0,00
per 1000 ha pasues		0,00	0,00	0,00
per sipërfaqen pasuese		0,00	0,00	0,00
			<i>Totali kullota</i>	0,00
Pagesa totale				- Lekë
2. Shpenzimet e pergjithshme per specialistet (inxhinjere pyjesh)				
ne % te pageses				
		Vlera	%	tot.leke
per 100 ha e pare		0,00	25,00	0,00
per 150 ha pasues		0,00	20,00	0,00
per 250 ha pasues		0,00	15,00	0,00
per 750 ha pasues		0,00	15,00	0,00
per 1000 ha pasues		0,00	10,00	0,00
per sipërfaqen pasuese		0,00	10,00	0,00
			<i>Shpenzimet totale</i>	0,00
Pagesa totale dhe Shpenzimet e pergjithshme				- Lekë
3.Pagesa dhe shpenzime per pergatitjen e Hartave (ne sistemin GIS)				
		leke/ha	ha	tot.leke
Harta e parcelave/nen-parcelave				
Per 500 ha e pare		0,00	0,00	0,00
Per pjesen tjeter te sipërfaqes(ha)		0,00	0,00	0,00
			<i>totali</i>	0,00
Harta e funksioneve				
Per 500 ha e pare		0,00	0,00	0,00
Per pjesen tjeter te sipërfaqes(ha)		0,00	0,00	0,00
			<i>totali</i>	0,00
Harta e pyjeve,shkurreve dhe kullotave				
Per 500 ha e pare		0,00	0,00	0,00
Per pjesen tjeter te sipërfaqes(ha)		0,00	0,00	0,00
			<i>totali</i>	0,00
Harta e infrastruktures dhe zonave te degraduara				
Per 500 ha e pare		0,00	0,00	0,00
Per pjesen tjeter te sipërfaqes(ha)		0,00	0,00	0,00
			<i>totali</i>	0,00
Harta e nderhyrjeve				
Per 500 ha e pare		0,00	0,00	0,00
Per pjesen tjeter te sipërfaqes(ha)		0,00	0,00	0,00

				<i>totali</i>	0,00
Pagesa totale dhe shpenzimet per pergatitjen e hartave					- Lekë
4. PAGESA DHE SHPENZIME PER IDENTIFIKIMIN E KUFIJVE TE PARCELAVE DHE NENPARCELAVE NE TERREN					
			leke/ha	ha	tot.leke
			0,00	0,00	0,00
			0,00	0,00	0,00
			0,00	0,00	0,00
				<i>total</i>	0,00
TOTALI IDENTIFIKIMI I KUFIJVE (pagesa dhe shpenzime)					- Lekë
5. RISHIKIMI I PLANIT TE VJETER TE MBARESHTRIMIT (i skaduar)					
Ne rast te rishikimit te planit te skaduar,pagesat dhe shpenzimet duhet te reduktohen me ____%					
			totali. pikave 1-4		
			Leke %	tot.leke
			0,00	0,80	0,00
Shkruaj ne qelize vleresn e reduktimit					- Lekë
6. PAGESA PER PRINTIMIN E PLANIT NE DISA KOPJE					
Kopjet ne leter te planit (raporti,formulet),hartat me ngjyra					
			Leke	n°	tot.leke
			0,00	0	0,00
Pagesa totale per Kopjet ne Leter					- Lekë
7. Pagesa dhe shpenzimet per vrojtimit ne siperfaqe prove					
a) Prerja dhe matja e druveve model (per llogaritjen e volumit)					
			leke/dru	nr.	tot.leke
			0,00	0	0,00
			0,00	0	0,00
			0,00	0	0,00
				<i>total</i>	0,00
b) vrojtimit brenda siperfaqeve prove					
			leke/sip prove	nr.	tot.leke

Trungishte		0,0	0,0	0,0
Cungishte dhe pyje te rinj		0,0	0,0	0,0
mixed forest		0,0	0,0	0,0
			<i>total</i>	0,00

TOTALI I TAKSAVE

- Lekë

b) RISHIKIMI I PLANIT TE SKADUAR % E PAGESAVE DHE SHPENZIMEVE PER PIKAT 5-10

			tot. pikave 5-10	
			leke % tot.leke
Taksat,.				0,00
TOTALI I TAKSAVE				- Lekë

TOTALI per pergatitjen e Planit te ri te Mbareshtimit te Pyjeve dhe Kullotave

- Lekë

KOSTOJA PER 1 HA

TOTALI per Rishikimin e Planit te Skaduar te Mbareshtimit te Pyjeve dhe Kullotave

- Lekë

KOSTOJA PER 1 HA

ANEKSI 2 - TERMAT E REFERENCES PER HARTIMIN E PMPK

1. SFONDI

Bashkia eka marre nje grant nga perfaqsuar nga, ne total ALL, te financoje pergatitjen e Planit te Mbareshtimit te Pyjeve dhe Kullotave te Ekonomise Pyjore

Keto terma reference do te sherbejne per te percaktuar pegjegjesite, detyrat dhe kualifikimet e kerkuara per konsulentet qe do te pergatisin Planin e Mbareshtimit per Bashkine bazuar ne Udhezuesin per Planet e Integruara te Mbareshtimit te Pyjeve dhe Kullotave 2018.

2. KONTEKSTI

Me reformen administrative dhe Ligjin Nr 115/2014, Republika e Shqiperise ka krijuar njesite e reja administrative ose Bashkite ku nga bashkimi i njesive administrative te meparshme prej 361 komunash dhe bashkish tashme kemi vetem 61 Bashki. Me keta kufij te rinj kerkohet edhe percaktimi i ekonomive pyjore dhe hartimi i planeve te reja te mbareshtimit bazuar ne keto parime:

- planet do perdoren per trungshtet, cungishtet, shkurret si dhe kullotat qe jane brenda kufijve te Bashkise dhe keto plane do quhen Plane te Mbareshtimit te Pyjeve dhe Kullotave.
- do te mbulojne te gjitha tipet e pronesise se pyjeve dhe kullotave
- periudha e vlefshmerise se planit eshte vjet
- secili PMPK hartohet per 1 ekonomi pyjore. Baza per krijimin e njesive te reja te mbareshtimit do te jene ekonomite ekzistuese pyjore, por sistemi i ri i mbareshtimit eshte unik.
- PMPK eshte pergatitur duke perdorur mundesite aktuale te teknologjise ne termat e lidhjes se internetit dhe perdorimin e mjeteve informatike te reja sidomos ne lidhje me SISIP qe menaxhon te dhenat e pyjeve dhe kullotave ne Shqiperi.
- PMPK bazohet ne klasifikimet e standartizuara qe jane te zakonshme per te gjitha planet dhe projektet e tjera si psh: IKP dhe keto do jene te pershtatshme edhe per SISIP.

Menaxhimi i procesit per hartimin e PMPK eshte pergjegjesi e Bashkise.

3. OBJEKTIVAT

Detyra per hartimin e Planeve te reja te Mbareshtimit te Pyjeve dhe Kullotave per nje ekonomi pyjore synon qe te arrije objektivat e meposhtme:

1. pergatitjen e nje plani shumefunksional duke mbuluar aspektet ekonomike, sociale dhe ekologjike
2. njohja e burimeve lokale duke perfshire siperfaqet pyjore dhe jo pyjore, produktet drusore dhe jodrusore, kullotat dhe produktet e tyre, gjendja e turizimit dhe fasilitetet didaktike dhe te kerkimit shkencor.
3. njohja e problemeve lokale si: erozioni, rreshqitjet, zjarret ne pyje, prerja ilegale, mbikullotja etj.
4. pergatitja aktive dhe pjesmarrja ne te gjitha hapat e procesit te pjesmarrjes duke perfshire aktoret lokale ne hartimin dhe menaxhimin e PMPK.
5. menaxhimi i punes per hartimin e planit dhe futjen e tij ne SISIP
6. percaktimi i ndërhyrjeve per periudhen e vlefshmerise se planit te mbarështrimit
7. mbeshtetja e Bashkise ne te gjitha fazat e hartimit te planit deri ne miratimin e tij nga MTM.

Ekonomia pyjore dhe kullosore per te cilen do te hartohet plani i mbareshtimit jepet ne tabelen e meposhtme:

Nr	Pergatitja e planit per Ekonomine Pyjore dhe Kullosore	Sip (ha)
1.	Siperfaqja totale	
1.1	Trungishte	
1.2.	Cungishte	
1.3.	Shkurre	
1.4.	Kullota	
1.5.	Te tjera	

4. QELLIMI I SHERBIMIT

Hartimi i PMPK duhet te behet bazuar ne parimin e mbareshtimit te qendrueshem qe nenkupton "te ruaje dhe te forcoje gjendjen shendetsore te ekosistemeve pyjore per nje afat kohe te gjate dhe ne te njejten kohe per te siguruar mundesi ekologjike, sociale, ekonomike dhe kulturore per mireqenien e brezave aktuale dhe atyre te ardhshem". Ky plan hartohet per ekonomite pyjore qe jane pjese e Bashkive dhe natyrisht ne kordinim edhe me njesite e tjera ekonomike fqinje apo zonat e mbrojtura nese eshte e nevojshme.

Hartimi i planit te mbareshtimit eshte nje mjet per te njohur gjendjen aktuale te territorit, siguron nje ndeveprim me aktoret dhe bashkite si dhe kordinim me institucionet qendrore nepermjet perdorimit te SISP dhe kjo pritet te ndodhe gjate hartimit te PMPK dhe gjate drejtimit te nderhyrjeve dhe ngjarjeve ne periudhen e vlefshmerise se planit. Perdorimi i nje metode te standartizuar te punes e percaktuar ne Udhezuesin e Planeve te Mbareshtimit te Pyjeve dhe Kullotave 2018, duhet te sherbeje per te siguruar rezultate homogjene dhe te krahasueshme ne nivel lokal duke perdorur procedurat qe ofrohen nga SISP.

Sipas Udhezuesit, procesi i hartimit te PMPK duhet te zhvillohet sipas ketyre hapave:

- Puna pergatitore
- Puna ne terren
- Puna ne zyre

Puna e eksperteve te jashtem duhet gjithmone te zhvillohet ne bashkepunim te ngushte me Bashkine dhe stafin pyjor lokal si nje kusht themelor per te siguruar rezultate te mira. Me poshte jepet nje skeme e permbajtjes se procesit, por hartimi i PMPK duhet absolutisht te zhvillohet sipas percaktimeve te Udhezuesit 2018.

PUNA PERGATITORE

